Citim nga Vendimi i AK-se. - Marrëveshja për themelimin e grupit nuk është ne përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik, dhe Rregullat e Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik për themelimin e Grupit - konzorciumit. Sipas Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik neni 27.3 citoj: Secili anëtar i grupit duhet te përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, neni 65 i LPP-se. Çdo kërkesë e vendosur nga autoriteti kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 te LPP-se do te aplikohet vetëm ndaj grupit ne tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual te grupit, kurse ne mbështetjen bankare ceket se kompania Groma Hold EOOD është partner udhëheqës, ndërsa ne nenin 3.2 te marrëveshjes për themelimin e grupit ceket se pjesëmarrja e përbashkët Groma Hold EOOD dhe RSM Company shpk, thuhet se kompania Groma Hold EOOD ne cilësinë e saj si partner ne kontrate do te kryej vetëm shërbime konsulentë dhe nuk mbaj asnjë përgjegjësi ne lidhje me ekzekutimin e kontratës dhe si e tillë kjo marrëveshje është ne kundërshtim me Deklaratën mbi marrjen e përgjegjëses bashkarishte dhe individualishte për formimin e grupit prandaj i njëjti nuk është kualifikuar ne fazën e poentimit.
Ky arsye e eliminimit është qesharake, dhe njëkohësisht edhe citimi i Udhëzuesit Operativ te Prokurimit publik dhe neneve te saj është jo relevant me arsyetimin ne fjale, poashtu edhe citimi i

dokumentit te mbështetjes bankare ne këtë rast është jorelevant dhe i paarsyeshëm, shihet mjafte qarte jo profesionalizmi i këtij "komisioni", dhe si rrjedhoje është mese e qarte qe ky vlerësim eshte tendencioz dhe me qëllime te qarta, për arsyet si ne vijim: Ne FDT, konkretisht ne piken 11.1 Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik eshte kerkuar: a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.
Kurse ne si Grup i OE, ne materialin tenderues kemi paraqitur te gjitha deklaratat dhe dokumentet përkatëse qe mbulojnë pikat a,b,c dhe d, dhe te njëjtat ndodhen ne materialin tenderues qe kemi dorezuar per kete aktivitet te prokurimit. Kompania Groma Hold EOOD është lider i këtij grupi, dhe deklarata për piken a. Ku kompania lider ne këtë rast Groma Hold EOOD deklaron me përgjegjësi te plote se është përgjegjës si individualisht ashtu edhe bashkërisht për këtë aktivitet te prokurimit. Çfarëdo tendence tjetër për interpretim ndryshe te deklarimeve përben shkelje flagrante ligjore, dhe devijim i qëllimshëm i fakteve për arsye te ndryshme.
Pretendimi 2
Ne Vendimin e AK-se jemi eliminuar me arsyetimin:
Citim nga Vendimi i AK-se. - Plani dinamik jo i plotësuar sipas kërkesave te DTte. Ne Dosje te tenderit kerkohet Plani Dinamik - te prezentohet sa me i detajuar i mundeshem duke perfshire te gjitha aktivitetet dhe pozicionet qe jane te përfshira neper paramasa nga ana e ofertuesit/kontraktuesit, ndersa OE nuk ka ofruar te dhëna sipas kerkeses se DT-se.
Ne si Grup i OE, kemi paraqitur planin dinamik sipas kërkesës se FDT-se, ku janë te përfshira te gjitha pozicionet e paramasave sipas kërkesës se AK-se, madje plani dinamik përfshin për secilin pozicion se sa dite i nevojitet per tu realizuar sipas kalendarit. Nuk e kuptojme kete arsyetimin "... sa me i detajuar i mundshem" ndoshta per arsyen sepse AK-ja ka ndonje model te planit dinamik dhe do te ishte mire ta publikonte si model dhe ne kete menyre te kishim mundesine te gjitha kompanite te realizonim pastaj planin dinamik sipas deshires dhe pelqimeve te AK-se, perndryshe eshte e pamundur ta dijme se cka nenkupton termi i famshëm "... sa me i detajuar i mundshem". Çfarëdo tendence tjetër për interpretim ndryshe te dokumenteve te dorëzuara përben shkelje flagrante ligjore, dhe devijim i qëllimshëm i fakteve për arsye te ndryshme.

Pretendimi 3
Ne Vendimin e AK-se jemi eliminuar me arsyetimin:
Citim nga Vendimi i AK-se. - OE ka deshtuar te plotesoj edhe kerkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, Kerkesa: 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi

vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë prej jo më pak se - Pjesen e I-re 16,000,000.00 euro, Pjesen e II-te 14,000.000,00 euro, Pjesen e III-te 12,000.000,00 euro, Pjesen e IV-te 20,000.000,00 euro. -OE nuk ka paraqitur Deklaratat Tatimore vjetore te dorezuara ne ATK per vitin 2022 ashtu sic eshte kerkuar ne 3 vitet e fundit ne kerkesat e percaktuara ne Njoftimin per kontrate dhe Dosjen e tenderit.

Ky arsyetim i AK-se eshte sa qesharak dhe poashtu edhe tendencioz dhe aspak profesional. Njoftimi per kontrate i ketij aktiviteti te prokurimit eshte publikuar me dt.08.03.2023, qe nenkupton se afati per dorezimin ne ATK te deklarimeve vjetore te vitit paraprak eshte deri me dt. 31.03.2023, dhe data qe merret per baze eshte data e njoftimit per kontrate dhe jo ajo e dorezimit te tenderit.

Poashtu nuk e kemi te qarte se sa joprofesional dhe injorant ne raport me LPP-ne dhe Legjislacionin sekondar te Prokurimit Publike, mund te jene komisioni i vlerësimit pasi qe sipas LPP dhe Legjislacionit sekondar nese nje kompani dorezon Deklaratat Tatimore qofte vetem per nje vit sipas kerkeses, dhe per ate vit mbulon kerkesat minimale te parashtruara ne FDT atehere ajo eshte mese e mjaftushme.

Citim nga Udhezuesi 001/2023 i dates 01.02.2023, faqe 31, paragrafi 2 Në rastin kur kërkesa e gjendjes ekonomike dhe financiare i referohet një qarkullimi total prej 3,000,000 euro në tri vitet e fundit dhe Operatori ekonomik përmbush kërkesën e përcaktuar ne dokumentet e tenderit në vetëm dy vite apo një vit, konsiderohet se OE ka përmbushur kërkesën minimale. Kushti minimal është përmbushur duke prezantuar dëshmitë e qarkullimit total prej € 3,000,000 në tre vite, dhe nuk ka rëndësi se sa ka qenë qarkullimi në secilin vit veç e veç. Ne si Grup i OE, kemi paraqitur deklaratat tatimore per 3 vitet e fundit nga data e Njoftimit per Kontrate pikerisht sic eshte kerkuar ne Njoftimin per Kontrate dhe FDT, dhe askund ne Njoftimin per Kontrate dhe FDT nuk është i cekur viti 2022, por eshte i cekur termi per 3 vitet e fundit, dhe ne përputhje me këtë kërkesë ne kemi paraqitur Deklaratat Tatimore per 3 vitet e fundit nga data e njoftimit për kontrate. Cfaredo tendence tjeter per interpretim ndryshe te dokumenteve te dorëzuara përben shkelje flagrante ligjore, dhe devijim i qëllimshëm i fakteve për arsye te ndryshme. Per fund duam te sqarojmë se me Vendimin e tyre AK, ka per qellim demtimin e buxhetit te Republikës se Kosovës, ku me mos shpalljen e ofertes tone fituese duke qene oferte e përgjegjshme me e lira ne 3 lote dhe e dyta ne 1 lot, buxheti rrezikon te demtohet si ne vijim: Lot 1 - 393,175.46 Euro, Lot 2 - 34,648.18 Euro, Lot 3 - 449,064.27 Euro, Lot 4 - 1,193,636.57 Euro. Pra këto vlera te lartshënuara janë diferenca e ofertës tone me ofertat tjera te shpallura fituese, dhe te njëjtat tregojnë për shkeljen dhe dëmtimin kriminal qe tenton te beje AK-ja ne kete rast.

Pra i apelojme Panelit te OSHP-se te evidentoje këto shkelje te renda, pasi qe arsyet e eliminimit tone janë arsye estetike qe sipas zyrtareve dhe komisionit vlerësuar nuk kane qene te kënaqshme per ta.

<u>ANKESA 2024/0056</u>

<u>Dispozitat e shkelura</u>

- Neni 1- Qellimi
- Neni 6- Ekonomiciteti dhe efiksasiteti

- Neni 7- Barazia ne trajtim , jo diskriminimi
- Neni 10 Mjetet per promovimin e transparences
- Neni 11 -Informatat sekrete afarsite
- Neni 59-Ekzaminimi vlersesimi dhe krahasimi I tendereve
- Neni 60 - Kriteret per dhenien e kontrates
- Neni 64- Deshmite e kerkesave
- Neni 69-Aftesia teknike dhe profesionale
- Rregullorja nr 01/2022 per Prokurim Publik
- Udhezuesi nr 01/2023 per Prokurim Publik

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Me date 04.05.2023 Grupi Operatoreve Ekonomik Sallahu Shpk & Salillari Shpk kane dorezuar oferten per Lot 1,2,3,4 ne lidhje me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi I rrugës Nacionale N9 segmenti Kijeve- Dollc, Loti 1 ,2,3,4" me nr.prokurimit 205-23-1843-5-1-1, ne perputhje me te gjitha kerkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues ne DT dhe FDT.

Me kete rast konform Procesverbalit te Hapjes se tendereve, vlera e oferteve tona eshte rradhitur nder te te lirat sipas cmimit, ku Kriteri I Dhenies se Kontrates ka qene Tenderi I pergjegjshem ekonomikisht me I favorshem I percaktuar sipas peshes se nen kritereve te percaktuara ne Aneks 6 ,ku Cmimi ka pasur 60 % të poentimit, dhe 40% kerkesat e tjera teknike-profesionale . (Shih Procesverbali i Hapjes se Tendereve)

Dhe duke qenë se kemi ofruar shumefish kapacitete teknike dhe profesionale nga ato se cfare jane kerkuar , rrjedhimisht sipas nje llogaritje te drejte te poentimit, kemi konsideruar se jemi meritor per t'u shperblyer me ndonjerin nga Lot -et si Operatori i përgjegjshëm me cmimin ekonomikisht me te favorshem.

Mirëpo, me date 29.12.2023 ne ora 14: 40 kemi pranuar Letren standard per tenderuesin e eliminuar , dhe Njoftimin mbi vendimin e AK-se me te cilin me kontrate rekomandon operatoret ekonomik te papergjegjshem si ne vijim :

Për Lot 1 : R&Rukolli; SABA BELCA Dega në Kosovë ;ELMAZAJ KONSTRUKSION; Tekno-Konstrukt SH.P.K

Për Lot 2 : OE Empreus Shpk, Jaha Company Shpk , Premium Ks, Tofior, NNT ABC, Metag Insaat Ticaret

Për Lot 3 : OE Lika Trade , Tofi DOO , Lika Company

Për Lot 4 : OE Famis Co Hc , KIT -AK , Kag Asphalt Company

Autoriteti Kontraktues, përkatësisht Komisioni Vleresues(p*er te cilin kemi dyshime se nuk ka qene kompetent*) ka perdorur arsyetim te pa bazuar dhe kunderligjor qe te na cilesoje si te pa pergjegjshem dhe te mos na rekomandoje me kontrate per ndonjerin nga Lot-et e ketij tenderi. Ne kete drejtim duke vepruar ne kundershtim me qellimin, ekonomicitetitn dhe efikasitetin te sanksionuar me Ligjin e Prokurimit Publik , dhe duke rekomanduar per kontrata operatore te pa pergjegjshem te cilet as per se afermi nuk plotesojne kerkesat e dosjes se tenderit, dhe me cmime ekonomikisht te pa favorshme

,duke demtuar keshtu edhe Buxhetin e Republikes se Kosoves qindra mijëra euro.
Te pakënaqur ndaj Vendimit te AK te dt 29.11.202 , duke qenë palë me interes në kuptim të nenit 4 të LPP-së paragrafi 1.11 lidhur me paragrafin 1.26, kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së në përputhje me nenin 108/A të LPP-së , ku mbi bazen e provave dhe fakteve të ofruara mbi shkeljet procedurale dhe materiale të bëra ne kete aktivitet te prokurimit, kemi kërkuar që të anulohet Njoftimi per dhënie te kontrates I dt 29.12.2023 dhe lenda te kthehet ne rivleresim për Lot 1 , 2, 3, 4 dhe të shpallemi OE I përgjegjshëm dhe I rekomanduar me ndonjerin nga Lot-et.. - (*Prove Kerkesa per Rishqyrtim dhe plotesimi me deshmit tjera shtese 03.01.2024)*
Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë mundin që të shqyrtojë pretendimet tona krahas provave dhe fakteve të shumta që kemi ofruar fillimisht mbi pergjegjshmerine tone, dhe mbi parregullesite dhe shkeljet ligjore pergjate vleresimit te ketij tenderi, por i ka refuzuar si të pa bazuara duke mos ofruar asnjë arsyetim të argumentuar lidhur me pikat ankuese të Kërkesës për Rishqyrtim , që në fakt përbëjne bazë ligjore për ktkhim të lëndës në rivlerësim . (Provë : Vendimi mbi refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim 09.01.2024) .
Andaj , pas udhëheqjes së procedurës paraprake për zgjidhjen e mosëmarrveshjeve, në kuptim të nenit 109 të LPP-së i drejtohemi Organit Shqyrtues me këtë Ankesë kundër Vendimit mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim te dt 09.01.2023, duke kërkuar anulimin e Vendimit te Autoritetit Kontraktues , dhe pas shqyrtimit të provave dhe pretendimeve te parashtruar ndaj shkeljeve procedurale dhe materiale kerkojme vendosje meritore,dhe kthim të lëndës në Rivlerësim edhe për LOT 1, 2,3 dhe 4.

<u>Pretendimi 1</u>

Permes Letres standard per tenderuesin e eliminuar ''Sallahu Shpk & Salillari Shpk '' eliminohen nga procedura e prokurimit nen arsyetimin se :
OE Ka deshtuar te plotesoje kerkesat e percaktuara ne Njoftimin e Kontrates dhe DT i mungojnë:
Ne Listen e Paisjeve eshte kerkuar Pika 10 Grejder 12-16t , jane kerkuar 3 Grejdera. Ndersa Operatori ka ofruar 5 Grejdera, 4 prej te cileve e tejkalojne kapacitetin e kërkuar :
1.Grejder me kapacitet 16.2t
1Grejder me kapacitet 18t
1Grejder me kapacitet 17t
1Grejder me kapacitet 20t
Paisja me nr 1 Greder marka O&K, tip F156.6A 2004, nr.107174 nga kerkimet ne interenet verifikohet se ky grader ka peshe prej 16,200kg ashtu siq eshte prezantuar nga vet operatori ekonomik nepermjet DUD-it.
Paisja nr.2 Greder Catepillar Champion 740,1990 eshte sipas kerkesave te DT-se.
Paisja nr.3 Grejder O&K tip 106 A ,viti 1992 , ne DUD nuk prezantohet pesha e paisjes mirepo pas kerkimit ne internet vertetohet se kjo paisje eshte nen peshen 12t, me c' rast nuk eshte ne perputhje me kerkesat e DT.

Paisja nr. 4 Greider Caterpillar 120m, viti 2018 me targa AKTM 67 . Ne dokumentacionin e prezantuar per kete paisje mungon pesha e paisjes. Mirepo pas kerkimit ne internet vertetohet se kjo paisje eshte 16,900 kg, me c'rast nuk eshte ne perputhje me kerkesat e DT-se , Lot 2, Lot 3 dhe Lot 4 , OE eshte I pa pergjegjshesm pasi nuk arrin te plotesoje kerkesat e percaktuara ne DT .

Sqarojmë se:

Sipas Letres standard per tenderuesin e eliminuar, Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur qe te argumentoje se OE Sallahu & Salillari jane operatore ekonomik I pa pergjegjshem .

Vecanarisht per Lot 1 nuk kemi pranuar asnje arsyetim eliminimi, per faktin se referuar Listes se paisjeve te Lot 1 , ne piken 10 eshte kerkuar Grejder 12 -16 ton 2 cope dhe ne Lot 2 , 3 , 4 jane kerkuar Grejder 12-16 t (3 cope).

Meqë nuk janë trajtuar provat e ofruara lidhur me kete pretendim nga Autoriteti Kontraktues , kerkojme nga OSHP qe t'a trajtoje, dhe ne baze te provave si ne vijim te ne kualifikoje si operatore ekonomik i pergjegjshem per Lot 1,2,3,4 .

OE Sallahu Shpk & Salillari Shpk ka ofruar 5 Grejder , ku 3 prej tyre e plotesojne kapacitetin e kerkuar prej 12-16t, dhe jane te renditur ne Listen e paisjeve si ne vijim, si dhe dy Grejder te tjere shtese ku nga deshmite e ofruara provohet qarte se jemi te pergjegjshem ne te 4 Lotet.

10.	Grejder 12-16t	2	5	1.Greder marka O & K , tip F 156.6A , viti i prodhimit 2004 , nr. 107574

"Zgjerimi i Rrugës Nacionale 4A - Segmenti Kijevë- Dollc , Loti 1,2,3,4 ", nr.prok 205-23-1843-5-1-1

Salillari

				2. Greder Cate tip Champion 740 , viti i prodhimit 1990 3. Greder marka O & K , tip 106A, viti i prodhimit 1992 4. Greder , marka caterpillar 120m, viti i prodhimit 2018 , targat AKMT67 5. Greder , marka Caterpillar, tip 14 G, viti i prodhimit 2003

-Greder I renditur nr. 1 Marka O & K tip F156.6A, viti I prodhimit 2004 , nr. 107574, me kapacitet 16 ton e 200kg eshte konform kerkeses se vendosur nga Autoriteti Kontraktues dhe nuk paraqet tejkalim te kapacitetit sepse eshte 16 ton, dhe 200 kg me teper natyrisht se nuk ndikojne asgje ne kryerjen e funksionit dhe cilesise se tij, per faktin se edhe nga vet prodhuesi shume prej paisjeve nuk e kane te

fiksuar kapacitetin prej vetem 16t.
Ne kete rast, duhet te merret si devijim I vogel ne raport me qellimin e aktivitetit te prokurimit , dhe ekonomicitetit konform nenit 59 par 4 i LPP-se , ashtu sic thuhet edhe ne Vendimin nr 0397/2023 te OSHP-se lidhur me nje arsyim te tille te eliminimit ne nje tjeter AP.
Sepse ne rastin konkret per Lot 1 Oferta e OE R&Rukolli eshte prej 233,128.00 euro me e shtrenjte se oferta e OE Sallahu dhe Salillari, e po ashtu edhe per Lot 3 Oferta e OE Lika Trade eshte 110,636.0 euro me e shtrenjte se oferta e OE Sallahu dhe Salillari.
Sikurse e percakton LPP : devijime te vogla qe nuk mund te shkaktojne ndryshime materiale, ose devijime nga karakterisitikat, kushtet, dhe kerkesat e tjera te parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe Dosjen e tenderit .
Ku nga praktika, ka raste kur MMPHI I ka kaluar pasije edhe me pesha me te medha.
Pra grederi ne fjale I pergjigjet plotesishte kerkeses se Autoritetit Kontraktues, dhe sipas Rregullores nr 01/2022 per Prokrim Publik eliminimi per nje ''arsye''te tille tregon jo seriozitet dhe profesionalizem. Ne perputhje me nenin 40 par 4 nderlidhur me nenin 40.7 te Rregullores nr 01/2022 per Prokurim Publik thuhet se : Tenderi do te konsiderohet I pergjegjshem kur
a) Eshte ne pajtueshmeri ne nga aspketi administrative me kerkesat formale te Dosjes se Tenderit
b) Eshte ne pajtueshmeri me termet teknike , me pershkrimin, kerkesat dhe specifikimet e percaktuara te Dosjes se tenderit
c) Eshte dorezuar nga operatori ekonomk qe permbushe kriteret e përzgjedhjes te percaktuara ne Dosjen e Tenderit .
Ne "pajtueshmeri" nga aspekti administrativ dhe teknik duhet te kuptohet si permbushje e e kerkesave dhe specifikimeve administrative dhe teknike te parashtruara ne Dosje te Tenderit, duke mos u larguar ne menyre thelbesore nga ato dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime.
Largime dhe kufizime jane ato te cilat :
(i) Dallojne esencialisht nga kushtet dhe specifikimet e Dosjes se Tenderit, dhe /ose
(ii) Afektojne paramterat, cilesine ose ekzekutimin e kontrates , dhe/ose
(iii) Kufizon te drejten e AK ose obligimet e tenderuesit sipas kontrates, dhe ose
(iv) Shtremberon konkurrencen e tendereusve, ofertimet e te cileve jane ne pajtueshmeri me rregullat.
Se Autoriteti Kontraktues po perdore standarde te dyfishta te vleresimit dhe qe e dëmtojnë edhe Buxhetin e Republikes se Kosoves e deshmon fakti se e rekomandon nje OE me te shtrenjte sesa ne prej 110,636.09 euro , me po te njejtat paisje sic I kemi ofruar ne ,dhe i cili ka ofruar pra 2 Greder 16.2ton(Lika Trade - Lot 3) , ndersa ne na eliminon se kemi ofru 1 greder te tille 16.2ton
Nga kjo duhet te nenkuptohet se edhe Grederi I ofruar nga Sallahu dhe Salillari duhet te jete I pranueshem per Autoritetin Kontraktues, dhe nuk do t'i shkaktoje humbje as Buxhetit te Republikes se Kosoves qindra mijera euro.
- Greder me piken nr. 2 Cate Champion 740, viti 1990 me kapacitet 16t po ashtu eshte konform kerkeses se AK-se .
- Greder i renditur ne piken 3 Marka O & K tip 106 A , viti i prodhimit 1992 ka kapacitet 12t. Sikurse shihet nga deshmite te cilat kane qene te bashkangjitura me oferte dhe per njohesit e fushes, eshte i

mjaftueshëm vetem modeli i paisjes ne fjale per te kuptuar kapacitetin e saj, gjithesesi me nje kerkim te thjeshte ne internet , mund te verifikohet lehtesisht kapaciteti I modelit te paisjes ne fjale, pra Greder tip 106 A I cili ka 12t .

Ne lidhje me rezultatin e kerkimit ne internet per Greder O& K F106 shfaqen fotografite me te dhenat tekike sikurse Grederi I ofruar ne piken 3 te Listes se paisjeve, me cka deshmohet edhe njehere se ''OE Sallahu Shpk & Salillari Shpk'' eshte i pergjegjshem dhe ka plotesuar kerkesen nr 10 te Listes se paisjeve per Lot 1 , 2 , 3 dhe 4 .

Se Grederi i renditur ne piken 3te Listes se paisjeve ka 12t, dhe ploteson kerkesen e DT , e deshmon edhe fakti se si Autoriteti Kontraktues per Operatorin Granit Shpk , lidhur me nje Greder te paraqitur nga ky operatore me te dhenat '' Greder Faun 105'' thote se ka peshen 12,400kg dhe si I tille eshte I pranueshem ky grader. Analogji me kete , si eshte e mundur qe Grederi F 106i Sallahu & Sallilari (pra grader me I madh) te jetë nën 12t , ndersa Grederi F 105(qe eshte me I vogel) te jetë mbi 12t.
Keto veprime , paraqesin qarte qasjen e pa barabarte dhe diskriminuese ndaj Operatorit Ekonomik

Sallahu Shpk & Salillari.
Sikurse u potencua me larte, nga GEO Sallahu & Salillari jane ofruar edhe Greder te tjere shtese (pika 4 dhe 5) te cilet po ashtu plotesojne kerkesat Minimale te vendosura nga Autoriteti Kontraktues sic eshte Grederi Caterpillar 120m viti I prodhimit 2018 I cili ka tonazhen prej 16 ton e 900 kg, ku eshte ofruar nje paisje e re , prodhim I viteteve te fundit , dhe ne kete kuptim do te duhej te merrej si positive per realizim te projektit pasi qe nuk perben asnje ndryshim negative material te dosjes se tenderit, dhe do te duhej po ashtu te cilesohej si devijm I vogel.
OE Sallahu Shpk & Salillari ka ofruar edhe nje Greder tjeter Shtese Marka Caterpillar tip 14g viti I prodhimit 2003 . Ne mbeshtetje te provave dhe fakteve te ofruara deshmohet se AK Komisioni Vleresues I ketij tenderi , ka vepruar ne kundershtim me nenin 59 te LPP-se duke na eliminuar nga procedura e prokurimit pavaresisht se eshte permbushur kerkesa ne fjale sic deshmohet edhe nga provat dhe argumentet e bashkangjitura, andaj bazuar ne qellimin,ekonomicitetin dhe efikastitetin e procedures, ne drejtim te ruajtjes se buxhetit , kerkojme nga OSHP qe te i konstatoje si devijime te vogla.

Pretendimi nr. 2
Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundershtim me nenin 40.3 te Rregullores nr 01/2022 per Prokurim Publik duke shkelur afatet ligjore te vleresimit te tenderit dhe nxjerrjes se njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.
Duke qene se afati i fundit per dorezimin e tendereve ka qene data 04.05.2023 Me datë 29.12.2023 eshte publikuar Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues . Pra , Autoriteti Kontraktues nxjerre vendim per vleresim te tenderit pas 238 dite ne kundershtim me rregullat e prokurimit publik.
Perkatesisht , sipas Rregullores nr 01/2022 per Prokurim Publik , Neni 40.3 thuhet "Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve." Perderisa ne platformen elektronike e-prokurim nuk ka asnje njoftim per tejzgjatje te periudhes se vlerësimit apo arsyetimin lidhur me shkeljen e afateve ligjore.
Po ashtu , Njoftimi i publikuar per rekomandim me kontrata te dt 29.12.2023 ne ora 14:40 minuta, pra kur kanë qenë 4 ditë pushimi/festa zyrtare në vazhdim , dhe afatet kohore per Kerkesen per Rishqyrtim fillojnë te rrjedhin pavaresisht kesaj, këto veprime të Zyrës së Prokurimit konsiderojme se janë ne kundershtim me qellimin dhe parimet e prokurimit publik per transparence ne shfrytezimin e fondeve publike, ku këto veprime jane ndermarre per te "ngulfatur"transparencën, dhe per t'u pamundësuar operatoreve ekonomik njoftimin lidhur me procesin e vleresimit te tendereve(qe do te elaborohet ne pretendimin si me poshte) .

Pretendimi nr. 3

Duke qene se Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues eshte publikuar me date 29.12.2023 ne ora 14;40 nje ore para perfundimit te orarit te rregullt te punes, dhe duke qene se ne vazhdim kane qene 4 dite pushimi/festa zyrtare ne vazhdim, dita e Merkure dt 03.01.2023 ka mbetur dita e fundit per ''realizuar qasjen '' ne dokumentet mbi te cilat eshte bere vleresimi dhe rekomandimi me kontrata ,ku po kete dite ka qenë edhe afati i fundit per te paraqitur Kerkesen per Rishqyrtim .

Te gjitha keto veprime ne drejtim te cenimit te transparences, jane ne kundershtim me Kodin Etik te Prokurimit Publik dhe dispozitat e detyrueshme, te ndermarra me qellim per t'i pamundesuar operatoreve ekonomik qasje ne dokumente , ku keto veprime shtojne edhe me teper dyshimet per shkelje dhe keqperdorime.

Grupi I Operatoreve Ekonomik Sallahu Shpk & Salillari me date 03.01.2023 ka parashtruar Kërkesë me shkrim për qasje në dokumente konform LPP-së drejtuar Zyrës së Prokurimit pranë MMPHI në platformën elektronike e-prokurim. Dhe ne ora 12:00 na eshte mundesuar qasje ne dokumentacion, qasje te cilen e konsiderojme te pjesshme sepse ne lidhje me Operatorin Ekonomik te rekomanduar per Për Lot 2 : OE Empreus Shpk, Jaha Company Shpk , Premium Ks, Tofior, NNT ABC,Metag Insaat Ticaret nuk na jane ofruar dokumentet bazike mbi te cilat eshte bere vleresimi dhe rekomandimi me kontrate , ku pa asnje Vendim per klasifikim te dokumenteve nga Autoriteti Kontraktues jane fshehur të gjitha dokumentet mbi kapacitetin teknik,financiar dhe profesional, dhe dokumente te tjera te cilat nuk janë kerkuar fare te jene si sekret afarist perfshire edhe Formularin e Dorezimit te Tendereve. Ne baze te nenit 11 par 3 te LPP-se thuhet se Autoritetet Kontraktuese mund te i klasifikoje informatat e tjera si secrete afarsite vetem nese informata perkatese i permbushe keto tri kritere :

3.1 qe ate ta kete derguar nje operatore ekonomik ne perputhje me kerkesen e përcaktuar nga Autoriteti i tille kontraktues sipas nenit 68 ose 69 te ketij ligji 3.2 qe operatori perkates ekonomik t'I kete derguar Autoritetit Kontraktues kerkesen me shkrim duke shprehur deshiren e tij qe Autoriteti Kontraktues t'I mbaje artikujt e tille si sekret , dhe

3.3 kerkesa e tille me shkrim te permbaje nje deklarate me shkrim (i) ne te cilen vërtetohet se nje element I tille nuk eshte prone publike, dhe se te dhenat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qellimshem apo nga pakujdesia dhe (ii) me te cilen parashtrohen arsyet qe bindshem demonstrojne , sipas gjykimit te arsyeshem te autoritetit kontraktues se qasja publike ne lementin e tille do te rezultonte ne demtim material te interesave legjitime komerciale te operatorit te tille ekonomik. AK nuk na ka ofruar qasje ne dokumente te operatorit te rekomanduar per LOT 2 ne kundershtim me nenin 10 dhe 11 te LPP-se duke fshehur dokumentet bazuar ne nje "Kerkese per Sekret afarsit " te OE e cila nuk I permbushe fare kushtet ligjre sic percaktohet me par 3 te nenit 11 te LPP=se/ Sipas nenit 7.6 par 3 te Rregullores nr 01/2022 per Prokrurim Publik thuhet se '' duhet dhene arsyetimet per secilin document te identifikuar si sekret afarsist' Ne Kerkesen per Sekret Afarsit nuk eshte ofruar asnje arsye qe bindshem do te demonstroje se qasja ne dokumente publike do te rezultonte ne demtim material te interesave legjitime komerciale te operatorit ekonomik. Operatori Ekonomik nuk ka vertetuar se nje element I tille nuk eshte prone publike, kushte keto te cilaat percaktohen shprehimisht me par 3.3 te nenit 11 te LPP-se. Pra, kerkese per sekret afarsist (dhe fshehje te dokumenteve) eshte bere edhe per dokumente qe ne fakt cilesohen si prone publike , sic

jane psh Kontratat Publike me liste te Kontratave te cilat operatori fitues I ka te lidhura me insititucionet publike , pra deshmohet se jane fsheur dokumente ne menyre te kunderligjshme , shto ketu faktin se Kontratat e realizuara ne 3 vitete e fundit kane qene edhe nje nder kriteret e dhenies se kontrates me pike poentimi , pamundesia e qasjes se keto dokumente
te cilat ligjerisht do te duhej te kishim qasje , paraqet qartazi shkelje te nenit 10 dhe 11 te LPP-se, dhe shton edhe me teper dyshimet se OE I rekomanduar nuk e ka plotesuar kete kerkese. Cdo kontrate e lidhur me institucionet publike , ne kete rast Autoritetet Kontraktuese ka titullin KONTRATE PUBLIKE ,dhe eshte prone publike.

Numri i Prokurimit: 205 23 1843 511– Titulli : Zgjerimi i rrugës nacionale N[illegible]-Segmenti Kijevë-Dollc, Loti 1,2,3,4

Aneksi 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**
(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE ***EMPREUS SH.P.K*** (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara:

1. KAPACITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR.
2. KAPACITETIN TEKNIK DHE PROFESIONAL.
3.LISTA E KONTRATAVE (KONTRATAT, REFERENCAT RAPORTET PERFUNDIMTARE).
4. LISTA E PUNETOREVE (DESHMIT E MARRA NGA A.T.K).

5. LISTA E PAISJEVE AKTI (DOKUMENTACIONI I PAISJEVE, DUDE DOGANORE, FATURE, LIBREZE QARKULLIMI).
6. PARAMASA DHE PARALLOGARIA.

7. MBESHTETJA BANKARE E DORZUAR

8. LISTA E ING-VE DHE GJITHË DOKUMENTACIONI I ING-VE

9. MARRVESHJET E DOREZUARA

Të nenit 69 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese

Deklaratë mbi natyrën e dëmit të tillë material dhe arsyet pse do të duhej të shfaqet:

Me respekt kërkojmë që dokumentacioni i lartëpërmendur i dorëzuar me këtë ofertë të mbahet konfidencial, pasi zbulimi i tyre publik do të shkaktonte dëme të konsiderueshme tregtare për kompaninë tonë. Ne e kuptojmë se ky informacion mund të duhet të ndahet me zyrtarët përkatës të Autoritetit Kontraktues për qëllime të vlerësimit të kësaj oferte, por kërkojmë që ai të trajtohet si pronë e kompanisë dhe të mos vihet në dispozicion të publikut ose palëve të tjera të treta.

Zbulimi i dokumenteve të tilla mund të zbulojë sekrete tregtare dhe informacione pronësore që kompania jonë nuk do të dëshironte të ndahesh

Po ashtu, jane fshehur edhe dokumente te cilat ne asnje menyre dhe rrethane nuk dëmtojnë interesat biznesore sic jane stafi I prezaantuar , pasijet e ofruara per realizim te projektit, pastaj FORMULARI I DOREZIMIT TE TENDERIT, qe nuk eshte fshehur asnjehere , ofrojne arsye te bindshme se AK ka kufizuar qasjen ne dokumente ne kundershtim me Nenin 10 dhe 11 te LPP-se.
Pretendimi nr. 4

Për Lot 1 eshte rekomanduar OE R&Rukolli; SABA BELCA Dega në Kosovë ;ELMAZAJ KONSTRUKSION; Tekno-Konstrukt SH.P.K , OE eshte i pa përgjegjshëm per faktin se :

Pavaresisht kohes se shkurter per kontrollimin e dokumentacionit te ketij OE te rekomanduar me Lot 1 , kemi verejtur shume mangesi ne Dosjen e te njejtit per cka I njejti do te duhej te shpallej I pa pergjegjshem dhe te eliminohet nga procedura e prokurimit., dhe jo te rekomandohet me kontrate.

4.1.OE eshte I pa pergjegjshem per faktin se ka deshtuar te plotesoje Kerkesen nr 7 te Dosjes se Tenderit qe te jete i Licencuar per prodhimin e Asfaltit . Ku ka ofruar nje marreveshje bashkepunimi me SB Construction , ku ne Licencen e te njejtit shihet se e njejta ka skaduar me dt 18.04.2023 , perderisa ofertimi ne tender eshte bere me dt 04.05.2023 .

Prove e keni licencen e skaduar te te njëjtit



Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Neodvisna Komisija za Rudnike i Minerali
Independent Commission for Mines and Minerals

LEJE PËR AKTIVITETET E VEÇANTA
DOZVOLE ZA POSEBNE AKTIVNOSTI / SPECIAL OPERATIONS PERMIT
556/KPMM/2018

Emri i Biznesit / Naziv Biznisa / Name of business:	"SB CONSTRUCTION" SH.P.K.
Nr. i Biznesit / Br.Biznisa / Business No:	3017787
Nr. i Regjistrit / Br.Registrirja / Registration No:	173
Pronar i Biznesit / Vlasnik Biznisa / Business Owner:	Valon Etemi
Koha/Afati / Trajanja / Duration:	18.04.2023
Emri i vendit / Ime mesta / Site name:	Allingaçe
Komuna / Opština / Municipality:	Obiliq

Sipërfaqja / Površina / Surface area: 10633.81 m²
Leje për / Dozvola za / Permit for:
baza e asfaltit / asnovna za asfalt / asphalt base

Të drejtat dhe detyrimet / Prava i obavezze / Rights and obligations:

- Kompania obligohet që t'i plotësojë kushtet e bëjnë Leje dhe obligohet të plotësojë detyrimet sipas nenit 41 të Ligjit për Minoritet dhe Minerale nr. 03/L-163 si dhe me Ligjin nr. 04/L-158 Për Plotësimet dhe Ndryshimet e Ligjit nr. 03/L-163 për Minoritet dhe Minerale.
- Kompanisë ju duhet ta ai pëlleftësi sulmet me Dinamit, i nakthëjë si do hapësi mënjë shënimi ta Nenit 41 Zakona o Rudnicima i Mineralima br. 03/L-163 kao i Zakonu br. 04/L-158 za Poznavanje i Dopune Zakona br. 03/L-163 za Rudnike i Minerale.
- Company is obliged to comply with the terms of this Permit and is obliged to fulfill its obligations under article 41 of the Law on Mines and Minerals no. 03/L-163 and the Law no 04/L-158 on Amending and Supplementing the Law no. 03/L-163 on Mines and Minerals

No. Fletë / Br. Ferd / Pred. No: 1284
Datë / Datum / Date: 30.04.2018

.Pikerisht per mos plotesimin e nje kerkese te tille , Sallahu Shpk ishte eliminuar nga procedura e prokurimit te tenderi me titull ‘’ Sanimi I deformimeve te paraqitura ne rrugen Nacionale N2 perkatesisht ne rrugen lidhese te mbikalimi ne Babimost me numër prokurimi 205-21-5311-5-2-1, te dhena te cilat mund te verifikohen edhe nga e-prokurimi.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës/ Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture

Letër standarde për tenderuesin e eliminuar

Prishtinë 20.10.2021

Operatori Ekonomik: "SALLAHU" SH.P.K., Rr.Baki Dullovi Nr.158, 71000, Kaçanik, Kosovë

Nr. i prokurimit:	MMPHI	2	1	0	4	0	5	2	1

Titulli: Sanimin e deformimeve të paraqitura në rrugën Nacionale N2 përkatësisht në rrugën lidhëse të Mbikalimi në Babimost

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, siç citohet në vazhdim "LPP ", indryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligji Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Operatori Ekonomik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ne Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne piken 8. OE duhet te jete i licencuar leje per aktivitete te veqanta për prodhimin e bazës se asfaltit, prodhimin e bazës se betonit dhe OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes zhavorr. Dëshmia 8- Kopja e licences lejesper aktivitete te veqanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marreveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit. OE ka ofruar marrveshje bashkëpunimi me SA-SALLAHU SHPK per licencat e asfaltit, betonit dhe gurëthyesit zhavorrit te cilat janë te skaduar me date:27.04.2021.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar ne Nenin I të këtij Njoftimi për dhënie të kontratës.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,
Nexhat Krasniqi
(Nënshkrimi)

Autoriteti Kontraktues ne refuzimin pretendimit ankimor ndaj '' OE Rukollit '' thote se : '' OE ka prezantuar te gjitha deshmite apo marreveshje per furnizim qe kane te bejne me posedimin e lejeve per aktivitete te vecanta, por ne mungese te funksionimit te bordite qe bene leshimin e ketyre lejeve OE nuk ka mundur te bejne vazhdimin edhe pse kane bere kerkesa me kohe per vazhdimin e te njejtave ''

Por ky eshte konstatim krejtesisht I gabuar , sepse edhe ne si OE kur kemi ofertuat ne tenderin per te cilin jemi eliminuar per licencat , kemi pasur te dorezuara kerkesat per vazhdim sic kerkohet me Ligj per Miniera dhe Minerale 2 Muaj para skadimit, dhe po ashtu kemi percjellur te Zyra e Prokurimit edhe nje Njoftim shtese nga KPMM te dt 30.09.2023 ku madje ishte konstatuar se kerkesat per vazhdim jane dorezuar, se dokumentacioni eshte i kompletuar por bordi nuk ka qene funksional .

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals

DATË	**Prishtinë, 28.09.2021**
PËR	**Ndërmarrjen " Sa-Sallahu " sh.p.k- Rr. Baki Dullovi nr. 158 , Kaçanik**
NGA:	**Ramiz Krasniqi – Drejtor Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale**
LENDA:	**Përgjigjeje ne kërkesën tuaj numër 6330 data 27.09.2021**

I nderuar Z. Sallahu,

Komisioni i Pavarur për Minierat dhe Mineralet ka pranuar një kërkesë nga ndërmarrja "Sa-Sallahu" sh.p.k-Kaçanik, me nr. prot . 6330 data 27.09.2021, përmes së cilës ndërmarrja ka kërkuar nga KPMM –ja që të ju mundësohet lëshimi i një dokumenti "si dëshmi më rastin e ofertimit në tenderë", më arsyetimin se ndërmarrjes nuk i "ndërpritet operimi me prodhimin e bazës së asfaltit, betonit dhe zhavorrit", pasi që janë të kompletuar me dokumentacion për licencim.

Komisioni i caktuar me vendim të drejtorit e ka shqyrtuar kërkesën tuaj dhe në bazë të dhënave që kemi në KPMM e vërtetojmë se ndërmarrja "Sa-Sallahu" sh.p.k-Kaçanik ka pasur tri leje për aktivitet të veçanta të lëshuara nga KPMM-ja, të cilave iu ka skaduar afati i vlefshmërisë me datën 27.04.2021. Më datë 24.02.2021 , ndërmarrje ka aplikuar për vazhdimin të lejeve përmes kërkesave 1149,1150 dhe 1151. Andaj konstatojmë së kërkesat janë në procedurë të shqyrtimit dhe të njëjtat janë të kompletuara me dokumentacion, mirëpo ende nuk janë të aprovuara nga bordi i KPMM-së ngase Kuvendi i Republikës së Kosovës ende nuk e ka zgjedhur bordin e ri.

Shqyrtimi i aplikacioneve të parashtruara nga palët në KPMM- bëhet në pajtim me Ligji nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale.

Ligji nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale në nenin 59 paragrafi 1 përcakton se:

" ... Të gjitha kompetencat e KPMM ushtrohen nga Bordi. Çdo vendim i cili sipas këtij ligji kërkohet të merret nga KPMM duhet të merret nga vetë Bordi i KPMM."

Bazuar në sqarimet e më sipërme, ndërmarrja është e kompletuar me dokumentacion mirëpo pritet aprovimi nga Bordi për të u pajisur me leje për Aktivitete të veçanta.

Ramiz Krasniqi,
Drejtori
Komisioni i Pavarur për Minierat dhe Mineralet

Rr. Armend Disci Nr.1
Prishtinë, Kosovë

Pergjigja e Autoritetit Kontraktues ka qene kjo (te cilen mund ta verifikoni edhe ne eprokurim)
''Pas shkreseses se KPMMse te dt 30.09.2021 nuk konfirmohet se ju jeni te paisur me licencat e asfaltit,betonit dhe gurethyesit , apo qe ju mund te operoni deri ne vazhdimin e licneces se re, prandaj konsiderojme se ju nuk e keni plotesuar kushtin e Dosjes se Tenderit sipas Kerkesat mbi mundesite tekniike dhe/ose profesionale. Andaj AK eshte I ndaluar qe te perdore standarde te dyfishta te vleresimit, dheduhet t'a eliminoje njesoje edhe OE R&Rukolli; SABA BELCA Dega në Kosovë ;ELMAZAJ KONSTRUKSION; Tekno-Konstrukt SH.P.K
4.2.Edhe sa I perket kapacitetit Teknik dhe profesional , perkatesisht Inxhinereve ky OE I ka me mangesi dhe nuk I ploteson kerkesat e percaktuara ne DT dhe Njoftim per Kontrate.
P.sh Menaxher te projektit e ka ofruar Ragip Behrami ku I njejti nuk ka me nje kontrate valide per shkak se I ka skaduar me 31.12.2023 , por ajo se cfare e bene kete kontrate jo valide eshte edhe fakti se ne Kontrate Ref 01/2023 thuhet se e njejta u nenshkrua me date 03.01.2023 ne Skenderaj , te ciles I

eshte bashkangjitur nje Vertetim neneshkrimi – Akt noterial I dates 18.04.2023 ku Noteri thote se '' nenshkrim I I meposhtem eshte vene ne dokumentin privat te quajtur Kontrate pune per kohe te pa tacktuar , Ref H017/2023 e dt 01.01.2023 .

Pra shohim se kemi te bejme me dokument fiktiv , per faktin se nuk ka as datat e njëjta dhe as nuk I referohet kontrates se njejt , por me numer referencash te ndryshme.

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

Ref: 01/2023

KONTRATË PUNE
PËR KOHË TË CAKTUAR

(Vazhdim)

Neni 1

Me këtë Kontratë: **R&Rukolli SH.P.K.** me seli në Skenderaj, adresa Rr. 18 Qershori, me **Numër Unik Identifikues 810618366**, me pronar **z. Rrustem Rukolli** (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë kontratë pune me: **z. Ragip Behrami,** i lindur me 03.03.1980, me nr. personal **1008558244**, kualifikimi profesional **Inxhinier i Ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv**, adresa e vendbanimit lagja Arbëria Prishtinë, (në tekstin e mëtejshëm: I punësuari).

Neni 2

punësuari do të kryej këto detyra të punës:
Menaxher projektesh të ndryshme ndërtimi. *Detyrat dhe përgjegjësitë janë:*
PËRSHKRIMI I PROCESIT TË PUNËS – NIVELI III

1. **Detyrat dhe përgjegjësit për Pozitën Menaxher:**
- Drejton dhe menaxhon punishten sipas politikave të ndërmarrjes
- Përcakton prioritetet e punëve për punëtorët dhe punishtes, sipas rregullores së ndërmarrjes,
- Zbaton kërkesat që dalin nga dokumenti i vlerësimit të rrezikut dhe ndihmon në respektimin e tyre nga punëmarrësit,
- Ngarkohet do të Administroj një Baze Qendrore të Dhënash të Riskut. Ndihmon për organizimin e grupit të punës për vlerësimin e risqeve që krijohen nga rreziqet e zbuluara të raportuara dhe për miratimin e masave të duhura parandaluese dhe korrigjuese. Masat duhet të zbatohen në të gjitha vendet ose veprimtaritë e ngjashme të punës ku mund të ekzistojnë rreziqet.
- Ka përgjegjësi për të dhënë reagime tek punëmarrësit të cilët paraqesin gjetjen e një rreziku, duke trajtuar dhe japë informacionin mbi rreziqet.
- Ka përgjegjësi që të mbledhë informacion në lidhje me rreziqet i cili merret në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullave, për të vlerësuar risqet, të miratojë masa të përshtatshme dhe t'i zbatojë ato për të gjitha rastet e ngjashme.
- Informacioni i punonjësve duhet të ofrohet për të gjitha rreziqet dhe risqet përkatëse, si dhe informacioni për masat e marra në kohë të përshtatshme – në përputhje me urgjencën së informacionit ose veprimet e nevojshme. Kjo do të behet qysh nga dita e parë e fillimit të punimeve nga punëtor të rinjë dhe ata në proces pune.
- Projektimin i organizimit dhe dizajnimit të brendshme dhe të jashtëm sipas politikave të ndërmarrjes
- Mbikqyrja e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe analizimit i rreziqeve në hapësira dhe vende pune,
- Trajtimi dhe zgjidhja e problemëve gjatë fazave të operative të ndërmarrjes
- T'i planifikoj dhe organizoi:
- Radhitja e makinave sipas procesit të punimeve,
- Racionalizimi i mjeteve dhe i sendeve të punës,
- Implementimi i standardet e punës dhe cilësisë,

Neni 9

ë punësuarit i ndërpritet marrëdhënia e punës nga punëdhënësi, nëse:

1) ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;
2) i punësuari nuk është më i aftë të kryejë detyrat e punës;
3) në rastet e rënda të sjelljes së keqe të të punësuarit;
4) për shkak të mospërmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës, dhe
5) për rastet e tjera të cilat janë përcaktuar me Ligjin e Punës.

Neni 10

punësuari është i detyruar t'iu përmbahet masave të caktuara të mbrojtjes në punë.

Neni 11

Punëdhënësi dhe i punësuari i pranojnë të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e caktuara me këtë Kontratë.

Neni 12

Për kontestet eventuale të moszbatimit të kësaj Kontrate, palët kontraktuese e pranojnë kompetencën e Gjykatës Kompetente në Skenderaj.

Neni 13

Secila palë mund ta shkëpusë këtë Kontratë në mënyrë të njëanshme, sipas kushteve dhe rasteve të caktuara me Ligj.

Neni 14

Pas njoftimit me përmbajtjen e Kontratës, kjo Kontratë nga palët kontraktuese u nënshkrua më datën: 03.01.2023, në Skenderaj, në dy (2) kopje autentike, nga të cilat, secilës palë i mbetet nga një kopje.

Punëdhënësi:
R&Rukolli,SH.P.K.

I Punësuari:
Ragip Behrami

Republika e Kosovës
NOTER
ZYFER ALIU
LIPJAN

LRP.4885/2023

----------Vërtetim nënshkrimi----------

Sot, më date **18.04.2023**(tetëmbëdhjetë prill dymijë e njëzet e tre) para meje, Zyfer Aliu, Noter me seli në Lipjan ,Rruga" Lidhja e Prizrenit" p.n , vërteton se:----------

Nënshkrimi i mëposhtëm i vënë në dokumentin privat të quajtur **"Kontratë pune për kohë të caktuar"** , Ref.:H017/2023 e dt.01.01.2023 është vënë nga:----------

1.Z.Agim Rukolli, i lindur në F.Rezallë-Skenderaj , më **23.07.1986**(njëzet e tre korrik njëmijë e nëntëqind e tetëdhjet e gjashtë) ,me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, shtetas i Republikës së Kosovës, identiteti i të cilit konstatohet nga letërnjoftimit me nr personal **1172382769** i lëshuar nga MPB Prishtinë më dt. 09.02.2022 valid gjerë më 08.02.2032, madhorë me zotësi të plotë veprimi(Përfaqësuesi i **"R&Rukolli " sh.p.k**).----------

2.Z.Ragip Behrami i lindur në Skenderaj , më **03.03.1980**(tre mars njëmijë e nëntëqind e tetëdhjet) ,me vendbanim të përhershëm në Skenderaj, shtetas i Republikës së Kosovës, identiteti i tij i konstatohet nga letërnjoftimit me nr personal **1008558244** i lëshuar nga MPB Prishtinë me dt. 19.09.2019 valid gjerë më 18.09.2029, madhorë me zotësi të plotë veprimi.----------

Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e dokumentit të përpiluar jashtë zyrës së tij, noteri vetem vërteton nënshkrimin e palës të vënë në praninë e tij dhe në zyrën e tij ----------

Ky akt është paguar sipas UA mbi Tarifat noteriale me nr. 05/2022 , Neni 31.1 dhe 2 për çdo nënshkrim 1€ për persona fizik dhe 7€ për persona juridik=6 nënshkrime = 9€+1€ për vendosjen e vinjetës (Neni 42.2 i TN-së)=10+18%TVSH=11.80€ (njëmbëdhjetë e 80/100).----------

Veprimi i noterizimit u krye në Lipjan, më dt.18.04.2023(tetëmbëdhjetë prill dymijë e njëzet e tre) në selin e Noterit Zyfer Aliu në adresën e lartshënuar.----------

NOTER
Zyfer Aliu

4.3.Se I njejti ka paraqitur dokumente fiktive e deshmon edhe fakti se ka prezantuar veprime te tilla te kontratave psh ing Avdi Citaku , ku kontrata thuhet se eshte nënshkruar me 04.01.2023 , ndersa vertetim nenshkrimi I aktit notarial eshte I dates 20.04.2023.

Neni 8

I punësuari është përgjegjës për kompensimin e dëmit për punën ose në lidhje me punën, nëse me qëllim ose nga pakujdesia i ka shkaktuar dëm punëdhënësit.

I punësuari është përgjegjës edhe për shfrytëzimin e mjeteve ose asketëve të ndërmarrjes pa autorizim paraprak të punëdhënësit, keqpërdorimit të emrit apo logos së ndërmarrjes si dhe për shpalosjen apo mos konfidencialitetin e nevojshëm në përputhje me rregullat e brendshme të ndërmarrjes.

I punësuari është përgjegjës edhe për kompensimin e dëmit, nëse me fajin e tij i ka shkaktuar dëm palës së tretë, dëm për të cilin punëdhënësi e ka kompensuar të dëmtuarin.

Neni 9

Të punësuarit i ndërpritet marrëdhënia e punës nga punëdhënësi, nëse:

1) ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;
2) i punësuari nuk është më i aftë të kryejë detyrat e punës;
3) në rastet e rënda të sjelljes së keqe të të punësuarit;
4) për shkak të mospërmbushjes së kënaqshme të detyrave të punës, dhe
5) për rastet e tjera të cilat janë përcaktuar me Ligjin e Punës.

Neni 10

I punësuari është i detyruar t'iu përmbahet masave të caktuara të mbrojtjes në punë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË PUNËS – NIVELI III

Detyrat dhe përgjegjësit për Pozitën Menaxher/ Inxhinier:

- Drejton dhe menaxhon Njësinë Punuese sipas rregullave të SSHP-së dhe politikave të kompanisë;
- Punëtoret e pranuar për herë të parë i paraqet në administratë për lidhje kontrate, paraqesin Certifikatën e mjekut se është i aftë për punë, pastaj vazhdon trajnimin lidhje me SSHP, pajisen me udhëzime të nevojshme lidhje me sigurinë teknike, PPM dhe fillon me punimet sipas kontratës;
- Përcakton prioritetet e punëve për punëmarrësit sipas rregullores së kompanisë;
Pretendimi Ankimor nr. 4 - Neni 11 i LPP-së Informatat sekrete afariste: 11.4. Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e "pastruar" të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste. - Pas kërkesës sonë për qasje ne DT te ofertuesve te shpallur fitues, AK-

MMPHI, na i ka dorëzuar dosjet e tenderit te ofertuesve te shpallur fitues për Llot-1, 3 dhe 4. Ndërsa për Lot-2 nuk e ka ofruar dokumentacionin e kërkuar – dëshminë e ofertuesve te shpallur fitues (përveç disa dokumenteve jo relevante). - AK-MMPHI bazuar ne piken 11.4 te Nenit 11- Informatat sekrete afariste, është dashur qe te "pastroje" informatat te cilat mund te konsiderohen si sekret afarist - Për shembull: - Vlera monetare e blerjes se makinerisë mund te konsiderohet sekret dhe si e tille mund te "pastrohet" nga ana e AK, por jo edhe te dhënat teknike për makineri dhe sidomos Marka dhe Tipi. Sepse, për shembull kriteri i peshës është bërë tashme publik nga ana e AK me rastin e publikimit te Vendimit ta AK (duke i publikuar peshën e grejderëve) - Dëshmitë për Inxhinieret dhe menaxherin mund te "pastrohen" nga shënimet personale (shembull: ditëlindja, nota mesatare gjate studimeve, numri personal) mirëpo Titulli i fituar, data e diplomimit, Institucioni qe e ka lëshuar dëshminë, etj nuk mund te konsiderohen sekret afarist, sepse ato janë kërkesa qe përdoren nga AK për vlerësimin e ofertës dhe rrjedhimisht duhet te kemi qasje ne to ne mënyrë qe te informohemi se ofertuesi i shpallur fitues i ka përmbushur kriteret apo jo!

Pretendimi Ankimor nr. 5 - Neni 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Sipas nenit 59 paragrafi 4 te LPP-së, citat neni "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. - Për Llotin-1 AK ka eliminuar ofertën tone edhe pse ne Vendimin për eliminim neve jemi shpallur te përgjegjshëm dhe me te lire se oferta e shpallur fituese. Është jo logjike dhe gjithsesi e kundërligjshme qe oferta shpallet e përgjegjshme dhe njëkohësisht te eliminohet duke na dërguar Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar. Vendimi i tille është kontradiktor dhe i kundërligjshëm. Rrjedhimisht oferta jone për Lotin-1 duhej te shpallej fituese. 5.1 Pretendimi ankimor ne raport me oferten tonë te GOE Granit SH.P.K.; K.N.P.SH. PAPENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K, për Lot 1 për shkelje te nenit 59 te LPP-së. - AK-Ministria e Infrastrukturës, përkatësisht komisioni i vlerësimit dhe zyra e prokurimit ka bërë shkelje te rëndë te nenit 59 te LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, duke përdorur standarde te dyfishta te për arsyet ne vijim: - Ne raportin e vlerësimit tek arsyeshmëria e dhënë për ofertën tonë si GOE "Granit SH.P.K.; K.N.P.SH. PAPENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K, operatoreve ekonomik thuhet " si i tillë OE është i përgjegjshëm vetëm për Lot 1 pasi i plotëson kërkesat e përcaktuara ne DT dhe Njoftimit për Kontratë, kurse për Lot 2,3,4 është i pa përgjegjshëm pasi nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara ne DT. I njëjti arsyetim është i shkruar edhe ne Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar qe kemi pranuar me dt. 29.12.2023. Për me shumë referoju Raportit te Vlerësimit dhe Letrës Standarde për Tenderuesin e Eliminuar.

15.	Grup i Operatorëve Ekonomik Granit SH.P.K.; K.N.P.SH. PAPENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K.	Në Listen e Paisjeve është kërkuar Pika 10. Grejder 12-16t, janë kërkuar 3 Grejdera. Ndërsa Operatori ka ofruar 4 grejdera, 2 prej të cilëve e tejkalojn kapacitetin e kërkuar: 1 Grejder me kapacitet 16,2 t. 1 grejder me kapacitet 18 t, 1 grejder me kapacitet 14,88 t, Ndërsa për pajisjen nr.4 (Faun 105) ka ofruar kontratë të shit/blerjes pa të dhëna mbi peshen e pajsijes, mirpo pas hulumtimit ne Internet ,komisioni I vlersimit konstaton se Grederi Faun 105 ka peshen prej 12.400 kg. dhe si I till OE eshte I pergjegjshem vetëm ne Lot-1 pasi plotson kerkesat e percaktuara ne DT dhe Njoftimit per kontrate. Kurse ne Lot- 2. Lot- 3, dhe Lot-4, OE eshte I pa pergjegjshem pasi nuk arrin të plotësoj kërkesat e përcaktuar në DT.

Ne si GOE: Granit SH.P.K.; K.N.P.SH. PAPENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K, pjesëmarrës ne ketë aktivitet te prokurimit nuk e kemi te qartë dhe nuk kemi hasur asnjëherë ne një rast te tillë se për një Lot (pjesë) një operator ekonomik te shpallet i përgjegjshëm ndërsa ne anën tjetër për te njëjtin Lot (pjesë) te shpallet fitues një operator ekonomik qe ka çmim dukshem me te shtrenjtë. Bazuar ne vlerësimin e Autoritetit Kontraktues neve do te duhej te na dërgohet letra standarde për tenderuesin e suksesshëm për Lot 1, pasi qe jemi te përgjegjshëm ne ketë Lot (pjesë). Shkelje tjetër e rëndë e komisionit te vlerësimit dhe e zyrës se prokurimit ka te beje me përgatitjen e raportit te vlerësimit sepse nuk është bërë krahasimi i ofertave ne harmoni me nenin paragrafin 5 te nenit 52 te LPP-së, i cili thotë: " Në rast të kriterit tenderi ekonomikisht më i favorshëm është e detyrueshme që të konvertohet çdo element i kritereve të dhënies në pikë dhe më pas të peshohet në bazë të formulës dhe peshave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe Dosjen e Tenderit." Po ashtu gjatë përgatitjes se raportit te vlerësimit nuk është zbatuar neni 27.9 i Rregullores 001/2022,per Prokurim Publik , i cili thotë: " Tenderët duhet të vlerësohen objektivisht dhe në mënyrë transparente krahas kritereve të peshuara të publikuara. Objektiviteti dhe transparenca arrihet në mënyrën më të mirë me përdorimin e sistemit të vlerësimit me pikë ose shënimeve të pikëve të vlerësuara bazuar në kriteret e peshuara, që tregojnë një vlerësim krahasues të tenderëve nën secilin kriter". Ne rastin tonë edhe pse jemi shpallur si ofertues i përgjegjshëm për Lot 1 , AKMinistria e Infrastrukturës nuk na ka njoftuar asnjëherë me piket e marra tek secili nen kriter sipas nenit 27.9 te Rregullores për Prokurim Publik. Përshkrimin e bërë me sipër e dëshmojmë me tabelën e poentimit ne raport te vlerësimit ku shihet se AK-Ministria e Infrastrukturës , ka vendosur vetem pikët totale dhe ato vetëm për Operatoret Ekonomik te rekomanduar për Kontratë, shih ne vijim:

	OE	Loti	Poenat
1	R & Rukolli; SABA BELCA Dega në Kosovë; ELMAZAJ KONSTRUKSION; Tekno - Konstrukt SH.P.K.	Lot-1	89.21
2	EMPREUS SH.P.K.; JAHA COMPANY sh.p.k.; Premium - ks SH.P.K.; Toifor Sh.p.k.; NNT ABC SH.P.K.; METAG INŞAAT TICARET A.Ş.	Lot-2	90.24
3	,,Lika Trade Sh.p.k.; TOFI doo; Lika Company SH.P.K.	Lot-3	91.43
4	FAMIS CO-HC SH.A; KIT-AK, Gradnje, d.o.o.; KAG - Asphalt Company SH.P.K.	Lot-4	82.63

Nga kjo tabelë nuk mund te shihet vlerësimi krahasues i tenderëve përmes peshimit qe kërkon paragrafi 5 i nenit 52 te LPP-së dhe nenit 27.9 i Rregullores për Prokurim Publik. - Nga kjo mostransparence lindin shumë pyetje dhe dyshime rreth procesit te vlerësimit te bërë nga AK-Ministria e Infrastrukturës , dhe pse ka nevojë te mos vendoset piket për secilin operator ekonomik te përgjegjshëm dhe për secilën nen kategori ashtu siç kërkohet. - Ne rastin tonë edhe pse jemi shpallur te përgjegjshëm ne Lot 1 , nuk kemi pranuar poentimin e ofertës sonë ne raport me ofertuesit e tjerë. - Komisioni i vlerësimit dhe zyra e prokurimit e AK-Ministria e Infrastrukturës duke mos vendosur piket e peshuara për secilin operator ekonomik te përgjegjshëm ka bërë edhe shkelje te nenit 44 te Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik Formularit Standard te vlerësimit , sepse nuk ka përdorur formularin përkatës te peshimit te pikëve për secilin nen kriter. 5.2 Pretendimi ankimor ne raport me oferte tonë te GOE Granit SH.P.K.; K.N.P.SH. PAPENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K, për Lot 2,3, 4 për shkelje te nenit 59 te LPP-së. - Bazuar ne Njoftimin e vendimit te AK, oferta jone është eliminuar për Llotet -2, 3 dhe 4 me pretekstin se një (1) grejder i ofruar ka peshe 16,2 tona! Sa i përket grejderëve, ne DT janë kërkuar 3 cope, ndërsa neve kemi ofruar 4, prej te cilëve 3 cope janë sipas kërkesës se DT ndërsa i katërti është opcional. D.m.th. si GOE jemi te përgjegjshëm edhe për Lotet 2, 3 dhe 4. - Për Llot-4 AK-Ministria e Infrastrukturës ka rekomanduar për dhënie me ofertën me e GOE me çmim dukshem me te larte se sa oferta jone. Oferta e shpallur fituese është me shtrenjte se oferta jone për 320,482.64 Euro. - Pos kësaj, ofertuesi i shpallur fitues për Llot-4 tek dëshmitë e makinerisë (Grejder, ngarkues, cilindra, dozer, eskavator, etj) te partnerit ne konzorcium KIT-AK Gradjnje doo Slovenia per dëshmi mbi pronësinë e makinerisë se ofruar nuk ka ofruar deshmite ashtu siç është kërkuar: faturën e blerjes ose Deklaratën Unike Doganore. Dëshmitë e ofruara për disa nga pajisjet nga ky partner nuk janë dorëzuar ne njërën nga gjuhet zyrtare te DT (Shqip, Serbisht, Anglisht). Prandaj dokumentacioni për makineritë e ofruara nga partneri ne konzorcium KIT-AK Gradjnje doo Slovenia, përveç gjuhës nuk mund te pranohet edhe sepse nuk ka ofruar dëshminë e kërkuar mbi pronësinë ashtu siç është kërkuar ne DT. Te gjitha pretendimet ankimor ne raport me ofertën fituese te GOE te rekomanduar për kontratë për Lot 4 do te i trajtojmë me poshtë tek pretendimet ankimore për Lot 4. 5.3.Pretendimi ankimor ne raport me ofertën e GEO R&RUKOLLI & SABA Belca & Elmazaj & Tekno Konstrukt te rekomanduar për dhënie kontrate për

Lot 1 , shkelje te nenit 59 te LPP-së. AK-Ministria e Infrastrukturës gjatë procesit te vlerësimit per Lot 1 ka bërë shkelje të rende te dispozitave ligjore te nenit 59 te LPP-se duke shpërblyer me kontratë Grupin e Operatoreve Ekonomik qe nuk i kanë plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe ne ketë mënyre ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 4 te nenit 59 te LPP-se i cili thotë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". - Pas qasjes ne dokumente zyrtare dhe marrjes se dokumentacionit te GOE R&RUKOLLI & SABA Belca & Elmazaj & Tekno Konstrukt, konstatojmë se ky grup nuk i plotëson kriteret e përzgjedhës te kërkuara nga AK ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontratë , si ne vijim: 1. Sipas kërkesës nr. 9 tek kriteret e përzgjedhës : Kërkesa: 9. OE duhet te jete i licencuar leje për aktivitete te veçanta për prodhimin e bazës se asfaltit, prodhimin e bazës se betonit dhe OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes zhavorr. - Dëshmia 9- Kopja e licencës lejes për aktivitete te veçanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. GOE ka ofruar marrëveshje për furnizim me asfalt me një Kompani qe posedon Baze asfalti, mirëpo Leja për aktivitete te veçanta është e skaduar me 18.04.2023 (nuk e është e vlefshme ne ditën e dorëzimit te tenderit – 04.05.2023). - Ne ketë mënyrë GEO R&RUKOLLI & SABA Belca & Elmazaj & Tekno Konstrukt nuk ploteson kerkesen e DT (leje valide per aktivitete te vecanta ng KPMM). Ofertuesi nuk mund ta dije se kur do te pajiset me leje per Baze asfalti, ngase edhe sot KPMM eshte pa bord. Operimi i bazes se asfalti pa leje valide konsiderohet ilegal sipas Ligjit per Miniera dhe minerale. Rrjedhimisht, AK nuk mund te pranoje lejen e skaduar sikur te ishte valide. - Po ashtu GOE te rekomanduar per kontratë ka ofruar "Marrëveshje për furnizim me zhavorr nga gurthyesi" me një kompani, mirëpo si dëshmi ka ofruar "Licence shfrytëzimi" qe ne fakt është Licence për gurore (shfrytëzim i shkëmbit te forte). Mirëpo, nuk ka ofruar Leje për aktivitete te veçanta për gurthyese (sortues/crusher/sortirac). Kërkesa e DT ka qene për gurthyes zhavorr dhe jo për shkëmb. Pra nga kjo rezulton se GEO i rekomanduar për dhënie kontrate për Lot 1, përveç qe ka ofruar Lejen per Baze asfalti me afat te skaduar, po ashtu nuk e ka ofruar lejen përkatëse per zhavor gurthyes sipas kërkesave te dosjes se tenderit. 2. GEO R&RUKOLLI & SABA Belca & Elmazaj & Tekno Konstrukt, është i pa përgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar pajisjet përkatëse te nevojshme për punët e asfaltit, sipas kërkesave te dosjes se tenderit. 10/23 - Pajisjet e nevojshme për punët e asfaltit janë kërkuar ne dosje te tenderit si ne vijim: - Cilindrat me rrota të kombinuara(gomë dhe hekur), min 6.5 t GEO R&RUKOLLI & SABA Belca & Elmazaj & Tekno Konstrukt ka ofruar: - AMMANN 635 D , Ky tip cilindri nuk gjendet askund ne web. Ofertuesi nuk ka ofruar dëshminë e kërkuar (DUD, Fature ose Kontrate blerje). Foto te tij nuk ka bashkëngjitur. Prandaj nuk mund te pranohet si Cilinder me rrota të kombinuara (gomë dhe hekur), min 6.5 t përderisa ne "dëshminë" e ofruar është shënuar si "radna masina" (shqip: makine punuese). - HYSTER C 530 A ne fakt është cilindër me rrota gome (jo te kombinuar – gome-hekur) dhe si i tille nuk plotëson kërkesën. Kjo mund te vërtetohet lehtësisht me një kërkim ne internet. - CASE W602BD bazuar edhe ne foton e ofruar është cilindër për ngjeshje te dheut dhe tamponit dhe nuk është ashtu siç është kërkuar (për punët e asfaltit) dhe si i tille nuk plotëson kërkesën; - DYNAPAC CC 232HF me nr. serik 341562 (fatura nr. 3 dhe foto e bashkëngjitur) është cilindër me

rrota hekuri (jo te kombinuar gome-hekur) dhe si i tille nuk plotëson kërkesën. Prandaj, GEO R&RUKOLLI & SABA Belca & Elmazaj & Tekno Konstrukt nuk ka plotësuar kërkesën e DT për 5 cope Cilindra me rrota te kombinuar (për punët e asfaltit). Sepse nga 7 cope te ofruar, vetëm 3 cope plotësojnë kërkesën. Deshmite detale lidhur me kete pretendim i gjeni ne shtojce – Aneksi 1- Cilindrat 16.pdf 3. Lista e kontratave te realizuara. GOE R&RUKOLLI & SABA Belca & Elmazaj & Tekno konstrukt, tek Listat e kontratave te realizuara te ofruara ne DT permban te dhena te pasakta si në vijim:

- Anëtari i GOE "ELMAZAJ

Numri i Prokurimit: 205 23 1843 511– Titulli : Zgjerimi i rrugës nacionale N9-Segmenti Kjevë-Dollc, Loti 1,2,3,4

Aneksi LISTA E KONTRATAVE TE REALIZUARA

NR.	Titulli i kontratës	Shuma e kontratës	Data e fillimit	Data e përfundimit	Emri i Përfituesit / Investitorit
1	Ndërtimi i Urës së Gjormit - Brataj - Ura e Laskos në qarkun Selenicë, Qarku Vlorë.	11,507,944.80 €	17.04.2019	26.05.2021	Fondi Shqiptar I Zhvillimit STRABAG Trema Engineering 2
2	Mbrojte ne Lumin Viose Ferras Fier	342,800.88 €	19.06.2019	20.11.2019	Drejtoria se Ujitjes dhe Kullimit Fier
	Vlera e kontratave te realizuara në tri vitet e fundit 2020, 2021, 2022	**11,850,745.68 €**			

Kësaj liste i bashkëngjitem te skanuara kontratat, aneks kontratat, procesverbalet e pranimeve teknike dhe referencat.

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vula _____

- Bazuar ne dëshmitë e ofruara, kontrata me nr. rendor 1 është realizuar nga ELMAZAJ ne cilësinë e nënkontraktonit (subcontract agreement). Pra ELMAZAJ ka qene nenkontraktor dhe jo kontraktor. - Edhe ne listën e ofruar qartësisht është specifikuar se Punëdhënës ka qene Fondi shqiptar i zhvillimit, Kontraktor ka qene "STRABAG Trema Engineering 2" ndërsa ELMAZAJ ka kryer punime si nenkontraktor. Kur kjo shume nuk merret parasysh, vlera e punëve te kryera nga OE ofertues-Konzorciumi zvogëlohet për se paku 11.000.000,00 Euro Deshmia lidhur me kete pretendim eshte bashkengjitur Aneksi 2 – Marrëveshje nënkontratë 1030.01.pdf - Kontrata me nr. rendor 2 është kontrate e nënshkruar dhe e realizuar nga Konzorciumi (JV ELMAZAJ KONSTRUKSION & BAHAS). Përderisa nuk ka shënime sa është përqindja e punëve te kryera nga partneret ne

konzorciom, edhe kjo kontrate nuk mund te merret si e realizuar vetëm nga njeri anëtar i konzorciumit (Elmazaj Konstruksion). Deshmia lidhur me kete pretendim eshte bashkengjitur Aneksi 3 – Kontrata - Mbrojte ne Lumin Vjose.pdf

Anëtari i GOE: RUKOLLI

Numri i Prokurimit: *205 23 1843 511*– Titulli : Zgjerimi i rrugës nacionale N9-Segmenti Kijevë-Dollc, Loti 1,2,3,4

Aneksi LISTA E KONTRATAVE TE REALIZUARA

NR.	Titulli i kontratës	Shuma e kontratës	Data e fillimit	Data e përfundimit	Emri Përfituesit Investitorit
1	Ndërtimi i rrugës Nacionale Nadakovc - Srekovnicë, Lot 3	1,648,386.27	19.01.2018	30.05.2022	Ministria Infrastruktur
2	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Izbicë - faza II	526,067.15	27.09.2019	14.12.2021	Komuna Skenderajt
3	Ndertimi i sheshit - rrugëve në qytet - infrastruktura nëntokësore dhe mbitokësore	1,560,058.69	28.12.2015	11.11.2021	Komuna Klinës
4	Ndërtimi i mbikalimit në Polluzhë - km. 1+636.50m dhe mbikalimit në Tërstenik - km. 3+249.81m	436,749.86	18.04.2019	23.04.2021	Ministria Infrastruktur
5	Asfaltimi i rrugëve në Kuqicë - Tërnavc komuna e Skenderajt	775,723.80	18.09.2019	27.11.2020	Komuna Skenderajt
6	Zgjerimi i Rruges Regjionale R102 segmenti Kamaran - Merinë, L=17km; Loti I (Marinë - Tërrstenik) +000.00 - 3+455.00	4,120,099.02	05.04.2018	12.11.2020	Ministria Infrastruktur
7	Ndërtimi i rrugës Zasellë - Mitrovice, L=2,470.00m'	344,027.82	23.04.2018	30.12.2019	Ministria Infrastruktur
	Vlera e kontratave te realizuara në tri vitet e fundit 2020, 2021 dhe 2022	**9,067,084.79**			

- Kontrata me nr. rendor 1 është kontrate e realizuar nga Konzorciumi (Rukolli & Bageri) Kontrata me nr. rendor 6 është kontrate e realizuar nga Konzorciumi (Rukolli & Victoria Invest) Përderisa nuk ka shënime sa është përqindja e punëve te kryera nga partneret ne konzorciom, edhe këto 2 kontrata nuk mund te merren si te realizuara vetëm nga njeri anëtar i konzorciumit (Rukolli). Kontratës me nr. rendor 7 i mungon referenca – raporti i pranimit. Si e tille nuk mund te merret parasysh. Bazuar ne këto, vlera e punëve te kryera nga OE ofertues-Konzorciumi zvogëlohet edhe për se paku 3.000.000,00 Euro. Këto fakte është dashur te merren parasysh nga Komisioni gjate vlerësimit – poentimit. Nga përshkrimi i mësipërme shihet qartë se AK-Ministria e Infrastrukturës me Lot 1 ka rekomanduar për kontratë një Grup te Operatoreve Ekonomik te pa përgjegjshëm. Ne ketë rast komisioni i vlerësimit është dashur qe fare te mos e përfshij ne poentim një operator ekonomik te pa përgjegjshëm ndërsa përkundrazi ka vepruar duke e përfshirë ne poentim dhe duke i marrë për bazë edhe kontrata me vlera te ndryshme monetare qe nuk i përkasin Grupit te Operatoreve Ekonomik te rekomanduar për kontratë.

Bazuar ne dëshmitë e shkeljeve ligjore te përshkrua me lartë kërkojmë nga Panelli Shqyrtues i OSHP-se te aprovoj ankesën tonë si te bazuar dhe lënda te kthehet në RIVLERESIM për Lot 1. 5.4 Pretendimi ankimor ne raport me ofertën e GOE FAMI CO-HC SHA, KITAK, Gradnje D.O.O, KAG Asphalt Company Shpk, te rekomanduar për dhënie kontrate për Lot 4. 5 AK-Ministria e Infrastrukturës gjatë procesit te vlerësimit për Lot 4 ka bërë shkelje të rende te dispozitave ligjore te nenit 59 te LPP-se duke shpërblyer me kontratë Grupin e Operatoreve Ekonomik qe nuk i kanë plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe ne ketë mënyre ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 4 te nenit 59 te LPP-se i cili thotë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. 6 Pas qasjes ne dokumentet zyrtare dhe marrjes se dokumenteve tenderuese te GOE FAMIS CO-HC SHA, KIT-AK, Gradnje D.O.O, KAG Asphalt Company Shpk, te rekomanduar për dhënie kontrate për Lot 4, konstatojmë se oferta e rekomanduar për kontratë është e pa përgjegjshme për arsyet në vijim: 1. Përshtatshmëria profesionale. Dëshmia a) Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit Partneri ne kozorcium KIT-AK gradnje ka dorëzuar dëshminë- Certifikatën e regjistrimit te biznesit ne gjuhen sllovene. Çdo dokument i dorëzuar ne oferte duhet te jete ne njërën nga gjuhet e tenderit ose i përkthyer ne shqip, serbisht apo anglisht. Prandaj ky dokument nuk mund te pranohet sepse është në kundërshtim me nenin 13 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik, saktësisht me paragrafin 4 te këtij neni i cili thotë: "Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze". Ne ketë rast AK-Ministria e Infrastrukturës, duke pranuar dokument ne gjuhen Sllovene ka bërë shkelje te nenit 13 te LPP-se dhe nenit 59 te LPP-së. Deshmia lidhur me kete pretendim eshte bashkengjitur Aneksi 4 - KIT AK Regjitrimi i biznesit.pdf 2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar.

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar. - Kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (lideri i grupit duhet te kete min 40% te mbështetjes bankare), - Pjesën e I-re 1,600,000.00 euro - pjesën e II-te 1,400,000,00 euro - pjesën e III-te 1,200,000,00 euro - pjesën e IV-te 2,000,000,00 euro. - Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi te pakushtëzuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar - Grupi i OE FAMIS CO-HC SHA, KIT-AK, Gradnje D.O.O, KAG Asphalt Company Shpk, kane ofruar dy konfirmime nga banka, mirepo jo sipas kerkeses se DT. 14/23 - Bazuar ne kërkesën eksplicite te DT (Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi te pakushtezuar), është e qarte se Grupi i OE FAMIS CO-HC SHA, KIT-AK, Gradnje D.O.O, KAG Asphalt Company Shpk, nuk ka ofruar dëshminë ashtu siç është kërkuar sepse ne dokumentin e lëshuar nga banka nuk tregohet sa është shuma e mjeteve financiare aktualisht ne dispozicion. OE mund te ketë limit te aprovuar, mirëpo konfirmimi bankar duhet te tregoje se sa prej asaj shume janë ne dispozicion ne

diten e leshimit te dokumentit dhe sa janë tashme te shfrytëzuara. - AK ne lidhje me ketë rast ka mundur te kërkojë sqarim shtesë sipas nenit 72 te LPP-së , ne mënyrë qe te sigurohet se ofertuesi e ka ne dispozicion shumen e kërkuar ne datën e lëshimit te këtij konfirmimi. - Nga përshkrimi i mësipërm rezulton se dokumentacioni i ofruar për ketë pikë si i tille nuk përmbush kërkesën e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë. Deshmia lidhur me kete pretendim eshte bashkengjitur Aneksi 4.1 – Konfirmimet nga banka.pdf 3. Kapaciteti teknik dhe profesional - Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës DT, Dëshmia 8. Lista e pajisjeve sipas aneksit te DT te plotësuar ne te gjitha kolonat, bashkangjitur Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet te regjistrohen. - Partneri ne kozorcium KIT AK gradnje për dëshmi mbi pronësinë e shumicës se makinerisë (25 cope) ka ofruar "Potrdilo o pregledu in preizkusu delovne opreme" (kur përkthehet ne shqip: Certifikata e inspektimit dhe testimit të pajisjeve të punës). Pra, nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara sipas DT (Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen). Pos kësaj, këto "dëshmi" janë ofruar ne gjuhen sllovene dhe jo siç kërkohet (shqip, serbisht ose anglisht). Si te tilla nuk mund te pranohen. - Prandaj grupi i OE i rekomanduar për kontratë për Lot 4 nuk ka përmbushur kërkesën 8. Lista e pajisjeve sipas DT. Deshmia lidhur me kete pretendim eshte bashkengjitur Aneksi 5 – KIT AK gradnje doo - Makineria.pdf 4. Lista e kontratave te realizuara:

Anëtari i GOE :FAMIS CO HC SHA

Lista e kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit

INVESTITORI	EMRI PROJEKTIT	KONTRATA NR	Data e nënshkrimit të kontratës	Data e përfundimit të kontratës	VLERA €
Ministria e Infrastrukturës Prishtinë	Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore e rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Kosovës për vitet 2019/2020	Kontratë Publike Kornize: 22/2018	Data e nënshkrimit: 05.04.2018 Data e fillimit: 08.04.2019	06.04.2020	1,058,355.23 €
Ministria e Infrastrukturës Prishtinë	Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore e rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Kosovës për vitet 2020/2021	Kontratë Publike Kornizë: 22/2018	Data e nënshkrimit: 05.04.2018 Data e fillimit: 05.04.2020	05.04.2021	1,187,658.35 €
Ministria e Infrastrukturës Prishtinë	Mirëmbajtja Rutinore dhe Dimërore të Autoudhës A7 (Ibrahim Rugova) e A6 nga udhëkryqi, A7 A6 deri në kyçjen në Koçjuh si dhe rrugën Nacionale N9	Kontratë Publike Kornizë: Mi-19-014-211	Data e nënshkrimit: 03.07.2019 Data e fillimit: 04.07.2019	04.07.2020	1,846,714.82 €
Ministria e Infrastrukturës Prishtinë	Mirëmbajtja Rutinore dhe Dimërore të Autoudhës A7 (Ibrahim Rugova) e A6 nga udhëkryqi, A7 A6 deri në kyçjen në Koçjuh si dhe rrugën Nacionale N9	Kontratë Publike Kornizë: Mi-19-014-211	Data e nënshkrimit: 03.07.2019 Data e fillimit: 04.07.2020	04.07.2021	1,849,410.18 €
Ministria e Infrastrukturës Prishtinë	Mirëmbajtja Rutinore dhe Dimërore të Autoudhës A7 (Ibrahim Rugova) e A6 nga udhëkryqi, A7 A6 deri në kyçjen në Koçjuh si dhe rrugën Nacionale N9	Kontratë Publike Kornizë: Mi-19-014-211	Data e nënshkrimit: 03.07.2019 Data e fillimit: 05.07.2021	05.07.2022	1,704,857.87 €
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial në Shtrokë Kontrata: 2.393.122,86€ dhe Aneks Kontrata: 238.653,10€	MTI 204-18-6049 / 034-5-1-1 dhe Aneks Kontrata: MTI 204-19-5939/034-5-1-1	30.10.2018 & Aneks kontrata 02.09.2019	15.09.2021	2,631,776.02 €
Ministria e Infrastrukturës Prishtinë	Mirëmbajtja e Urave në rrugët Nacionale dhe Regjionale të Kosovës për vitet 2017/2018 dhe 2018/2019	001/2018 Kontratë Kornizë	02.03.2018	26.10.2020	5,377,058.07 €
Ministria e Infrastrukturës Prishtinë	Strukturat në zgjerimin e rrugës Nacionale N9.1, segmenti Dollc - Gjakovë, Lot 2	205-18-5892-5-1-1 Vlera e kontratës: 3,981,729.43€ Realizimi 30.60%	31.05.2018	2019-2022 në vazhdim	1,218,317.91 €
Ministria e Infrastrukturës Prishtinë	Strukturat në zgjerimin e rrugës Nacionale N9.1, segmenti Dollc - Gjakovë, Lot 3	205-18-5953-5-1-1 Vlera e kontratës: 2,900,003.40€ Realizimi 52.38%	20.12.2018	2018-2022 në vazhdim	1,519,298.70 €
Komuna Suharekë	Ndërtimi i urazes - Krahu i Djathtë - Suharekë	624-19-5202-5-1-1 & 624-019-050-511 Realizimi: 40.63%	24.03.2020	2020-2022 në vazhdim	677,292.63 €
				Totali :	19,070,739.48 €

"Famis Co HC" sh.p.

FAMIS CO HOLDING COMPANY

Famis Co
23000 Suhare
Mob: +386 -
info@fam
www.fam

Bazuar ne dëshmitë e ofruara, 3 kontratat e fundit ne liste janë kontrata ne ekzekutim e sipër dhe ofertuesi për to nuk ka ofruar as referencë e as raport te pranimit te punëve. Këto kontrata nuk mund te merren parasysh ne totalin e punëve te kryera nga FAMIS CO HC SHA. Totali prej 19,070,739.48 Euro duhet te zvogëlohet se paku për shumen 3,414,000.00 Euro. 16/23 Anëtari i GOE: KIT AK gradnje:

- Nga Lista e mësipërme, vetëm per njërën kontrate është ofruar Referenca – raporti (ne sllovenisht dhe e perkthyer ne shqip). Për te gjitha tjerat mungojnë dëshmitë e kërkuara (Referenca ose raporti i pranimit). Prandaj si kontrate e kryer nga KIT AK gradnje mund te pranohet vetëm njëra. Te gjitha tjerat janë ofruar ne liste mirëpo ju mungon dëshmia e kërkuar dhe si te tilla nuk mund te merren

parasysh. Bazuar ne këto, vlera e punëve te kryera nga partneri KIT AK gradnje zvogëlohet për me shume se 19.000.000,00 Euro

Anëtari i GOE KAG Asphalt:

List of completed contracts

Bidder's Name: *KIT-AK Gradnje d.o.o.*
Date: *18.04.2023*

9.1 & 9.2 Technical and professional opportunities

Starting Year	Ending Year	Contract Identification	Role of Bidder
2021	2022	Contract name: *Expansion of the Ormož economic and business zone* Brief Description of the Works performed by the Bidder: *Construction of municipal infrastructure, roads and sewerage* Amount of contract: *2.608.652,55 €* Name of Employer: *Municipality of Ormoz* Address: *Pivjska ulica 6, 2270 Ormoz, Slovenia*	Prime Contractor
2021	2022	Contract name: *Construction of the Golobinjek cycle path along Sotla - Lastnič* Brief Description of the Works performed by the Bidder: *All works for the construction of a 3.500 m long cycle road, with 3 bridges* Amount of contract: *1.921.599,65 EUR* Name of Employer: *Ministry of Infrastructure of the Republic of Slovenia* Address: *Trzaska cesta 19, 1535 Ljubljana, Slovenia*	Prime Contractor
2021	2022	Contract name: *Construction of the southern road link IC11* Brief Description of the Works performed by the Bidder: *Construction of roads with municipal infrastructure and sewerage* Amount of contract: *2.359.938,44 €* Name of Employer: *Municipality of Hoce - Slivnica* Address: *Pohorska cesta 15, 2311 Hoce, Slovenia*	Prime Contractor
2019	2020	Contract name: *Construction of road R2-430/0282, through Smarjeta near Celje* Brief Description of the Works performed by the Bidder: *All works for the construction of a 1660 m long road, DN400 ductile iron water supply, sewerage* Amount of contract: *2.654.938,71 EUR* Name of Employer: *Ministry of Infrastructure of the Republic of Slovenia* Address: *Trzaska cesta 19, 1535 Ljubljana, Slovenia*	Prime Contractor

2016	2020	Contract name: *IMPROVEMENT OF THE WATER AND COMMUNAL INFRASTRUCTURE OF THE PETRINJA AGGLOMERATION, RECONSTRUCTION WATER SUPPLY, RECONSTRUCTION AND CONSTRUCTION OF THE PETRINJA AGGLOMERATION DRAINAGE SYSTEM* Brief Description of the Works performed by the Bidder: *All works for the implementation of sewerage, including road structure* Amount of contract: *12,219,289,91 EUR* Name of Employer: *KOLEKTOR KOLING d.o.o.* Address: *Ankova 43, 5280 Idrija, Slovenia*	Member in JV
2022	2023	Contract name: *ARRANGEMENT OF THE LOCAL ROAD VOJNIK – LJUBEČNA* Brief Description of the Works performed by the Bidder: *All works for roads construction* Amount of contract: *292.690,59 EUR* Name of Employer: *Municipality of Vojnik* Address: *Kerčova ulica 8, 3212 Vojnik*	Prime Contractor
2020	2021	Contract name: ARRANGEMENT OF THE LOCAL ROAD DOLGA GORA – SLADKA GORA Brief Description of the Works performed by the Bidder: *All works for roads construction* Amount of contract: *477.982,57 EUR* Name of Employer: *Municipality of Šentjur* Address: *Mestni trg 10, 3230 Šentjur*	Prime Contractor
2020	2021	Contract name: *RECONSTRUCTION OF THE LOCAL ROAD TUNCOVEC – ST. FLORIAN* Brief Description of the Works performed by the Bidder: *All works for roads construction* Amount of contract: *197.930,82 EUR* Name of Employer: *Municipality of Rogaška Slatina* Address: *Izletniška ulica 2, 3250 Rogaška Slatina*	Prime Contractor
2020	2021	Contract name: *RECONSTRUCTION OF THE LESIČNO – GOLOBINJEK ROADWAY, WITH THE ARRANGEMENT OF THE ROAD CONNECTION AND REHABILITATION OF THE LANDSLIDE* Brief Description of the Works performed by the Bidder: *All works for roads construction* Amount of contract: *429.037,87 EUR* Name of Employer: *Ministry of Infrastructure of the Republic of Slovenia* Address: *Trzaska cesta 19, 1535 Ljubljana, Slovenia*	Prime Contractor
2021	2022	Contract name: *ARRANGEMENT OF THE LOCAL ROAD DROBINSKO – LOKA PRI ŽUSMU AND LOKA PRI ŽUSMU – SODNA VAS* Brief Description of the Works performed by the Bidder: *All works for roads construction* Amount of contract: *897.089,23 EUR*	Prime Contractor

		Name of Employer: *Municipality of Senjur* Address: *Mostni trg 10, 1290 Šentjur*	
2020	2021	Contract name: *REPLACEMENT OF THE CONNECTION OF THE LOCAL ROAD TO THE STATE ROAD IN THE SETTLEMENT OF TUNCOVEC* Brief Description of the Works performed by the Bidder: *All works for roads construction* Amount of contract: *209.355,46 EUR* Name of Employer: *Ministry of Infrastructure of the Republic of Slovenia* Address: *Tržaška cesta 19, 1535 Ljubljana, Slovenia*	Prime Contractor X
2021	2023	Contract name: *ECONOMIC BUSINESS INFRASTRUCTURE IN PC AG III* Brief Description of the Works performed by the Bidder: *Construction of municipal infrastructure, roads and sewerage* Amount of contract: *2.036.297,87 EUR* Name of Employer: *Municipality of Žalec* Address: *Ul. Savinjske Cete 5, 3310 Žalec*	Prime Contractor X
2021	2023	Contract name: *CONSTRUCTION OF HIGHWAY FROM THE CONNECTION VELENJE SOUTH TO THE CONNECTION SLOVENJ GRADEC SOUTH ON THE 3RD DEVELOPMENT AXIS PORT. SECTION F-JENINA* Brief Description of the Works performed by the Bidder: *Construction work on the highway* Amount of contract: *2.171.644,15 EUR* Name of Employer: *VOC Celje d.o.o.* Address: *Lava 42, 3000 Celje*	Subcontractor X
2018	2021	Contract name: *Construction of sections of the railway line Rimske toplice - Laško and Laško - brick bridge and an off-level crossing* Brief Description of the Works performed by the Bidder: *Implementation of all construction works for the upgrading of the railway line* Amount of contract: *3.054.325,92 EUR* Name of Employer: *KOLEKTOR KOLING d.o.o.* Address: *Ankova 4A, 5280 Idrija, Slovenia*	Member in JV/subcontractor X

Tel: 038/241-401 Fax:038/538-730
e-mail:kag_ks@yahoo.com
Web: www.kag-asphalton.com

Lista e kontratave

Titulli	AK	Nr. i kontates	Data e Kontraktimit	Vlera
Ndërtimi i infrastrukturës në parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit (Konsorcium V. Bashkuar 60 % & KAG 40%)	K. Prizren	622-190-35-511	04.12.2019	€ 1,159,627.3
Rregullimi dhe zgjerimi i rrugës Planej – Mazrek – Ulken i Hasit – Ramja e Dëshmorëve.	Ministria e Infrastrukturës & Transportit	205-19-5761-5-1-1	25.10.2019	€ 543,584.5
Ndërtimi i rrugeve Xerxe, Çaïne,Nashpoll, Senoc, Retija e Epërme dhe Mersor	K. Rahovec	623-16-049-521	25.10.2016	€ 394,145.38
Ndërtimi (asfaltimi) i rrugës qarkore ne Rahovec	K. Rahovec	623-12-047-5-511	19.07.2012	€ 604,687.08
Rregullimi i trotuarit,rrugicave dhe kanalizimit ne fshatin Atmazhë të Prizrenit	K. Prizren	622-17-120-521	18.09.2017	€ 159,620.55
NDËRTIMI I RRUGËVE ME KUBËZA NË DABIDOL, POLLUZHË, RATKOC, GEXHË, KRAMOVIK DHE GURI I KUQ	K. Rahovec	623-17-2129-5-2-1	28.07.2017	€ 258,807.49

ndërtimi-asfaltimi i rrugës në fshatin Zhabel	K. Gjakovë	632-16-048-511	16.01.2017	€ 289,717.84	27.11.2
parimi (asfaltimi) i rrugëve në hovec – Drenoc - Sarosh - Zatriq, rtesë - Sapniq	K. Rahovec	623-17-8412-5-2-1	05.10.2017	€ 380,130.54	09.10.2
ndërtimi i rrugës Demjan Prloh, akovë" & aneks kontratë	Ministria e Infrastrukturës	36/2017	06.12.2017	€ 395,376.57	12.10.2
faltimi i rrugës në fshatin Rastello-rezimir - kalimi kufitar (Vazhdimi i nimëve) (Projekt Tre vjeçar)	K. Dragash	621-17-2657-5-1-1	29.08.2017	€ 449,820.00	10.10.2
ërtimi i rrugëve në Hoçë të Vogël, estoc, Krushë të Madhe dhe Fortesë	K. Rahovecit	623-16-065-521	01.11.2016	€ 313,988.20	15.10.2

- Nga Lista e mësipërme shihet se te Kontrata e pare ne liste është Konzorcium, ne te cilin KAG ASPHALT SHPK ka përqindje prej 40%. - Kontrata nr. 2 dhe nr.3 mund te merren parasysh, ndërsa nga nr. rendor 4 e tutje te gjitha kontratat e listuara janë përfunduar para vitit 2020 dhe si te tilla nuk mund te merren parasysh. 20/23 Rrjedhimisht: - Për Llot-4 , sipas dëshmive te paraqitura me lartë, AK-Ministria e Infrastrukturës ka rekomanduar për dhënie kontrate ofertën me çmim shumë me te lartë se sa oferta jonë për 320,482.64 Euro. - Pos kësaj, ofertuesi i shpallur fitues për Llot-4 tek dëshmitë e makinerisë (Grejder, ngarkues, cilindra, dozer, eskavator, etj) te partnerit ne konzorcium KIT-AK Gradjnje doo Slovenia për dëshmi mbi pronësinë e makinerisë se ofruar nuk ka ofruar deshmite ashtu siç është kërkuar: faturën e blerjes ose Deklaratën Unike Doganore. Dëshmitë e ofruara për shumicen e pajisjeve nga ky partner nuk janë dorëzuar ne njërën nga gjuhet zyrtare te DT (Shqip, Serbisht, Anglisht). Prandaj dokumentacioni për makineritë e ofruara nga partneri ne konzorcium KIT-AK Gradjnje doo Slovenia, nuk mund te pranohet edhe sepse nuk ka ofruar dëshminë e kërkuar mbi pronësinë ne njeren nga gjuhet e lejuara (shqip, serbisht, anglisht) si dhe nuk ka ofruar deshmite mbi pronesine ashtu siç është kërkuar ne DT. Nga përshkrimi i mësipërm i te gjeturave për Lot 1 dhe Lot 4 rezulton se AK-Ministria e Infrastrukturës ka bërë shkelje te rendë te dispozitave ligjore te Ligjit për Prokurim Publik dhe Ligjeve tjera duke shpërblyer me kontratë ne te dy rastet operator ekonomik qe nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe kanë çmim dukshëm me te lartë se sa oferta jonë. Te dy GOE te cilët janë rekomanduar

me kontratë për Lot 1 dhe 4 ne vend qe te shpallen te pa përgjegjshëm sipas te gjeturave te përshkruara me lartë ata rekomandohen për dhënie kontrate nga AKMinistria e Infrastrukturës. Ne tabelën e mëposhtme shih dallimin ne buxhet ne mes te ofertës sonë dhe GOE te rekomanduar për kontratë:

Nr.	Çmimi i oferte sonë	Çmimi i oferte se GOE te rekomanduar për kontratë	Dallimi ne çmim €
Lot 1	7,346,466.21	7,392,670.30	46,204.09
Lot 4	8,994,786.16	9,315,268.80	320,482,64

Nga tabela e mësipërme shihet se vetëm për Lot 1 dhe 4 AK-Ministria e Infrastrukturës ka dëmtuar buxhetin ne vlerë prej 366,686.73 €. Bazuar ne dëshmitë e shkeljeve ligjore te përshkrua me lartë kërkojmë nga Panelli Shqyrtues i OSHP-se te aprovoj ankesën tonë si te bazuar dhe lënda te kthehet në RIVLERESIM për Lot 4. 5. Pretendimi Ankimor nr. 6 - Sipas pretendimit ankimor nr. 6 AK-Ministria e Infrastrukturës gjatë procesit te vlerësimit ka bërë shkelje te nenit 60 te LPP-së Kriteret për Dhënien e Kontratës, ku sipas paragrafit 2 te këtij nenit i cili thotë: "Nëse autoriteti kontraktues ka përcaktuar në dosjen e tenderit se kontrata publike do ti jepet operatorit 21/23 ekonomik që dorëzon tenderin e përgjegjshëm ekonomikisht më të favorshëm, dhënia e kësaj kontrate do të bëhet vetëm në bazë të kritereve dhe peshës së tyre përkatëse të përcaktuar në dosjen e tenderit në pajtim me paragrafët 2. dhe 3. të nenit 52 të këtij ligji." - AK-Ministria e Infrastrukturës nuk ka zbatuar ketë nen sepse nuk ka vlerësuar ne bazë te kritereve dhe peshës se tyre përkatëse te përcaktuar në dosje te tenderit. Po ashtu AK, përkatësisht komisioni i vlerësimit dhe zyra e prokurimit ne raportin e vlerësimit nuk kane vendosur renditjen e operatoreve ekonomik te pa suksesshëm sipas kritereve dhe peshës se tyre përkatëse. Ne raportin e vlerësimit, komisioni ka vendosur vetëm totalin e pikeve te operatoreve ekonomik te rekomanduar për kontratë dhe nuk ka paraqitur fare piket per te gjithe operatoret e pergjegjshem per secilin nenkriter sipas formularëve te percaktuar ne dosje te tenderit:

- Po ashtu AK-Ministria e Infrastrukturës ka bërë shkelje te rendë te këtij neni ne rastin tonë sepse ne raport te vlerësimit ceket se oferta e GEO Granit SH.P.K.; K.N.P.SH. PAPENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K, është e përgjegjshme për Lot 1 ndërsa nuk përfshihet fare oferta jonë ne tabelën e poentimit. 6. Pretendimi Ankimor nr. 7 - Neni 69 i Ligjit - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale AK-Ministria e Infrastrukturës saktësisht komisioni i vlerësimit duke eliminuar ofertën tonë si te pa përgjegjshme ndërsa ne ane tjetër duke rekomanduar operator ekonomik për dhënie kontrate ka shkelur nenin 69 te LPP-së Aftësia Teknike dhe Profesionale sepse nuk ka zbatuar vetë kriteret tek kjo pikë te cilat janë kërkuar në dosje te tenderit dhe njoftimin për kontratë. - Për Lot 1 ka shpallur fitues ofertën e grupit te operatoreve ekonomik te cilët janë te pa përgjegjshëm për arsyet e përshkruara tek pretendimi nr. 5 ne raport ne raport me ofertën e GEO R&RUKOLLI & SABA Belca & Elmazaj & Tekno Const. te rekomanduar për dhënie kontrate për Lot 1 . - Për Lot 4 ka po ashtu ka

shpallur fitues ofertën e grupit te operatoreve ekonomik te cilët janë te pa përgjegjshëm për arsyet e përshkruara tek pretendimi nr. 5 ne raport me ofertën e GEO FAMIS CO-HC SHA, KITAK, Gradnje D.O.O, KAG Asphalt Company Shpk, te rekomanduar për dhënie kontrate për Lot 4. Sipas te gjeturave te përshkruara mësipërme ne te gjitha pretendimet ankimore vërehet shumë qartë se AK-Ministria e Infrastrukturës gjatë vlerësimit për ketë aktivitet te prokurimit ka bërë shkelje te renda te dispozitave ligjore te LPP-së. 22/23 Te gjitha këto shkelje janë përshkruar përmes pretendimeve ankimore te kësaj ankese. Vlen te ceket se shkeljet e bëra nga AK-Ministria e Infrastrukturës janë te shumëfishta ne ketë proces te vlerësimit duke filluar nga shkeljet e parimeve bazike te Ligjit për Prokurim Publik, shkelje procedurale dhe administrative dhe deri te shkeljet renda duke tentuar te dëmtohet buxheti i Kosoves përmes shpërblimit me kontratë te operatoreve ekonomik për Lot 1 dhe 4 , te cilët kanë ofertuar me çmim me te lartë se oferta e jonë.

Prandaj ne fund te kësaj ankese, duke u bazuar ne shkeljet e kryera nga ana e AK te LPP dhe Rregullores per prokurim publik, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së qe te nxjerr: VENDIM - Te Aprovohet ankesa jonë si e bazuar për Lot 1 dhe 4. - Te Anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-se i datës 29.12.2023 - Te Kthehet lënda në Rivlerësim për Lot 1 dhe 4.

ANKESA 2024 / 0058

Dispozitat e shkelura

- Neni 1 i LPP-se
- Neni 6 i LPP-se
- Neni 7 i LPP-se
- Neni 56 i LPP-se
- Neni 59 i LPP-se
- Neni 60 i LPP-se
- Neni 68 i LPP-se
- Neni 72 i LPP-se

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Ne me dt. 27.12.2023 permes platformes elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-se ku per **Lot 1,** eshte rekomanduar per kontrate grupi i OE R&Rukolli; SABA BELCA Dega ne Kosove; ELMAZAJ KONSTRUKSION; Tekno-Konstrukt SH.P.K. ndërsa ne për te katër lotët jemi eliminuar me arsyetimin si ne vijim:
OE ka deshtuar te plotsoj nenin 8.1 dhe 8.2 - Kerkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare pika 2 .Kapital financiar te mjaftueshem per realizimin e kontrates (lideri i grupit duhet te kete min 40% te mbeshtetjes bankare),
Pjesen e I-re 1,600,000.00 euro
- Pjesen e II-te 1,400,000,00 euro

- Pjesen e III-te 1,200,000,00 euro
Pjesen e IV-te 2,000,000,00 euro
Deshmia e kerkuar: Deklarate nga banka qe deshmon se OE ka mjete te gatshme ne xhirollogari ose qasje ne kredi te pakushtezuar, dokumenti te jete origjinal i nenshkruar dhe vulosur nga institucioni. Bankar.
- Operatori ekonomik nuk ka ofruar dokumentin e Bankes sipas DT- ka ofruar qasje ne kredi te Kushtezuar dhe LIDERI I KONZORCIU1v1IT NUK KA MBESHTETJE BANKARE NE VLERJ PREJ 40% .
Plani dinamik jo i plotesuar sipas kerkesave te DT-se. Ne dosje te tenderit kerkohet Plani Dinamik - te prezentohet same i detajuar i mundeshem duke i perfshire te gjitha aktivitetet dhe pozicionet qe jane te perfshira neper paramasa nga ana e ofertuesit/Kontraktuesit, ndersa OE nuk ka ofruar te dhena sipas kerkeses se DT-se.
Ne lidhje me arsyen e pare te eliminimit tone, ku AK-ja e ka cekur se nuke kemi ofruar dokumentin nga banka sipas kerkeses se dosjes se tenderit dhe kinse ne kemi ofruar qasjen ne kredi te kushtëzuar dhe se lideri i konsorciumit nuk ka mbeshtetje bankare ne vlere prej 40%, ju sqarojme se ky arsyetim i AK-se eshte i pa qendrueshem, i pabazuar dhe subjektiv.
Arsyeja e AK-se eshte e paqendrueshme per faktin se kerkese e dosjes se tenderit ka qene "2.*Kapital financiar ti! mjaftueshem per rea/izimin e kontrates (lideri i grupit dultet te kete min 40% te mbeslttetjes bankare),*
Pjesen e I-re 1,600,000.00 euro
- Pjesen e II-te 1,400,000,00 euro
- Pjesen e III-te 1,200,000,00 euro
Pjesen e IV-te 2,000,000,00 euro", ndersa si deshmi dokumentare eshte kerkuar "2. *Deklarate nga banka qi! desltmon se OE ka mjete ti! gatsltme ne xhirollogari ose qasje ne kredi te pakuslttezuar, dokumenti ti! jete origjinal i nensltkruar dlte vulosur nga institucioni. Bankar*".
Dokumentet e prezantuar nga ana j one te cilat j ane te leshuara nga banka nuk j ane te kushtezuara per faktin se askund ne dokument nuk specifikohet asnje kusht per qasjen ne kredi. Ne deklarata specifikohet qarte se lideri i konsorciumit dhe anetari tjeter i konsorciumit kane mjete ne llogari dhe kane te aprovuar kreditin dhe askund nuk ceket qe kompanite duhet te plotesojne ndonje kusht per aprovim te kredise. Gjithashtu ne perve9 limitit kreditor te aprovuar, e kemi deshmuar me fakte konkrete se posedojme edhe mjete te gatshme ne llogari, ku permes ketyre deshmive shihet qarte se e pe1mbushim kerkesen e dosjes se tenderit.
Kur analizohet linja kreditore e aprovuar, overdrafti dhe mjetet te cilat lideri i konsorciumit "Ndertimi", i ka prezantuar si deshmi shihet qarte se i njejti e an'in vleren prej 1,004,618.48 euro dhe si rezultat i kesaj kuptohet qarte se eshte permbushur kerkesa e dosjes se tenderit dhe arsyeja e AK-se per eliminimin tone eshte e paqendrueshme.
Lideri i konsorciumit ne Banken TEB i ka ne llogari 584,326.74 euro, kurse ne Banken Raiffeisen i ka 315,291.74 euro dhe keto deshmohen me konfirmimet bankare.

Po ashtu nga Raiffeisen Bank ka te aprovuar kredine ne vlere 100.000.00 euro dhe mbiterheqjen ne shume 5,000.00 euro.
Nga keto deshmi kuptohet qarte se lideri i konsorciumit i ka mjetet ne llogari mbi 40%, prandaj arsyeja e eliminimit eshte e paqendrueshme dhe e pa bazuar.
Perve9 kesaj edhe kredia eshte e aprovuar dhe askund nuk shkruan se do te shqyrtohen mundesite e leshimit te kredise por decidivisht shkruan eshte e aprovuar, prandaj permes kerkeses per rishqyrtim kerkojme qe te analizohen edhe nje here dokumentet tona dhe pas analizimit te tyre te nxjerrët vendim jo diskriminues dhe i bazuar ne dispozita ligjore.
Gjithashtu edhe arsyeja tjeter ku AK-ja e ka cekur se lideri i konsorciumit nuk e posedon 40% e mbeshtetjes bankare, eshte arsye e paqendrueshme per faktin se ne perve9 mbeshtetjes bankare e kemi prezantuar deshmine se kemi mjete te gatshme ne llogari ne momentin e ofertimit dhe kur mblidhen shuma e mbeshtetjes bankare dhe shuma te cilen e posedojme ne llogari, atehere plotesohet kerkesa e dosjes se tenderit.
Andaj si perfundim autoriteti kontraktues na ka eliminuar per LOT 1 e po ashtu edhe per Lotet tjera pa ndonje fakt konkret dhe ne kundershtim me kerkesat e dosjes se tenderit dhe dispozitave ligjore te LPP-se.
Sa i perket arsyes se dyte te eliminimit te grupit tone nga aktiviteti i prokurimit, ku AK-ja e ka cekur se per planin dinamik nuk ka ofruar te dhena sipas kerkeses se dosjes se tenderit, ju sqarojme se edhe ky arsyetim i AK-se eshte i pa bazuar dhe i paqendrueshem.
1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë prej jo më pak se- Pjesen e I-re 16,000,000.00 euro, Pjesen e II-te 14,000.000,00 euro, Pjesen e III-te 12,000.000,00 euro, Pjesen e IV-te 20,000.000,00 euro.

2. Kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (lideri i grupit duhet te kete min 40% te mbeshtetjes bankare), - Pjesen e I-re 1,600,000.00 euro, - Pjesen e II-te 1,400,000,00 euro, Pjesen e III-te 1,200,000,00 euro, Pjesen e IV-te 2,000,000,00 euro.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratat Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK për tri vitet e fundit

2. Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi te pakushtezuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni. Bankar.

Kapaciteti teknik dhe professional

Kërkesat

1. Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore me se paku 5 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) në lëmin e kërkuar (ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve).

2. Udhëheqës i punishtes Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, ose infrastrukturë rrugore me se paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) në lëmin e kërkuar (ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve).

3. Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë, drejtimi Hidroteknik - tri vite përvojë pune profesionale(pas diplomimit) në lëmin e kërkuar (ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve).

4. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ose gjeodet (shkolla e lartë), ose Bahcelor i diplomuar i gjeodezisë me pesë vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit)) në lëmin e kërkuar (ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve).

5. Një (1) Inxhinier i diplomuar i komunikacionit me dy vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ose Bachelor i diplomuar i komunikacionit me tri vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) në lëmin e kërkuar (ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve).

6. Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me tri vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ose Bahcelor i diplomuar i elektroteknikës me pesë vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) në lëmin e kërkuar (ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve).

7. OE duhet te jete i licencuar leje per aktivitete te veqanta për prodhimin e bazës se asfaltit, prodhimin e bazës se betonit dhe OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes zhavorr

8. Plani Menaxhimit te trafikut sa me i detajua.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Dëshmia 1. CV- per projektet e realizuara pas diplomimit-, diploma e noterizuar nga origjinali (noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate) Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt(noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate), si dhe Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar nga punedhenesi .

2. Dëshmia2. CV- per projektet e realizuara pas diplomimit-, diploma e noterizuar nga origjinali (noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate) Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt(noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate), si dhe Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar nga punëdhënësi.

3. Dëshmia 3. CV- per projektet e realizuara pas diplomimit-, diploma e noterizuar nga

origjinali (noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate) Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt(noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate), si dhe Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar nga punedhenesi .

4. Dëshmia 4. CV- per projektet e realizuara pas diplomimit-, diploma e noterizuar nga origjinali (noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate) Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt(noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate), si dhe Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar nga punëdhënësi.

5. Dëshmia 5. CV- per projektet e realizuara pas diplomimit-, diploma e noterizuar nga origjinali (noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate) Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt(noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate), si dhe Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar nga punëdhënësi.

6. Dëshmia 6. CV- per projektet e realizuara pas diplomimit-, diploma e noterizuar nga origjinali (noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate) Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt(noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate), si dhe Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar nga punëdhënësi.

7. Dëshmia 7- Kopja e licences lejesper aktivitete te veqanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marreveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.1

8. Dëshmia 8.Planit të menaxhimit të trafikut i hartuar dhe nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit dhe i vulosur nga kompania Duke pasur parasysh frekuentimin e kësaj rruge (ku i ka përafërsisht 18,000 automjete për 24h, mesatarja vjetore), duhet të pregaditet sa më i detajuar (i përcjellur me skica dhe shenja përkatëse të trafikut rrugorë) duke e studiuar mirë edhe duke pasur parasysh gjendjen në teren të rrugës dhe strukturave (në mënyr që të mos ketë bllokim të komunikacionit).

<u>Kërkesa e FDT-së</u>

Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik

a) një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht

përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës b) një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c) një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d) Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Grup i Operatoreve Ekonomik: N.P.„Victoria Invest International" Sh.p.k.; Victoria Invest shpk - OE ka deshtuar te plotsoj nenin 9.1dhe9.2 - Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale, ASHTU SIQ ESHTE KERK.UAR ne Njoftimin per kontrate dhe Dosjen e tenderit Kerkohet : Lista e kontratave te realizuara perfunduara ne lëmine e kerkuar per periudhen e shkuar tre vje9are nga data e njoftimit per kontrate. Operatori ekonomik duh et te kete proj ekte te realizuara ne lemin e asfaltimit, ndertimit, rehabilitimit, rikonstruktimit te rrugeve,duke deshmuar me Procesverbalet e 1 pranimit perfundimtar te puneve duke treguar vieren, daten, natyren dhe vendndodhjen e projekteve ne lemine e kerkuar per periudhen e shkuar tre vje9are. - OE i mungojne procesverbalet perfundimtare te pranimit teknik,duke treguar vleren, daten, natyren dhe vendndodhjen e projekteve ne lemine e kerkuar per periudhen e shkuar tre vje9are. - Plani dinamik jo i plotesuar sipas kerkesave te DT-se. Ne dosje te tenderit kerkohet Plani Dinamik - te prezantohet same i detajuar i mundeshem duke i perfshire te gjitha aktivitetet dhe pozicionet qe jane te perfshira neper paramasa nga ana e ofertuesit/Kontraktuesit, ndersa 0 E nuk ka ofruar te dhena sipas kerkeses se DT-se. **Grup i Operatoreve Ekonomik Groma Hold EOOD; RSM Company SH.P.K.** Groma Hold EOOD; RSM Company SH.P.K., OE ka deshtuar te plotesoj kerkesat e percaktuara ne Njoftimin e kontrates dhe DT i mungojn:

- Marrveshja per themelimin e grupit nuk eshte ne perputhje me Ligjin e Prokurimit Publike, dhe Rregullat e Udhezuesit Operativ te Prokuimit Publike per themelimin e grupit - konzerciumit. Sipas Udhezuesit Operativ te Prokurimit Publik neni 27.3 citoj : Secili anetare i grupit duhet te permbush kerkesat e pershtatshmerise, neni 65 i LPP-se. <;;do kerkese e vendosur nga autoriteti kontraktues sipas neneve 66.2, 68, dhe 69 te LPP-se do te aplikohet vetern ndaj grupit si tersi dhe jo ndaj antareve individual te grupit, kurse ne mbeshtetjen bankare ceket
se kompania Groma Hold EOOD eshte partner udheheqes, ndersa ne nenin 3.2. te marrveshjes per themelimin e grupit ceket se pjesmartja e perbashket e Groma Hold EOOD dhe RSM Company SH.P.K., thuhet se kompania Groma Holld EOOD ne cilsin e saj si partner ne kontrate do te kryej vetem sherbime konsulente dhe nuk do te mbaj asnje pergjegjesi ne lidhje me ekzekutimin e kontrates dhe si e till kjo marrveshje eshte ne kundershtim me Deklaraten mbi marrjen e pergjegjsis bashkarishte dhe individualishte per formimin e grupit Prandaj I njejti nuk eshte kualifikuar ne fazen e poentimit.
- Plani dinamik jo i plotesuar sipas kerkesave te DT-se.
Ne dosje te tenderit kerkohet Plani Dinarnik – te prezentohet same i detajuar i mundeshem duke i perfshire te gjitha aktivitetet dhe pozicionet qe jane te perfshira neper paramasa nga ana e ofertuesit/Kontraktuesit, ndersa OE nuk ka ofruar te dhena sipas kerkeses se DT-se.
- OE ka deshtuar te plotsoj edhe Kerkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, Kerkesa : 1. Operatori
ekonomik duhet te ofroje deshmi te kenaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjate tre viteve te fundit ka qene ne vlere prej jo me pak se Deshmia e kerkuar: 1. Deklaratat Tatimore vjetore te
dorezuara ne ATK per tri vitet e fundit. Pjesen e I-re 16,000,000.00 euro Pjesen e II-te 14,000.000,00 euro
Pjesen e III-te 12,000.000,00 euro Pjesen e IV-te 20,000.000,00 euro - OE nuk ka paraqitur Deklaratat Tatimore vjetore te dorezuara ne ATK per vitin 2022 ash tu siq eshte kerkuar ne 3 vitet e fundit ne kerkesat e përcaktuara ne Njoftimin per kontrate dhe Dosjen e tenderit.

<u>Grup i Operatoreve Ekonomik Granit SH.P.K.; K.N.P.SH. PAPENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K.</u>

Ne Listen e Paisjeve eshte kerkuar Pika 10. Grejder 12-l6t,jane kerkuar 3 Grejdera. Ndersa Operatori ka ofruar 4 grejdera, 2 prej te cileve e tejkalojn kapacitetin e kerkuar: I Grejder me kapacitet 16,2 t. l grejder me kapacitet 18 t, I grejder me kapacitet 14,88 t, Ndersa per pajisjen nr.4 (Faun 105) ka ofruar kontrate te
shitlblerjes pate dhena mbi peshen e pajsijes, mirpo pas hulumtimit ne Internet ,komisioni I v!ersimit konstaton se Grederi Faun 105 ka peshen prej 12.400 kg. dhe si I till OE eshte I pergjegjshem vetem ne Lot-I pasi plotson kerkesat e përcaktuara ne DT dhe Njoftimit per kontrate.

Kurse ne Lot- 2. Lot- 3, dhe Lot-4, OE eshte I pa pergjegjshem pasi nuk arrin te piotesoj kerkesat e percaktuar ne DT.

Grup i Operatoreve Ekonomik SALLAHU SH.P.K.; SALILLARI

Ne Listen e Paisjeve eshte kerkuar Pika 10.Grejder l2-l 6t, jarte kerkuar 3 Grejdera. Ndersa Operatori ka ofruar 5 grejdera, 4 prej te cileve e tejkalojn kapacitetin e kerkuar:
1 Grejder me kapacitet 16,2 t.
1 grejder me kapacitet 18 t
I grejder me kapacitet 17 t
l grejder me kapacitet 20t .
Paisja nr. I. Greder marka O&K,tipi Fl56.6 A,2004 nr. 107174, nga kerkimet ne internet verifikohet se ky greder ka peshe prej 16,200 kg, ashtu siq eshte prezentuar nga vet operatori ekonomk neprmjet DUD-it.
Paisja nr. 2. Greder caterpillar champion 740, 1990 eshte sipas kerkesave te DT-se.
Pajisja nr.3. Greider O&K, tipi 106 A, viti 1992, Ne DUD nuk prezentohet pasha e pajisjes. Mirpeo pas kekrimit ne internet vertetohet se kjo pajisje eshte nen peshen 12t, me c'rast nuk eshte ne perputhj e me kerkesat e DT-se.
Pjaisja nr.4. Gredier Caterpillar, 120 m, viti 2018 me targa AKTM 67. Ne dokumentacionin e prezentuar per kete pajsije mungon pesha e pajisjes. Mirpeo pas kekrimit ne internet vertetohet se kjo pajisje eshte 16.900 kg, me c'rast nuk eshte ne perputhje me kerkesat e DT-se.
Pajisja nr.5. Greider Caterpillar, tip l4G, viti 2003. Ne DUD te prezentuar nga OE pesha e pajisjes eshte 20.000kg (20t), dhe si i tille nuk eshte ne perputhje me kerkesat e DT-se.

Grup i Operatoreve Ekonomik N.N. I 00 % Design Sh.p.k.; Haxha Korn SH.P.K.; Haxha Company SH.P.K.; INTEGRAL Sh.p.k.; MILENIUM KONSTRUCTION SH.P.K.; CAPITAL SH.P.K.

N.N. 100 % Design Sh.p.k.; Haxha Korn SH.P.K.; Haxha Company SH.P.K.; INTEGRAL Sh.p.k.; MILENIUM KONSTRUCTION SH.P.K.; CAPITAL SH.P.K.,

OE ka deshtuar te plotsoj nenin 8.1 dhe 8.2 - Kerkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare pika 2 .Kapital financiar te mjaftueshëm per realizimin e kontrates (lideri i grupit duhet te kete min 40% te mbështetjes bankare), Pjesen e I-re 1,600,000.00 euro - Pjesen e II-te 1,400,000,00 euro, - Pjesen e l!I-te 1,200,000,00 euro -
Pjesen e IV-te 2,000,000,00 euro
Deshmia e kerkuar: Deklarate nga banka qe deshmon se OE ka mjete te gatshme ne xhirollogari ose qasje ne kredi te pakushtezuar, dokumenti te jete origjinal i nenshkruar dhe vulosur nga institucioni. Bankar.

- Opera tori ekonomik nuk ka ofruar dokumentin e Bankes sipas DT - ka ofruar qasje ne kredi te Kushtezuar dhe LIDERI I KONZORCIUMIT NUK KA MBESHTETJE BANKARE NE VLERJ PREJ 40% .
- Plani dinamik jo i plotesuar sipas kerkesave te DT-se. Ne dosje te tenderit kerkohet Plani Dinamik - te prezentohet sa me i detajuar i mundeshem duke i perfshire te gjitha aktivitetet dhe pozicionet qe jane te perfshira neper paramasa nga ana e ofertuesit/Kontraktuesit, ndersa OE nuk ka ofruar te dhena sipas kerkeses se DT-se.

Grup i Operatoreve Ekonomik R & Rukolli; SABA BELCA Dega ne Kosove; ELMAZAJ KONSTRUKSION; Tekno - Konstrukt SH.P.K.

OE eshte shpall I pergjegjshem per Lot-! dhe eshte rekomanduar per shperblim me kontrate ne Lot-1 , pasi ka plotsuar kerkesat e percaktuara ne FDT, kurse ne Lot-2 ,Lot -3. Dhe Lot - 4, I njëjti ka deshtuar te plotsoj Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose , profesionale le lista paisjeve si dhe ne baz te nenit II.1.9 te Njoftimit per kontrate dhe DT, AK ka vu si kriter se ,Numri maksimal i Pjeseveqe qe dote mund te shperblehet nje tenclernes eshte: l
Ne Listen e Paisjeve eshte kerkuar Pika 10. Grejcler 12-16t,jane kerkuar 3 Grejdera. Ndersa Operatori ka ofruar 6 grejdera, 4 prej te cileve e tejkalojn kapacitetin e kerkuar: 1 grejder me kapacitet 20 t. l grejder me kapacitet 16.581 t, l grejder me kapacitet 17.534t, 1 grejder me kapacitet I Ot,
I grejder me kapacitet 15.8t.,ndersa per pajisjen nr.l (O&K) Fl56, ka ofruar faturw pate dhena mbi peshen e pajsijes, mirpo pas hulumtimit ne Internet, komisioni I v!ersimit konstaton se I njejti ka peshen prej 15.8t dhe si i till OE eshte i pergjegjshem vetem ne Lot-I pasi plotson kerkesat e percaktuara ne DT dhe Njoftimit per kontrate. Kurse ne Lot- 2. Lot- 3, dhe Lot-4, OE eshte I pa 1 pergjegjshem pasi nuk arrin te plotesoj kerkesat e percaktuar ne DT.

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i Panlit Shqyrtues të OSHP-së: 2023/0194

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

I. PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË ANKESËS 2024/0050, TË PARASHTRUAR NGA OE ""N.P.,VICTORIA INVEST INTERNATIONAL SH.P.K."

Sqarim hyrës: Parashtruesi i ankesës – OE "Victoria Invest International Sh.p.k" (më tej OE ankues) në këtë aktivitet të prokurimit ka dorëzuar ofertë për Lot 1 dhe Lot 2, rrjedhimisht pretendimet ankimore janë për këto Lote. OE ankues ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 03.01.2024, me pretendimet që lidhen me arsyet e eliminimit të OE ankues. AK me datë 09.01.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Në ankesë të dorëzuar në OSHP, krahas pretendimeve që lidhen me arsyet e eliminimit janë paraqitur edhe pretendimet ankimore në lidhje me GOE të rekomanduar për Lot1.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me kontratat e realizuara.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 1

a) AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar për OE ankues ka dhënë arsyetimin si vijon: "*OE ka dështuar te plotësoj nenin 9.1 dhe 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ASHTU SIQ ESHTE KERKUAR ne Njoftimin për kontrate dhe Dosjen e tenderit. Kërkohet: Lista e kontratave te realizuara përfunduara ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare nga data e njoftimit për kontrate. Operatori ekonomik duhet te këtë projekte te realizuara ne lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit te rrugëve, duke dëshmuar me Procesverbalet e pranimit përfundimtar te punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve në lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare. OE i mungojnë procesverbalet përfundimtare te pranimit teknik, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare. Plani dinamik jo i plotësuar sipas kërkesave te DT-se.*"

b) AK, në njoftimin për kontratë të publikuar me datë 08.03.2023, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka përcaktuar kërkesën: "*1. Operatori ekonomik duhet të*

ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, (projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve)."Për këtë kërkesë dëshmia e kërkuar është "*Dëshmia 1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve*".

c) Me datë 16.03.2023, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), përkatësisht Departamenti i Monitorimit ka dhënë rekomandimin në lidhje me këtë aktivitet, ku ndër të tjera rekomandon: "Në dosjen e tenderit Neni III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional në njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit Neni 9.1 & 9.2 Autoriteti kontraktues, pika 1 ka kërkuar "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, (projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve). Lidhur me këtë pikë që me rastin e vendosjes së kërkesave/dëshmive për pjesëmarrje dhe kualifikuese të veprojnë pajtim me nenit 69.6.2 të LPP-së i cili specifikon "*listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve...*" Pra duhet të caktohet periudha gjatë tre viteve të kaluara nga data e publikimit për kontratë, andaj KRPP ju rekomandon që duhet të përmirësoni Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e tenderit në pajtim me paragrafin 6.2, të nenit 69, të LPP-së.".

d) AK, ka publikuar tri njoftime për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara, korrigjimin me datë 17.03.2023, korrigjimin me datë 13.04.2023 dhe korrigjimin me datë 24.04.2023.

e) Me datë 24.04.2023, AK ka publikuar dosjen e tenderit të korrigjuar ku tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nuk ka vendosur (e ka larguar përmes njoftimit për korrigjime) kërkesën të cilën AK e ka precizuar si arsye të eliminimit për OE ankues.

f) Në dosjen e tenderit në aneksin 1-specifikimet teknike të detyrueshme në pjesën 19. KRITERET E PROPOZUARA PËR DHËNIEN E KONTRATËS, AK ka precizuar "*Lista e*

kontratave te realizuara përfunduara ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare nga data e njoftimit për kontrate. Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve duke dëshmuar me Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare"

g) AK në dosjen e tenderit tek Aneksi 6. Kriteri për dhënien e kontratës, ku është përcaktuar çmimi ekonomikisht me i favorshëm, ka përcaktuar nenkriteret ku me numër rendor 2 është vendosur nënkriteri "*Përvoja për punë të ngjashme*" me përshkrimin "*përvoja për punë të ngjashme në 3 vitet e fundit*".

h) OE ankues ka dorëzuar listën e kontratave;

   i. Punët e realizuara nga Victoria Invest International Sh.p.k ku janë paraqitur 2 kontrata që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve si dhe një kontratë me titull Mbyllja e vendepozitimit ekzistues të mbeturinave të ngurta ECO-Park-Durrës.

   ii. Punët e realizuara nga Victoria Invest Sh.p.k ku është paraqitur projekti "Motorway A2 Package 5 &6 Pesocani -Trebenista-Ohrid me datë të përfundimit 17.02.2021.

   iii. Është dorëzuar dokument i konfirmimit të pagesës së bashkë me certifikatën e pagesës për muajin tetor 2020 për projektin "Motorway A2 Package 5 &6 Pesocani -Trebenista-Ohrid"

i) Eksperti sqaron se në lidhje me formulimin kontrata të ngjashme, KRPP ka dhënë opinionin numër 11 me datë 09.06.2023, si vijon: "*Me LPP, saktësisht në nenin 4 (Përkufizimet) të këtij ligji dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme", megjithatë konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të LPP-së, KRPP ofron këtë: OPINION: Termi "njëjtë (i, e)" mbiemër që ka kuptimin po ai, ose po ajo gjë. Shembull: i njëjti send, i njëjti vend, e njëjta ngjyrë etj. Termi "ngjashëm (i, e)" mbiemër, ka kuptimin që ngjan shumë me një tjetër. Shembull: në raste (në rrethana) të ngjashme. Në kuptim të prokurimit*

publik: Termi " njëjtë (i, e)" ka kuptimin e një furnizimi, shërbimi a pune të njëjtë (identike) me atë që kërkohet dhe/ose lëndën e kontratës. Termi "të ngjashme" ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Shembull: Lënda e Kontratës "Furnizim me mollë". Nëse AK kërkon si dëshmi " Listën e Kontratave të furnizimeve të njëjta gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë prej minimum.....euro". Kjo duhet të nënkuptoj se OE duhet të sjellë listën e kontratave të furnizimeve me mollë në vlerën e specifikuar dhe i përjashton OE nga pjesëmarrja që kanë kryer furnizime me pemë dhe/ose perime të tjera. Prandaj një kërkesë e tillë e kufizon maksimalisht konkurrencën dhe i diskriminon operatoret ekonomik potencial (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të LPP-së). Në LPP, specifikisht në nenin 69 lidhur me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, referenca përshkruhet si në vijim: "Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara....." Pra, nuk përmendet asnjëri nga termet "të njëjta" apo "të ngjashme". Pavarësisht nga kjo, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t'i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi). Prandaj AK-të nuk duhet të specifikojnë kritere të përzgjedhjes me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për para. Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: "Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në kë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik."

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 1</u>

Eksperti sqaron se arsyetimi i AK-së në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar përbën pasaktësi për faktin se lista e kontratave të realizuara si arsye e eliminimit e precizuar nga

AK për OE ankues në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, sipas shkresave të lëndës është larguar nga kriteret e përzgjedhjes të përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Ndërsa AK në dosje të tenderit ka vendosur kërkesën që OE duhet të kenë projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve duke dëshmuar me procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare. Në lidhje me kontratat për subjektin Victoria Invest International Sh.p.k, AK ka vlerësuar se nuk janë në lëmin e kërkuar (asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve). Në lidhje me këtë sipas opinionit të KRPP-së përcaktimi i natyrës së kontratave të ngjashme është kompetencë ekskluzive e AK-së. Ndërsa në lidhje me kontratën dhe dëshminë e subjektit Victoria Invest Sh.p.k dëshmia e dorëzuar është vetëm një certifikatë mujore e pagesës dhe nuk është dëshmi konform kërkesës së AK-së për realizimin e projektit me të dhënat përkatëse. Andaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

<u>Pretendimi ankimor 2</u>

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me planin.

<u>Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 2</u>

a) AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar për OE ankues ka dhënë arsyetimin si vijon: "*Ne dosje te tenderit kërkohet Plani Dinamik – te prezantohet sa me i detajuar i mundshëm duke i përfshirë te gjitha aktivitetet dhe pozicionet qe janë te përfshira neper paramasa nga ana e ofertuesit/Kontraktuesit, ndërsa OE nuk ka ofruar te dhëna sipas kërkesës se DT-se*.".

b) Në dosjen e tenderit në aneksin 1 -specifikimet teknike të detyrueshme në pjesën 19. KRITERET E PROPOZUARA PËR DHËNIEN E KONTRATËS, është shënuar: "*Plani Dinamik - duhet të prezantohet sa më i detajuar i mundëshëm (duke i përfshirë të gjitha aktivitetet/pozicionet që janë të përfshira nëpër paramasa) nga ana e ofertuesit/Kontraktuesit*"

c) AK në dosjen e tenderit tek Aneksi 6. Kriteri për dhënien e kontratës, ku është përcaktuar çmimi ekonomikisht me i favorshëm, ka përcaktuar nenkriteret ku me numër rendor 4

është vendosur nënkriteri "*4. Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë i detajuar*".

d) OE ankues në tenderin e dorëzuar ka paraqitur dokumentin "*plani i menaxhimit dhe plani dinamik*" në të cilin nga faqe 1 deri në faqe 8 është prezantuar plani për menaxhimin e trafikut ku shënohet se është hartuar nga Burim Fetaj ing. i komunikacionit, me asistimin e Beqir Ramadani IDN - Konstruktiv dhe Nexhat Behrami IDE (Mbrojtja kundër zjarrit). Në plan përshkruhet detajet të menaxhimit të trafikut të shoqëruar me shenja të trafikut rrugor dhe skicën e rrugës. Më tej në faqet 8-9 paraqiten planet dinamike për të dy lotët në periudhën kohore prej 24 muajsh.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 2

Plani dinamik është kërkesë e vendosur nga AK në aneksin 1 të dosjes së tenderit në kuadër të kritereve të propozuara të kriterit për dhënie të kontratës, përkatësisht si nënkriter i përcaktuar nga AK në aneksin 6 të dosjes së tenderit me qëllim të përzgjedhjes së OE sipas kriterit tenderi me çmimin ekonomikisht me i favorshëm. Formulimi i kërkesës është relativ dhe jo i qartë e aq më tepër duke përdor fjalën "sa më i detajuar i mundshëm", pra duke e lënë në mundësinë e OE-ve që sipas mundësisë së tyre të thellohen në detaje. Më tej mënyra e formulimit të kriterit "*Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë i detajuar*." krijon përshtypjen që kriteri vlerësohet në dy nënndarje, fillimisht sa më i shkurtë për nga afati kohore dhe pjesa e dytë sa më mirë që është i detajuar. Sipas tabelës së poentimit të dërguar nga AK, gjatë vlerësimit është marrë për bazë vetëm afati kohor i deklaruar nga OE-të për realizimin e punëve në lotin përkatës. Andaj, duke marrë për bazë një formulim të tillë i cili për AK është subjektiv në kuptimin e vlerësimit të këtij kriteri, si dhe faktit që OE ka dorëzuar një plan i cili mund të konsiderohet më pak i detajuar mirëpo i cili jep një pasqyrë të qartë të indikatorit vlerësues "kohë", prandaj çështja e aspektit "sa më i detajuar" është vlerësim subjektiv. Rrjedhimisht, pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 3

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka rekomanduar për kontratë Grupi i OE-ve "R & Rukolli"; "SABA BELCA" Dega në Kosovë;

"ELMAZAJ KONSTRUKSION"; "Tekno - Konstrukt SH.P.K." (më tej GOE i rekomanduar për Lot 1) për faktin se i njëjti është i papërgjegjshëm për arsye se nuk ka dorëzuar dëshmitë në lidhje kërkesën 1 te kapacitetit ekonomik dhe financiar.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 3

a) AK në dosjen e tenderit, tek kërkesat e kapaciteti ekonomik dhe financiar ka vendosur kërkesën 1 si vijon: "1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë prej jo më pak se Pjesën e I-re 16,000,000.00 euro, Pjesën e II-te 14,000.000,00 euro, Pjesën e III-te 12,000.000,00-euro dhe Pjesën e IV-te 20,000.000,00 euro. "Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "1. Deklaratat Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK për tri vitet e fundit"

b) GOE i rekomanduar në lidhje me këtë kërkesë në tenderin e tij ka dorëzuar dokumentet si vijon:

   i. Dokumentin sqarues të OE "R&Rukolli" me titullin SQARIM, në të cilin shkruan: Për përmbushjen e kërkesave te specifikuara ne dosjen e tenderit nga Autoriteti Kontraktues (me tutje AK)- Ministria e Infrastrukturës ne lidhje me tenderin Numri i Prokurimit: 205- 23-1886-5-1-1 - Titulli : " Ndërtimi i urës ne zgjerimin e rrugës nacionale N9.l, segmenti nga kryqëzimi me rrugën nacionale N9 deri ne Gjakove, përkatësisht Ura mbi Lumin Dri ne fshatin Rakovine (km.0+38.25-Km.0+138.72) , përkatësisht për përmbushjen e kërkesës Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, përkatësisht Neni 8.1 & 8.2, pika 1, "Kapaciteti ekonomik dhe financiar:" i ofrojmë këtë sqarim AK-se ne lidhje me përmbushjen e kësaj kërkese nga ndërmarrja jone. Qarkullimi gjate vitit 2022: 12,516,537.49 €, Qarkullimi gjate vitit 2021: 12,727,770.01 €, Qarkullimi gjate vitit 2020: 8,908,677.32 €, Qarkullimi gjate vitit 2019: 12,885,678.33 €. Te bashkëngjitura janë Deklaratat Tatimore Vjetore për vitet 2022, 2021, 2020 dhe 2019. Dokumenti mbanë datën 14 Prill 2023."

ii. CD Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave, për OE "R&Rukolli", për periudhën e deklarimit 2022 në të cilën paraqitet se të ardhurat bruto për këtë periudhë janë 12,516,537.49.

iii. CD Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave, për OE Saba Belca-Dega në Kosovë, për periudhën e deklarimit 2020 në të cilën paraqitet se të ardhurat bruto për këtë periudhë janë 909,565.91.

iv. CD Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave, për OE Saba Belca-Dega në Kosovë, për periudhën e deklarimit 2019 në të cilën paraqitet se të ardhurat bruto për këtë periudhë janë 1,482,066.07.

v. CD Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave, për OE Saba Belca-Dega në Kosovë, për periudhën e deklarimit 2021 në të cilën paraqitet se të ardhurat bruto për këtë periudhë janë 565,798.19.

vi. CD Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave, për OE Tekno-Konstrukt, për periudhën e deklarimit 2022 në të cilën paraqitet se të ardhurat bruto për këtë periudhë janë 3,546,035.62.

vii. CD Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave, për OE Tekno-Konstrukt, për periudhën e deklarimit 2021 në të cilën paraqitet se të ardhurat bruto për këtë periudhë janë 3,110,981.91.

viii. CD Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave, për OE Tekno-Konstrukt, për periudhën e deklarimit 2020 në të cilën paraqitet se të ardhurat bruto për këtë periudhë janë 1,653,123.83.

ix. Konfirmimin nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, përkatësisht Drejtoria e Shërbimit te Tatimpaguesve te Mëdhenj, për subjektin ELMAZAJ KONSTRUKSION SHPK, ku thuhet: Ne përgjigje te kërkesës suaj me date 28.07.2021, dorëzuar ne Drejtorinë e Shërbimit te Tatimpaguesve te Mëdhenj, me objekt "Kërkesë për konfirmim të Pasqyrave Financiare 2020 dhe raportit te Audituesit te Pavarur", ju konfirmojmë bashkëlidhur kopje te tyre deklaruar nga ana juaj online ne sistemin tatimor C@TS ne datën 30.03.2021. Bashkangjitur me konfirmim është dokumenti "PASQYRAT FINANCIARE" për vitin 2020 në të cilin paraqiten Totali i aktiviteteve afatshkurta në vlerë prej 790,428.403 lekë dhe totali

i aktiviteteve afatgjata 498,678.390 lekë dhe në fund totali i aktiviteteve 1,289,106.390 lekë.

x. Konfirmimin nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, përkatësisht Drejtoria e Shërbimit te Tatimpaguesve te Mëdhenj, për subjektin ELMAZAJ KONSTRUKSION SHPK, ku thuhet: "Ne përgjigje te kërkesës suaj me date 26.05.2022, dorëzuar ne Drejtorinë e Shërbimit te Tatimpaguesve te Mëdhenj, me objekt "Kërkesë për konfirmim te Pasqyrave Financiare 2021 dhe raportit te Audituesit te Pavarur", ju konfirmojmë bashkëlidhur kopje te tyre deklaruar nga ana juaj online ne sistemin tatimor C@TS ne datën 30.03.2022". Bashkangjitur me konfirmim është dokumenti "PASQYRAT FINANCIARE" për vitin 2020 në të cilin paraqiten Totali i aktiviteteve afatshkurta në vlerë prej 790,428.403 lekë dhe totali i aktiviteteve afatgjata 498,678.390 lekë dhe në fund totali i aktiviteteve 1,289,106.390 lekë.

xi. Dokumentin - PASQYRAT FINANCIARE për vitin 2022 2020 në të cilin paraqiten Totali i aktiviteteve afatshkurta në vlerë prej 1,273,639,494 lekë dhe totali i aktiviteteve afatgjata 763,236,046 lekë dhe në fund totali i aktiviteteve 2,036,875,540 lekë.

c) Eksperti sqaron se në nenin 26.5 të Rregullores për Prokurimin Publik, përcaktohet se: "Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit."

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 3</u>

Eksperti sqaron se bazuar në dëshmitë e dorëzuara nga anëtarët e GOE të rekomanduar për kontratë, plotësohet kërkesa e specifikuar nga AK për kapacitetin ekonomik dhe financiar ku kërkohet dëshmi për qarkullimi gjatë tre viteve të fundit në vlerë prej jo më pak se 16,000,000.00 euro për pjesën 1 (Lot 1). Fakti që lideri i Grupit nuk ka dorëzuar dëshmitë për të gjitha vitet (3) nuk konsiderohet si mosplotësim i kërkesës së dosjes së tenderit. Kjo

për faktin se ashtu sikurse sqarohet me lartë kërkesa aplikohet për grupin si tërësi. Për me shumë, AK ka mund të kërkojë sqarime shtesë për deklaratat e viteve të munguara ashtu sikurse përcaktohet në Udhëzuesin për Prokurimin Publik 001/2023. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 4

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesën për menaxherin e projektit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 4

a) AK, në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka paraqitur kërkesën: " 1.Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore me se paku 5 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) në lëmin e kërkuar (ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve). Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "*Dëshmia 1.CV- për projektet e realizuara pas diplomimit-, diploma e noterizuar nga origjinali (noterizimi te mos jete me i vjetër se 6 muaj nga data e njoftimit për kontrate) Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt (noterizimi te mos jete me i vjetër se 6 muaj nga data e njoftimit për kontrate), si dhe Referenca për punët e mëparshme ne lëmin e kërkuar te lëshuar nga punëdhënësi*.".

b) GOE i rekomanduar në tenderin e dorëzuar ka paraqitur fajllin me emërtimin "6.1 Menaxheri i projektit" ku paraqiten: 1.CV e z.Ragip Behramaj, e nënshkruar. Në fund shënohet " Pas njoftimit me përmbajtjen e Kontratës, kjo Kontrate nga palët kontraktuese u nënshkrua me datën: 03.01.2023, ne Skenderaj, ne dy (2) kopje autentike, nga te cilat, secilës pale i mbetet nga një kopje." Më tej është prezantuar Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, në të cilën shënohet se z.Ragip Behramaj merr kualifikimin Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë. Diploma është lëshuar me datë 10.11.2004. Kopja e diplomës është e noterizuar.

c) Dokumenti i kontratës së punës me afat të pacaktuar i lidhur në mes të "R&Rukolli" Sh.p.k, me seli ne Skenderaj, dhe R.B, me kualifikimi Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv, ku specifikohet se i punësuari caktohet ne vendin e punës Menaxher projektesh te ndryshme ndërtimi. Më tej përcaktohet se i punësuari themelon marrëdhënie pune, në kohë të caktuar, duke filluar nga: 01.01.2023 deri me: 31.12.2023. Poashtu, është bashkangjitur dokumenti i noterizuar me numër të LRP Nr.4885/2023 - Vërtetim nënshkrimi, në të cilën shënohet: "*Sot, me datë 18.04.2023 para meje, Zyfer Aliu, Noter me seli ne Lipjan, Rruga "Lidhja e Prizrenit" p.n, vërteton se nënshkrimi i mëposhtëm i vënë në dokumentin privat të quajtur "Kontratë pune për kohë të caktuar", Ref H017/2013 e dt. 01.01.2023 është vënë nga: 1.Z.Agim Rukolli, i lindur ne F.Rezallë-Skenderaj, me vendbanim te përhershëm ne Prishtinë, shtetas i Republikës se Kosovës, identiteti i te cilit konstatohet nga letërnjoftimi, madhor me zotësi te plotë veprimi (Përfaqësuesi i "R&Rukolli " Sh.p.k). 2.Z.Ragip Behrami i lindur ne Skenderaj , me 03.03.1980. Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e dokumentit te përpiluar jashtë zyrës se tij, noteri vetëm vërteton nënshkrimin e palës të vënë në praninë e tij në zyre. Veprimi i noterizimit u krye në Lipjan, me dt.18.04.2023 në selinë e Noterit Zyfer Aliu në adresën e lartshënuar.*"

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 4</u>

Eksperti fillimisht sqaron se dorëzimi i tenderëve është bërë me datë 04.05.2023 dhe GOE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar marrëveshje valide në këtë periudhë të lidhur në mes të anëtarit të grupit OE "R&Rukolli" dhe z.Ragip Behrami. AK nuk ka respektuar afatet e përcaktuar me nenin 40 paragrafi 3, të Rregullores për Prokurimin Publik, për ekzaminimin vlerësimin, krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrjen e njoftimit mbi vendimin e AK-së. Kështu, procesi nga hapja e ofertave deri në njoftimin mbi vendimin e AK-së ka zgjatë 238 ditë kalendarike. Më tej, në lidhje me noterizimin e kontratës, eksperti sqaron se GOE ka paraqitur aktin noterial për vërtetimin e nënshkrimit të kontratës nga palët, në të cilin akt, noteri i referohet kontratës së dorëzuar nga GOE. Eksperti sqaron se në lidhje me procedurat noteriale nuk është kompetent të ekzaminojë aktet e lëshuara nga një noter dhe për çfarëdo dyshimi OE ankues mund të referojë çështjen në institucionin relevant. Andaj, duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, eksperti vlerëson se pretendimi ankimor është i

pabazuar.

Pretendimi ankimor 5

Më tej OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesën 7 të dosjes së tenderit lidhur me licencën për prodhimin e bazës se asfaltit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 5

a) AK, në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka paraqitur kërkesën: "*7. OE duhet te jete i licencuar leje për aktivitete te veçanta për prodhimin e bazës se asfaltit, prodhimin e bazës se betonit dhe OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes zhavorr*". Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "*Dëshmia 7- Kopja e licencës lejes për aktivitete te veçanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit*".

b) GOE i rekomanduar në tenderin e dorëzuar ka paraqitur dokumentet: "Leje Për Aktivitetet e Veçanta", e lëshuar me datë 30.04.2018, nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (më tej KPMM) me numër 586/KPMM/2018. Leja është lëshuar për bazë të asfaltit për biznesin "SB CONSTRACTION" Sh.p.k. në kohëzgjatje deri me datë 18.04.2023. Gjithashtu është paraqitur dokumenti - "Kërkesë për Leje për Aktivitetet e Veçanta" (formular i KPMM) e cila mbanë vulën e protokollit të KPMM me datë 05.04.2023 dhe numër të protokollit 1318. Bashkangjitur është dorëzuar edhe Fatura e lëshuar nga KPMM në lidhje me kërkesën për vazhdim të lejes. Në fund është bashkangjitur edhe dokumenti "Marrëveshje për Furnizim me Asfalt" në mes të OE "R-Rukolli" dhe "SB Construction" në të cilën shënohet: "*Me këtë vërtetojmë marrëveshjen e Shitjes (furnizimit) se materialit te gjitha llojeve te asfaltit sipas recepturave, kërkesave te projektit dhe nevojës ndërmjet: R & Rukolli SH.P.K. si blerës (qiramarrës) ne njërën ane dhe SB*

Construction SH.P.K. si shitës/furnizues (qiradhënës) ne anën tjetër. Marrëveshja lidhet për kohëzgjatjen e projektit dhe palët pajtohen qe do te respektojnë çdo kërkesë te projektit ne fjale siç është kërkuar ne dosje te tenderit. Kjo marrëveshje garanton pa vështirësi furnizimin me materialin e cekur me larte si dhe makinerisë se nevojshme për shtrimin e asfaltit ne çdo kohe dhe ne tere territorin e Kosovës. Kjo marrëveshje furnizimi me asfalt është valide për tenderin me titull: Zgjerimi i rrugës nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc, Loti 1,2,3,4 Nr. i prokurimit: 205 23 1843 511. SB Construction SH.P.K. posedon Bazën e Asfaltit te licencuar, me kapacitet prodhimit prej 150 t/h mete gjitha pajisjet dhe stafin e specializuar për kryerjen e punëve te asfaltimeve." Marrëveshja është nënshkruar me datë 18.04.2023 dhe është vulosur nga palët.

c) Së bashku me marrëveshjen është dorëzuar edhe dokumenti i noterizuar me numër të LRP Nr.5399/2023 - Vërtetim nënshkrimi në të cilën shënohet " *Sot, me date 24.04.2023 para meje, Zyfer Aliu, Noter me seli ne Lipjan ,Rruga" Lidhja e Prizrenit" p.n, vërteton se Nënshkrimi i mëposhtëm i vene ne dokumentin privat te quajtur "Marrëveshje për furnizim me asfalt", e dt.18.04.2023 është vene nga:1.z.Ragip Behrami i lindur ne Skenderaj, me vendbanim te përhershëm ne Skenderaj, shtetas i Republikës se Kosovës, madhore me zotësi te plote veprimi (I autorizuar i "R&Rukolli " sh.p.k.) 2.Z.Drilon Etemi, nga i ati Etem, i lindur ne Presheve-R. Serbise, me vendqëndrim ne Prishtinë, shtetas i Republikës se Maqedonisë se Veriut, madhor, me zotësi te plotë veprimi (I autorizuar i "SB Construction sh.p.k.") Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e dokumentit te përpiluar jashtë zyrës se tij , noteri vetëm vërteton nënshkrimin e palës te vene ne praninë e tij dhe ne zyrën e tij. Veprimi i noterizimit u krye ne Lipjan, me dt.24.04.2023 ne selinë e Noterit Zyfer Aliu ne adresën e lartshënuar* "

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 5</u>

Eksperti sqaron se GOE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Lejen për Aktivitetet e Veçanta, për bazë të asfaltit, e lëshuar nga KPMM me afat deri me datë 18.04.2023, që i bie të ketë pasur vlefshmëri në kohën e publikimit për kontratë, ndërsa leja ka skaduar para afatit për dorëzimin e tenderëve. Gjithashtu, GOE i rekomanduar ka dorëzuar edhe kërkesën e bërë në KPMM për vazhdimin e lejes. Megjithatë, marrë për bazë faktin se afati i

lejes ka skaduar dhe faktit që GOE ka dorëzuar si dëshmi formularin për vazhdimin e lejes, si dokument zyrtar i KPMM-së, AK për të konstatuar se plotësohet apo jo kërkesa e dosjes së tenderit, përkatësisht GOE ka kapacitetin për të përmbushur kontratën është dashur të kërkojë informacione shtesë nga GOE apo KPMM se a ka subjekti licencë të vlefshme për veprimtarinë përkatëse. Andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 6

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë ka dështuar të dëshmojë se përmbushë kërkesën për pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës DT, përkatësisht kërkesën 10 te Listës se pajisjeve Greder 12-16t - 3 cope.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 6

a) Në lidhje me pajisjet, AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ka paraqitur Pajisjet dhe Mekanizimin e Obligueshëm për secilin Lot, ku për Lot 1 është paraqitur tabela me 22 pajisjet, ndër të tjera edhe pozicioni 10 - Grejder 12-16t, sasia e kërkuar (2 copë). Si dëshmi është kërkuar për të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamionë rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj).

b) GOE i rekomanduar për Lot 1 ka dorëzuar dokumentin "8.00 Lista e pajisjeve" ku për pozicionin 10 janë paraqitur të dhënat për 6 grejderë si vijon:
    1) 1999; e mire; O&K F156; pesha 15.St; pronar Rukolli; Fature, Foto.
    2) 1994; e mire; O&K F156; pesha 15.St; pronar Rukolli; Fature, DUD, Foto.
    3) 2004; e mire; Volvo G 726 B; pesha 16t; pronar Rukolli; DUD, Foto.
    4) 2008; e mire; CAT 140M; pesha 15.lt; Elmazaj Konstruksion; DUD; fature; Foto. kontrate.
    5) 10.5.2008; e mire; CAT 120M; pesha 14.lt; Elmazaj Konstruksion; DUD; fature; Foto. kontrate.
    6) 1982; e mire; O&K F 105; pesha 9.2t; pronar Rukolli; DUD, Foto.

Në fund të listës shënohet: Kapacitetin e pajisjeve mund te kontrolloni ne ueb: https://www.lectura-specs.com/en/model

c) Gjithashtu, është dorëzuar dokumenti "8.07 Grejder-kerkesa10"

i. Përshkrimi: Greder (Rrafshues) TIPI: O&K F156, Kapaciteti: 15.8 T, viti i prodhimit: 1999, Ngjyra: e Kuqe. Është dorëzuar fatura e shitblerjes nr. 45/2020 e lëshuar nga "Vëllëzrit Ramadani" e cila mbanë datën: 04.02.2021 me përshkrimin: Greder i përdorur Marka: O&K, Tipi: F156, Nr. serisë 107359, Viti i prodhimit: 1999, "grederi asht me defekt trapi i parë", nr i DUD-it 9855/2020.

ii. Përshkrimi: Greder (Rrafshues) TIPI: O&K F156, Kapaciteti: 15.8 T, viti i prodhimit: 1994, Ngjyra: e Kuqe. Është dorëzuar fatura e shitblerjes nr. 45/2020 e lëshuar nga NP"EURO BAG" e cila mbanë datën: 23.11.2020 me përshkrimin: Greder i përdorur Marka: O&K, Tipi: F156, Ngjyra e kuqe, Viti i prodhimit: 1994, Shenja&nr: 106559.

iii. Poashtu është dorëzuar Dokumenti Unik Doganor me numër të referencës doganore 28550, datë 23.11.2020 ku paraqitën të dhënat e pajisjes: GREDER O&K tipi F156, Viti i prodhirnt-1994, Nr serik 106569 dhe peshë 15.800.00 kg (neto dhe bruto).

iv. Përshkrimi: Greder (Rrafshues) TIPI: Volvo G 726 B, Kapaciteti: 16T, viti i Prodhimit: 2004, Ngjyra: e Verdhë. Poashtu është dorëzuar Dokumenti Unik Doganor ku paraqitën të dhënat e pajisjes: Sheshuesit dhe niveluesit e përdorur Marka Volvo G 726 B, numri i serisë 036495 Viti i prodhimit-2004, Nr. serik 106569 dhe peshë 20.000.00 kg (neto dhe bruto).

v. Përshkrimi: Greder (Rrafshues) TIPI: O&K F 105, Kapaciteti: 16T, Viti i Prodhimit: 1982, Ngjyra: e Gjelbër. Poashtu është dorëzuar Dokumenti Unik Doganor ku paraqitën të dhënat e pajisjes: Greder i përdorur, Marka: O&K, Tipi: F 105, Ngjyra e kaltër, Viti i prodhimit: 1982, nr. serik 3210807 dhe peshë 10.000.00 kg.

vi. Ofertë nr.310 "Teknoxgroup" ku përshkruhet modeli Cat 140 M me përshkrimin: Pesha e makinës bazë: 16,581 kg. Pesha e makinës maksimale me te gjitha opsionet 23,583 kg.

vii. Ofertë nr.323 "Teknoxgroup" ku përshkruhet modeli Cat 120 M me përshkrimin: Pesha standard e makinës pa aksesor 17,534 kg dhe Pesha e makinës me gjithë aksesor

23,100 kg.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 6

Eksperti sqaron se nga 6 pajisjet – Greder të paraqitur në listën e pajisjeve nga GOE i rekomanduar për kontratë për Lot 1, sipas dëshmive të dorëzuara për pajisjen me numër rendor 1 (O&K tipi F156 viti 1999) nuk ka paraqitur të dhëna për peshën si dhe nuk ka dorëzuar dëshminë – Deklaratë Unike Doganor. Për pajisjen me numër redor 2 (O&K tipi F156 viti 1994) ka peshën në intervalin 12-16 T. Pajisja me numër rendor 3 (Volvo G 726 B) ka peshën 20.000.00 kg. Pajisja me numër rendor 4 (O&K, Tipi: F 105) ka peshën 10.000.00 kg, dhe pajisja me numër rendor 5 (Cat 140 M) ka peshën 23,583 kg. Si përfundim, eksperti sqaron AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së se në raport me vlerësimin për pajisjet. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë.

Pretendimi ankimor 7

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë ka dështuar të dëshmojë se përmbushë kërkesën për pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës DT, përkatësisht kërkesën 16 te Listës se pajisjeve, Cilindrat me rrota të kombinuara(gomë dhe hekur), min 6.5 t, ku pajisjet e prezantuara me numër rendor 4, 5 dhe 7 nuk plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 7

a) Në lidhje me pajisjet, AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ka paraqitur Pajisjet dhe Mekanizimin e Obligueshëm për secilin Lot, ndër të tjera edhe pozicioni 16 te Listës se pajisjeve, Cilindrat me rrota të kombinuara(gomë dhe hekur), min. 6.5 t, sasia e kërkuar: Lot 1 është 5 copë. Si dëshmi është kërkuar për të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamionë rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj).

b) GOE i rekomanduar për Lot 1 ka dorëzuar listën e pajisjeve ku në lidhje me pozicionin 16

ka paraqitur të dhënat për pajisjet si vijon:

1) 1998; e mire; AMMANN 635 D; nr. shasise 89735; pesha 8t; pronar Saba Belca; NR(RO) VRAAC-42.
2) 2007; e mire; HAMM HD 075K; nr. shasise HI 730653; pesha 7.335t; pronar Saba Belca; Fature NO. 62/V/15.
3) 1988; e mire; HAMM KHD.DV ; nr. shasise 1530876152530; pesha 9.5t; pronar Saba Belca; NO. VRAAK-33.
4) 1997; e mire; HYSTER C 530 A; nr. shasise 1521 N; pesha 7t; pronar Saba Belca; NR(RO) VRAAD-80.
5) 1990; e mire; CASE W602BD; nr. serik JKC9103402; pesha 7.5t; pronar Rukolli; DUD 3042;
6) 2009; e mire; Dynapac CC 232 HF; nr. serik 62011233; pesha 7.2t; Elmazaj Konstruksion; Fature; Foto.
7) 2009; e mire; Dynapac CC 232 HF; nr. serik 341562 CHF; pesha 7.2t; Elmazaj Konstruksion; Fature; Foto.

c) GOE i rekomanduar për Lot 1 ka dorëzuar dëshmi e regjistrimit të lëshuar nga Republika e Serbisë për pajisjen AMMANN, modeli 653D mirëpo nuk është dorëzuar ndonjë dëshmi tjetër. Në lidhje me këtë pajisje eksperti ka kërkuar në ueb faqen https://www.lectura-specs.com por nuk ka informata për një pajisje të tillë. Ndërsa në kërkimin në internet, të gjitha informatat e shfaqura tregojnë se pajisja është me të gjitha rrotat hekur.

d) Për pajisjen HYSTER C 530 është dorëzuar dëshmi e regjistrimit e lëshuar nga Republika e Serbisë mirëpo nuk është dorëzuar ndonjë dëshmi tjetër. Në lidhje me këtë pajisje eksperti ka kërkuar në ueb faqen https://www.lectura-specs.com por nuk ka informata për një pajisje të tillë. Ndërsa në kërkimin në internet, të gjitha informatat e shfaqura tregojnë se pajisja është me të gjitha rrotat gome.

e) Për pajisje Dynapac CC 232 HF është dorëzuar fatura e shitjes të lëshuar nga Delia Group për pajisjen Dynapac CC 232 HF me nr. serik 341562 si dhe ka bashkangjitur fotografinë ku shihet se pajisja është me rrota hekuri dhe jo rrota të kombinuara (gomë dhe hekur).

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 7

Sipas sqarimeve të mësipërme, eksperti vlerëson se GOE i rekomanduar për kontratë për Lot 1, në lidhje me përmbushjen e kërkesës së pajisjeve për pozicionin 16, nga 7 pajisjet e ofruara, për njërën pajisjeve (CC 232 HF me nr. serik 341562) sipas dëshmive të dorëzuara shihet që nuk është konform kërkesës së AK-së. Ndërsa për një pajisje tjetër (HYSTER C 530) në bazë të kërkimit në internet është evidente se nuk është me rrota të kombinuara. Andaj pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë.

Pretendimi ankimor 8

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë ka dështuar të dëshmojë se përmbushë kërkesën për pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës DT, përkatësisht kërkesën 17 te Listës se pajisjeve, Cilindrat me rrota hekuri me vibrim min, 6.5 t, ku pajisja e prezantuara me numër rendor 4 nuk plotëso kërkesat e dosjes së tenderit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 8

a) Në lidhje me pajisjet, AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ka paraqitur Pajisjet dhe Mekanizimin e Obligueshëm për secilin Lot, ndër të tjera edhe pozicioni 16 te Listës se pajisjeve, Cilindrat me rrota hekuri me vibrim min, 6.5, sasia e kërkuar: Lot 1 është 5 copë. Si dëshmi është kërkuar për të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamionë rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj).

b) GOE i rekomanduar për Lot 1 ka dorëzuar listën e pajisjeve ku në lidhje me pozicionin 17 ka paraqitur të dhënat për pajisjen me numër rendor 4: Bomag BW 141 AD-4.

c) GOE i rekomanduar për Lot 1 ka dorëzuar dëshmi e regjistrimit të lëshuar nga Republika e Serbisë për pajisjen Bomag, modeli BW 141 AD-4 ku shkruan "ukupna masa" (pesha totale) 5900.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 8

Sipas sqarimeve të mësipërme, eksperti vlerëson se GOE i rekomanduar për kontratë për Lot 1, në lidhje me përmbushjen e kërkesës së pajisjeve për pozicionin 17, ku është kërkuar 5 pajisje dhe nga 5 pajisjet e ofruara, për njërën (Bomag BW 141 AD-4) sipas dëshmive të dorëzuara shihet që nuk është konform kërkesës së AK-së, përkatësisht pesha nuk është minimum 6.5 t. Andaj pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë.

II. PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË ANKESËS 2024/0050, TË PARASHTRUAR NGA OE "RSM COMPANY SH.P.K."

Sqarim hyrës: Parashtruesi i ankesës – OE "RSM Company SH.P.K." (më tej OE ankues) si anëtar i Grupit të OE-ve Groma Hold EOOD; RSM Company SH.P.K.: ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 03.01.2024, me pretendimet që lidhen me arsyet e eliminimit të OE ankues. AK me datë 09.01.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me marrëveshjen për themelimin e grupit dhe se udhëheqës (lider) i grupit është anëtari-OE "Groma Hold EOOD"

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 1

a) AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar për OE ankues ka dhënë arsyetimin si vijon: "Marrëveshja për themelimin e grupit nuk është ne përputhje me Ligjin e Prokurimit Publike, dhe Rregullat e Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publike për themelimin e grupit - konzerciumit. Sipas Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik neni 27.3 citoj : Secili anëtarë i grupit duhet te përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, neni 65 i LPP-se. çdo kërkesë e vendosur nga autoriteti kontraktues sipas neneve 66.2, 68, dhe 69 te LPP-se do te aplikohet vetëm ndaj grupit si tersi dhe jo ndaj anëtarëve individual te grupit, kurse ne mbështetjen bankare ceket se kompania Groma Hold EOOD është partner udhëheqës, ndërsa ne nenin 3.2. te marrëveshja për themelimin e grupit ceket se pjesëmarrja e përbashkët e Groma Hold EOOD dhe RSM Company SH.P.K., thuhet se kompania Groma Holld EOOD ne cilësinë e saj si partner ne kontratë do te kryej vetëm shërbime konsulentë dhe nuk do te mbaj asnjë përgjegjësi ne lidhje me ekzekutimin e kontratës dhe si e tillë kjo marrëveshje është ne kundërshtim me Deklaratën mbi marrjen e përgjegjësisë bashkarishte dhe individualisht për formimin e grupit Prandaj i njëjti nuk është kualifikuar ne fazën e poentimit."

b) AK, në dosjen e tenderit, tek seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit, në nenin 11.1 Krijimi

i një grupi të operatorëve ekonomik, kërkohet: "a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës, b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT."

c) Grupi i OE-ve ankues në tenderin e tij kanë dorëzuar fajllin: "1 Joint Venture dhe Deklaratat nen betim.". në të cilin janë bashkangjitur:

i. Kontratën e përpiluar në gjuhen angleze dhe bullgare e lidhur për themelimin e grupit të përbashkët, të përbërë nga: 1. N "GROMA HOLD EOOD & RSM COMP ANY SHPK", për qëllime tenderimit ne prokurim publik me titull: "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9- Segmenti Kijeve-Dollc, Loti 1,2,3,4, me numër te procedurës tenderi: 205-23-1843- 5-1. -1". Në nenin 3 të kontratës specifikohet: "*Ne rast se kontrata për ekzekutimin e prokurimit publik me subjekt Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9- Segmenti Kijeve- Dollc, Loti 1,2,3,4, me nr. tenderit: 205-23-1843-5. -1 -1" do ti jepet grupit të përbashkët: "GROMA HOLD EOOD & RSM COMPANY SHPK", palët bien dakord që: 3.1. Kontrata për zbatimin e nënshkruar ndërmjet "GROMA HOLD EOOD & RSM COMPANY SHPK" dhe Klientit Ministria e Infrastrukturës do të ekzekutohet nëpërmjet partnerit të sipërmarrjes së përbashkët - RSM Company Shpk.*". Më tej në paragrafin 2 të nenit 3 të kontratës thuhet: "*SIPËRMARRJA E PËRBASHKËT "GROMA HOLD EOOD & RSM COMPANY SHPK" cakton "Groma Hold" EOOD, në cilësinë e saj si partner në grup, të kryejë vetëm dhe ekskluzivisht shërbime konsulence për ekzekutimin e Kontratës me Klientin dhe ky i fundit nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi në lidhje me ekzekutimin e kontratës*.". Në fund, kontrata është nënshkruar nga: Për grupin "GROMA HOLD EOOD & RSM COMPANY SHPK"", përfaqësuar nga Shpat Kamberi. Për "RSM Company" përfaqësuar nga z.Agim Kola. Për "GROMA HOLD EOOD"

përfaqësuar nga z.Viktor Velev. Kontrata në secilën faqe mban vulën e noterit: Margarita Golomehova – Kostadinova, me adresë në Blagoevgrad.

ii. Dokumentin në gjuhën angleze me titull *"Autorizim" me tekstin në vijim: "Ne, të nënshkruarit, si përfaqësues të J.V. "Groma Hold EOOD & RSM Company sh.p.k.", autorizojmë z.Agim Kola të veprojë në emër të grupit, të gjitha veprimet e nevojshme, nënshkrimin e tenderit dhe çdo dokumentacion në lidhje me tenderin nga Ministria e Infrastrukturës me titull: "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9- Segmenti Kijeve-Dollc, Loti 1,2,3,4" me nr. prokurimit: 205-23-1843-5-1-1."*

iii. Dokumentin në gjuhën angleze me titull "Deklaratë" me tekstin në vijim: *Unë, I nënshkruari, Viktor Georgiev Velev si menaxher përfaqësues i shoqëria Groma Hold EOOD dhe si anëtare e J.V. "Groma Hold EOOD & RSM Company sh.p.k., deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë, se jam plotësisht përgjegjës, bashkërisht dhe individualisht, për tenderin nga Ministria e Infrastrukturës me titull: "Zgjerimi i Rruges Nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc, Loti 1,2,3,4" me nr. prokurimit: 205-23-1843-5-1-1.*

iv. Dokumentin në gjuhën angleze me titull "Deklaratë" me tekstin në vijim: *"Unë, i nënshkruari, Viktor Georgiev Velev si menaxher përfaqësues i shoqëria Groma Hold EOOD dhe si anëtare e J.V. "Groma Hold EOOD & RSM Company sh.p.k., konfirmoni pjesëmarrjen tonë në grup dhe konfirmoni që ne nuk marrim pjesë individualisht dhe/ose në çdo grup tjetër pjesëmarrës në të njëjtën procedurë të prokurimit, për tenderin nga Ministria e Infrastrukturës me titull: "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc, Loti 1,2,3,4" me nr. prokurimit: 205-23-1843-511.*

v. *Dokumentin me titull "Deklarate për Konfirmim Pjesëmarrje Ne Grup" me tekstin si vijon: "Unë I poshtë nënshkruari Agim Kola, drejtor i kompanisë RSM Company shpk dhe si pjesëtar i grupit J.V. Groma Hold EOOD& RSM Company sh.p.k.", konfirmojmë pjesëmarrjen tone në grup dhe konfirmojmë se ne nuk jemi duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtë të prokurimit, për tenderin nga Ministria e Infrastrukturës, me titull: " Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijevë-Dollc, Loti 1,2,3,4 " me nr. prokurimi: 205-23- 1843-5-1-1." Dokumenti është i nënshkruar dhe vulosur nga anëtari "RSM Company shpk"*

vi. *Dokumentin me titull "Deklarate mbi Përgjegjësinë" me tekstin si vijon: "Unë I poshtë nënshkruari Agim Kola, drejtor i kompanisë RSM Company shpk dhe si pjesëtar i grupit J.V. Groma Hold EOOD& RSM Company sh.p.k.", deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se jam përgjegjës si bashkërisht dhe individualisht për tenderin nga Ministria e Infrastrukturës, me titull: "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijevë-Dollc, Loti 1,2,3,4 " me nr. prokurimi: 205-23-1843-5-1-1, nëse fitojmë të drejtën për ekzekutimin e projektit në fjalë."*

vii. *Deklaratën nën betim sipas Aneksit 2 të plotësuar në gjuhën angleze nga anëtari i grupit "Groma Hold EOOD".*

viii. *Deklaratën nën betim sipas Aneksit 2 të plotësuar nga anëtari i grupit "RSM COMPANY SHPK".*

ix. *Grupi i OE-ve ankues me qëllim të prezantimit të dëshmisë për plotësimin e kërkesës 2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, në tenderin e tij kanë dorëzuar poashtu dokumentin me emërtimin: "3 Deklarata e bankës për mjete ne llogari", të lëshuar nga Investbank AD, dega në Blagoevgrad, me numër: 8049-46, të datës 11.04.2023, në të cilin thuhet: "INVESTBANK AD lëshon referencën aktuale bankare në favor të kompanisë GROMA HOLD EOOD me adresë menaxheriale në 2709 Belo Pole, Komuna Blagoevgrad, me UIC: 101611650, përfaqësuar nga Victor Georgiev Velev, Kompania është një partner besnik dhe nuk ka detyrime të papaguara. drejt bankës. GROMA HOLD EOOD ka hapur llogarinë rrjedhëse aktive. Kompania ka fondet e veta në llogarinë bankare në Investbank në shumën mbi 2,000,000.00-euro (dy milionë euro) për financimin e procedurës së tenderit. Kjo referencë bankare do të shërbejë pranë Ministrisë së Infrastrukturës së Republikës së Kosovës, Ndërtesa Gërmia, zyra A/104, 1000 Prishtinë, Republika e Kosovës për pjesëmarrjen e kompanisë si grup i përbashkët "Groma Hold EOOD" & "RSM Company SHPK" (Groma Hold EOOD partner kryesor - 52% dhe RSM Company SHPK - 48%;) në procedure te tenderit me titull: Zgjerimi i Rruges Nacionale N9 -Segmenti Kijeve - Dolle, Loti 1,2,3,4, Tender Prokurimi Nr : 205-23-1843-5 -1 -1 (Zgjerimi i rrugës së republikës nr. 9, seksioni Kijevë-Dollc, Loti 1,2,3,4 me numrin e procedurës së tenderit: 205-23-1843-5-1-1). Referenca është lëshuar pa ndonjë zotim specifik për Investbank.*

x. *Në lidhje me Grupin e OE-ve në Neni 71 të LPP-së, paragrafi 3, përcaktohet: "Të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe secili veçmas të përgjegjshëm para autoritetit kontraktues për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i epet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Të gjitha autoritetet kontraktuese në dosjet e tyre të tenderit duhet ta përfshijnë një njoftim lidhur me këtë çështje."*

d) Poashtu, në Rregulloren për Prokurimin Publik, Neni 26, përcaktohet: "*26.1 Një tender mund të dorëzohet nga një grup i Operatorëve ekonomik. Në këtë rast grupi, me tenderin e tyre, duhet te: a. Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për përformancën e kontratës; b. Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm); c. Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veproj në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm; dhe d. Secili anëtar i grupit duhet të jetë i regjistruar në platformën elektronike, kërkesë e cila duhet të përcaktohet në dosje të tenderit. 26.2 Deklaratat e kërkuara në (a), (b) dhe (c) të paragrafit 26.1, mund të përfshihen në një dokument."*

e) OE ankues, në kërkesën për rishqyrtim dhe në këtë ankesë në lidhje me këtë pikë ka paraqitur pretendimin si vijon: "*Kurse ne si Grup i OE, ne materialin tenderues kemi paraqitur te gjitha deklaratat dhe dokumentet përkatëse qe mbulojnë pikat a,b,c dhe d, dhe te njejtat ndodhen ne materialin tenderues qe kemi dorezuar per kete aktivitet te prokurimit. Kompania Groma Hold EOOD eshte lider i ketij grupi, dhe deklarata për piken a. ku kompania lider ne kete rast Groma Hold EOOD deklaron me përgjegjësi te plote se është përgjegjës si individualisht ashtu edhe bashkarisht per kete aktivitet te prokurimit. Çfarëdo tendence tjetër për interpretim ndryshe te deklarimeve përben shkelje flagrante ligjore, dhe devijim i qëllimshëm*

i fakteve për arsye te ndryshme."

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 1

Eksperti sqaron se provat shkresore të dorëzuara nga GOE janë kundërthënëse. Me qëllim të përmbushjes së kërkesës të përcaktuar në nenin 11.1, pika c), të FTD-së, në lidhje me krijimin e grupit të OE-ve, është dorëzuar dokumenti i autorizimit ku thuhet se: autorizohet z.Agim Kola (d.m.th. pronari por jo partneri kryesor sikurse përcaktohet në kërkesë) që të veprojë në emër të grupit, për të gjitha veprimet e nevojshme, nënshkrimin e tenderit dhe çdo dokumentacion në lidhje me tenderin. Në anën tjetër në lidhje me plotësimin e kërkesës numër 2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar të dosjes së tenderit, ku kërkohet që lideri i grupit duhet te ketë min. 40% te mbështetjes bankare, GOE ka dorëzuar deklaratën e bankës të lëshuar nga Investbank AD përshkruhet se anëtari "GROMA HOLD EOOD" ka fondet e veta në llogarinë bankare në Investbank në shumën mbi dy milionë euro për financimin e procedurës së tenderit dhe se referenca bankare shërben për Ministrinë e Infrastrukturës së Republikës së Kosovës, për pjesëmarrjen e kompanisë si grup i përbashkët Groma Hold EOOD partner kryesor - 52% dhe RSM Company SHPK - 48%. Poashtu, në pretendimet ankimore në kërkesën për rishqyrtim dhe në këtë ankesë OE ankues thekson se anëtari i grupit Groma Hold EOOD është lider i grupit. Më tej, anëtarët e grupit sikurse është sqaruar me lartë kanë dorëzuar deklaratat ndaras në lidhje me kërkesën e përcaktuar në nenin 11.1, pika a) e FTD-së. Në të dy deklaratat mungon pjesa e fundit e tekstit të kërkesës "në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës". Në kontratën e noterizuar për krijimin e grupit, të nënshkruar nga palët thuhet se kontrata do të ekzekutohet nëpërmjet partnerit RSM Company Sh.p.k dhe se Groma Hold EOOD, në cilësinë si partner në grup, të kryejë vetëm dhe ekskluzivisht shërbime konsulence për ekzekutimin e kontratës me klientin dhe nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi në lidhje me ekzekutimin e kontratës. Andaj, sipas sqarimit të mësipërme, dëshmitë e dorëzuara nga GOE nuk janë konform kërkesave të nenit 72 paragrafi 3 i të LPP-së, Nenit 26, paragrafi 1, i Rregullores për Prokurim Publik dhe kërkesës e përcaktuar në nenin 11., pika a) të FTD-së. Rrjedhimisht pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 2

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me planin dinamik.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 2

a) AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar për OE ankues ka dhënë arsyetimin si vijon: "*Plani dinamik jo i plotësuar sipas kërkesave te DT-se. Ne dosje te tenderit kërkohet Plani Dinamik - te prezantohet sa me i detajuar i mundshëm duke i përfshirë te gjitha aktivitetet dhe pozicionet qe janë te përfshira neper paramasa nga ana e ofertuesit/Kontraktuesit, ndërsa OE nuk ka ofruar te dhëna sipas kërkesës se DT-se.*".

b) AK, në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka paraqitur kërkesën: "*8.Plani Menaxhimit te trafikut sa me i detajua*". Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është "*Dëshmia 8.Planit të menaxhimit të trafikut i hartuar dhe nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit dhe i vulosur nga kompania Duke pasur parasysh frekuentimin e kësaj rruge (ku i ka përafërsisht 18,000 automjete për 24h, mesatarja vjetore), duhet të përgatitet sa më i detajuar (i përcjellur me skica dhe shenja përkatëse të trafikut rrugorë) duke e studiuar mirë edhe duke pasur parasysh gjendjen në teren të rrugës dhe strukturave (në mënyrë që të mos ketë bllokim të komunikacionit*".

c) AK, ka bërë njoftimin për kontratë dhe ka publikuar dosjen e tenderit me datë 08.03.2023.

d) AK, ka publikuar tri njoftime për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara, korrigjimin me datë 17.03.2023, korrigjimin me datë 13.04.2023 dhe korrigjimin me date 24.04.2023.

e) Me datë 24.04.2023, AK ka publikuar dosjen e tenderit të korrigjuar ku tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nuk ka vendosur kërkesën të cilën AK e ka precizuar si arsye të eliminimit për OE ankues.

f) Më tej, AK në dosjen e tenderit tek Aneksi 6. Kriteri për dhënien e kontratës, ku është përcaktuar çmimi ekonomikisht me i favorshëm, ka përcaktuar nenkriteret ku me numër rendor 4 është vendosur nënkriteri "*4. Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë I detajuar*".

g) OE ankues në tenderin e dorëzuar ka paraqitur katër dokumente të planeve dinamike për secilin lot të cilat pasqyrojnë pozicionet kryesore dhe kanë kohëzgjatjen për secilin lot.

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 2</u>

Plani dinamik është kërkesë e vendosur nga AK në aneksin 1 të dosjes së tenderit në kuadër të kritereve të propozuara të kriterit për dhënie të kontratës, përkatësisht si nënkriter i përcaktuar nga AK në aneksin 6 të dosjes së tenderit me qëllim të përzgjedhjes së OE sipas kriterit tenderi me çmimin ekonomikisht me i favorshëm. Formulimi i kërkesës është relativ dhe jo i qartë e aq më tepër duke përdor fjalën "sa më i detajuar i mundëshëm", pra duke e lënë në mundësinë e OE-ve që sipas mundësisë së tyre të thellohen në detaje. Më tej mënyra e formulimit të kriterit "*Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë i detajuar*." krijon përshtypjen që kriteri vlerësohet në dy nënndarje, fillimisht sa më i shkurtë për nga afati kohore dhe pjesa e dytë sa më mirë që është i detajuar. Sipas tabelës së poentimit të dërguar nga AK, gjatë vlerësimit është marrë për bazë vetëm afati kohor i deklaruar nga OE-të për realizimin e punëve në lotin përkatës. Andaj, duke marrë për bazë një formulim të tillë si dhe faktit që OE ka dorëzuar një plan i cili mund të konsiderohet më pak i detajuar mirëpo i cili jep një pasqyrë të qartë të indikatorit vlerësues "kohë" atëherë i njëjti është dashur të merret për bazë, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 3

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 3

a) AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar për OE ankues ka dhënë arsyetimin si vijon: "OE ka dështuar te plotësoj edhe Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, Kërkesa : 1. Operatori ekonomik duhet te ofroje dëshmi te kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjate tre viteve te fundit ka qene ne vlere prej jo me pak se Dëshmia e kërkuar: 1. Deklaratat Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK për tri vitet e fundit. Pjesën e I-re 16,000,000.00 euro. Pjesën e II-te 14,000.000,00 euro. Pjesën e III-te 12,000.000,00 euro. Pjesën e IV-te 20,000.000,00 euro.

b) OE nuk ka paraqitur Deklaratat Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK për vitin 2022 ashtu siç është kërkuar ne 3 vitet e fundit ne kërkesat e përcaktuara ne Njoftimin për kontrate dhe Dosjen e tenderit."

c) AK në dosjen e tenderit, tek kërkesat e kapaciteti ekonomik dhe financiar ka vendosur kërkesën 1 si vijon: "1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë prej jo më pak se Pjesën e I-re 16,000,000.00 euro, Pjesën e II-te 14,000.000,00 euro, Pjesën e III-te 12,000.000,00-euro dhe Pjesën e IV-te 20,000.000,00 euro." Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "1. Deklaratat Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK për tri vitet e fundit".

d) GOE i rekomanduar në lidhje me këtë kërkesë në tenderin e tij ka dorëzuar dokumentet si vijon:

i. CD Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave, për OE "RSM Company", për periudhën e deklarimit 2021 në të cilën paraqitet se të ardhurat bruto për këtë periudhë janë 1,321,612.13 euro.

ii. CD Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave, për OE "RSM Company", për periudhën e deklarimit 2020 në të cilën paraqitet se të ardhurat bruto për këtë periudhë janë 1,489,479.29 euro. CD Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave, për OE "RSM Company", për periudhën e deklarimit 2019 në të cilën paraqitet se të ardhurat bruto për këtë periudhë janë 1,932,774.45 euro.

iii. Raporti në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare nga auditori i pavarur për vitin 2021.

iv. Raporti në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare nga auditori i pavarur për vitin 2020.

v. Raporti në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare nga auditori i pavarur për vitin 2019.

e) Eksperti sqaron se në nenin Neni 68 të LPP-së në paragrafin 1 përcaktohet: "Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohet, qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do ti referohen maksimum tri viteve të fundit financiare. Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës. Në përgjithësi, operatorëve ekonomik u lejohet të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim: 1.1. raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka; 1.2. evidencë të një police të sigurimit

të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve; 1.3. kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose 1.4. kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose 1.5. Deklaratat

Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës". Më tej në paragrafin 2: "Autoriteti kontraktues do të specifikojë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tender ose pjesëmarrje, se cilat nga referencat e sipërpërmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dhe/ose referencat e tjera kërkohen prej tij.". Në fund në paragrafin 3 thuhet "Nëse për ndonjë arsye të vlefshme, operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktues, operatorit ekonomik i lejohet që të demonstrojë gjendjen e vetë ekonomike dhe financiare përmes dokumentit tjetër që autoriteti kontraktues, në ushtrimin e diskrecionit të tij të arsyeshëm, e konsideron të përshtatshëm."

f) Në Udhëzuesin për Prokurimin Publik të publikuar nga KRPP, në lidhje me kërkesat e gjendjes ekonomike dhe financiare, në faqe 31 është dhënë sqarimin si vijon: Shënim: Kërkesa e gjendjes ekonomike dhe financiare është një kusht minimal për kualifikim. Do të thotë se të gjithë tenderët që përmbushin këtë kërkesë minimale përmbushin kushtin e gjendjes ekonomike, dhe nuk kane rëndësi rastet kur dëshmia është shume me e madhe se kërkesa minimale e përcaktuar. Në rastin kur kërkesa e gjendjes ekonomike dhe financiare i referohet një qarkullimi total prej 3,000,000 euro në tri vitet e fundit dhe Operatori ekonomik përmbush kërkesën e përcaktuar ne dokumentet e tenderit në vetëm dy vite apo një vit, konsiderohet se OE ka përmbushur kërkesën minimale. Kushti minimal është përmbushur duke prezantuar dëshmitë e qarkullimit total prej € 3,000,000 në tre vite, dhe nuk ka rëndësi se sa ka qenë qarkullimi në secilin vit veç e veç.

g) Eksperti sqaron se në lidhje me në lidhje me kërkesat e gjendjes ekonomike dhe financiare, KRPP ka dhënë interpretimin me numër rendor 24 me datë 29.03.2023, si vijon: "Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L- 092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruara, KRPP sqaron si në vijim: Paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i LPP-së, përcakton: "1.5 Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën tatimore të Kosovës" Kjo dispozitë në fakt, nënkupton se këtë dëshmi mund ta sjellin vetëm OE vendor, ndërkohë që OE të huaj nuk mund ta sjellin këtë dëshmi, përveç se mund ti sjellin Deklaratat Tatimore nga vendi i Themelimit të tyre. Prandaj, neni 68 i LPP-së për të eliminuar çdo kufizim dhe/ose diskriminim të mundshëm të OE-ve, përmban paragrafin 3, i cili përcakton: "3. Nëse për ndonjë arsye të vlefshme, operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktues, operatorit ekonomik i lejohet që të demonstrojë gjendjen e vetë ekonomike dhe financiare përmes dokumentit tjetër që autoriteti kontraktues, në ushtrimin e diskrecionit të tij të arsyeshëm, e konsideron të përshtatshëm". Megjithatë, për të eliminuar çdo mundësi të kufizimit të konkurrencës dhe/ose diskriminimit të OE-ve për pjesëmarrje në aktivitetet e prokurimit, AK-të këshillohen që kurdo që kërkojnë referencën e lartë cituar, për të njëjtën të përshkruajnë në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë si në vijim: "Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën tatimore të Kosovës ose nga vendi i themelimit të tyre".

h) AK, në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 09.01.2024, në lidhje me këtë pretendim ankimor është përgjigjur: "Pretendimi ankimore nr.3 i kompanisë ankuese qe ka te bej me Deklaratat Tatimore vjetore te mos dorëzuar ne ATK për vitin 2022 ashtu siç është kërkuar ne 3 vitet e fundit ne kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për kontrate dhe Dosjen e tenderit, AK e merr si te bazuar pasi konsideron se është bërë lëshim Teknik me rastin e vlerësimit".

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 3

Eksperti fillimisht sqaron se konstatimi i AK-së se nuk është plotësuar kërkesa për kapacitetin ekonomik dhe financiar për shkak se nuk është dorëzuar deklaratat tatimore vjetore e ATK për vitin 2022 është i paqëndrueshëm. Kjo për faktin se ashtu sikurse është sqaruar mësipër kërkesa plotësohet kur dorëzohen dëshmi që përmbushin qarkullimin minimal të përcaktuar nga AK, në këtë rast për secilin Lot. Andaj, me të drejtë AK e ka cilësuar si të bazuar këtë pretendim ankimor. Gjithashtu, në lidhje me anëtarin e grupit - "Groma Hold EOOD", AK gjatë rivlerësimit duhet të marrë për bazë përcaktimin e nenit 68, paragrafi 3, të LPP-së, ku theksohet se OE i lejohet që të demonstrojë gjendjen e vet ekonomike dhe financiare përmes dokumentit tjetër. Prandaj, në lidhje me këtë pretendim është vendosur përmes vendimit të AK-së të datës 09.01.2024, rrjedhimisht eksperti e rikonfirmon si të bazuar.

III. PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË ANKESËS 2024/0056, TË PARASHTRUAR NGA OE "SALLAHU" SH.P.K

Sqarim hyrës: Parashtruesi i ankesës – OE "Sallahu" Sh.p.k (më tej OE ankues) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 03.01.2024, përderisa AK me datë 09.01.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit ka dorëzuar ofertë për Lot 1, Lot 2, Lot 3 dhe Lot 4. OE ankues me datë 05.02.2024 ka ngarkuar shkresën përmes të cilës tërheq pretendimet ankimore lidhur me Lot 3. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të dhëna nga AK në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar si dhe tenderët e OE të rekomanduar për Lot 1, 2 dhe 4.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me pajisjet.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 1

a) AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar për OE ankues të publikuar me datë 29.12.2023 ka dhënë arsyetimin si vijon: " *OE ka dështuar te plotësoj kërkesat e përcaktuara ne Njoftimin e kontratës dhe DT i mungojnë: Ne Listën e Pajisjeve është kërkuar Pika 10.Grejder 12-16t,jane kërkuar 3 Grejderi. Ndërsa Operatori ka, ofruar 5 grejderë, 4 prej te cilëve e tejkalojnë kapacitetin e kërkuar: Grejder me kapacitet 16,2 t, grejder me kapacitet 18 t, grejder me kapacitet 17 t, grejder me kapacitet 20t. Pajisja nr.1.Greder marka O&K,tipi F156.6 A,2004 nr.107174, nga kërkimet ne internet verifikohet se ky grejder ka peshe prej 16,200 kg, ashtu siç është prezantuar nga vet operatori ekonomik nëpërmjet DUD-it. Pajisja nr. 2. Greder caterpillar champion 740, 1990 është sipas kërkesave te DT-se. Pajisja nr.3. Greider O&K, tipi 106 A, viti 1992, Ne DUD nuk prezantohet pasha e pajisjes. Mirëpo pas kërkimit ne internet vërtetohet se kjo pajisje është nen peshën 12t, me ç'rast nuk është ne përputhje me kërkesat e DT-se. Pajisja nr.4. Grejder Caterpillar, 120 m, viti 2018 me targa AKIM 67. Ne dokumentacionin e prezantuar për këtë pajisje mungon pesha e pajisjes. Mirëpo pas kërkimit ne internet vërtetohet se kjo pajisje është 16.900 kg, me c 'rast nuk është ne përputhje me kërkesat e DT-se. Pajisja nr.5. Grejder Caterpillar, tip 140, viti 2003. Ne DUD te prezantuar nga OE pesha e pajisjes është 20,000kg (20t), dhe si i tille nuk është ne përputhje*

me kërkesat e DT-se. 2. Lot- 3, dhe Lot-4, OE është I pa përgjegjshëm pasi nuk anin te plotësoj kërkesat e përcaktuar ne DT ".

b) Në lidhje me pajisjet, AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ka paraqitur Pajisjet dhe Mekanizimin e Obligueshëm për secilin Lot, ku për Lot 1 është paraqitur tabela me 22 pajisjet, ndër të tjera edhe pozicioni 10 - Grejder 12-16t, sasia e kërkuar (2 copë). Si dëshmi është kërkuar për të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamionë rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj).

c) OE ankues në tenderin e tij ka dorëzuar dokumentin me emërtimin "Listat e pajisjeve L1-L4", ku ndër të tjera janë paraqitur pesë Grejderë.
    1) Greder marka O&K, tip F 156.6A, viti i prodhimit 2004, nr. 107574,
    2) Greder Cate tip Champion 740, viti i prodhimit 1990,
    3) Greder marka O&K, tip 106A, viti i prodhimit 1992,
    4) Greder, marka Caterpillar 120m, viti i prodhimit 2018, targat AKMT67,
    5) Greder, marka Caterpillar, tip 14 C, viti i prodhimit 2003.

d) OE ankues ka dorëzuar dëshmitë si vijon:
    1) Deklaratën Unike Doganore të datës 10.04.2017 në të cilën tek përshkrimi shënohet: Makineri sheshuese dhe niveluese, Marka: O&K; tipi: F 156.6A; kW: 118; ngjyra e kuqe; viti i prodhimit: 2004, pesha 16,200.00 kg.
    2) Deklaratën Unike Doganore të datës 10.12.2008 në të cilën tek përshkrimi shënohet: Makineri për rregullimin e rrugësve (Grejder), Marka: Cate; Tipi: champion 740 nr.serik 01448, Viti i Prodhimit: 1990, Ngjyra: e portokalltë, pesha 16,000.00 kg.
    3) Deklaratë Unike Doganore, e lëshuar nga Dogana e Republikës së Shqipërisë e cila mbanë datën 20.02.2009. Informatat në këtë dokument janë të palexueshme.
    4) Certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor e lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përkatësisht Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Certifikata vërteton regjistrimin e pronësisë së subjektit Salillari për mjetin Caterpillar 120M2 me vit të prodhimit 2018 dhe ngjyrë të verdhë. Për të njëjtin mjet

është dorëzuar edhe certifikata e regjistrimit mirëpo të dhënat janë të palexueshme.

5) Është dorëzuar Deklarata Doganore për mjetin me përshkrimin: Grejder i përdorur me numër te shasisë 96 U1290, komplet me aksesor me peshën 20,000.00 kg.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 1

Eksperti sqaron se nga 5 pajisjet – Greder të paraqitur në listën e pajisjeve, sipas dëshmive të dorëzuara, pajisja me numër rendor 1 ka peshën 16200 kg apo 16.2T që është jashtë intervalit të paraqitu nga AK për peshën e pajisjes 12-16T. OE ankues në lidhje me këtë pozicion në ankesë pretendon se fakti që pajisja tejkalon për 200 kg peshën nuk ka ndikim në kryerjen e funksionit dhe cilësisë se tij dhe AK është dashur që konform nenit 59 të LPP-së paragrafi 4 të pranojë si devijim të vogël duke marr për bazë edhe dallimin në çmim me GOE të rekomanduar për Lot 1 e që është me shtrenjtë për 233,128.00 euro me e shtrenjte se oferta e OE ankues. Në lidhje me këtë pikë eksperti sqaron se, në raport me peshën totale është evidente dallimi minimal. Megjithatë eksperti nuk mund të konstatojë pranimin e devijimit meqë kjo është përgjegjësi e AK-së dhe në rast të rivlerësimit, AK mundet që të vlerësojë a janë të pranueshme devijimet konform nenit 59 të LPP-së me kushtin që devijimet të kuanitifkohen dhe OE-të të trajtohen barabartë për të gjithë sipas nenit 7 të LPP-së.

Në lidhje me pajisjen me numër rendor 3 (marka O&K, tip 106A) dhe 4 (Caterpillar 120M2) sipas dokumenteve të dorëzuar me ofertë nuk mund të vërtetohet pesha e pajisjeve. Në lidhje me pajisjen numër rendor 3 OE ankues në ankesë ka bashkangjitur si provë një imazh nga kërkimi në internet ku shihet pesha prej 12T, megjithatë, eksperti rekomandon që paneli shqyrtues të kërkojë nga AK që konform nenit 72 të LPP-së për këto pajisje të kërkojë sqarimet shtesë në mënyrë që të vlerësohet përmbushja e kërkesave. Andaj pretendimi ankimor është i pjesërisht i bazuar në këtë pikë.

Pretendimi ankimor 2

OE ankues pretendon se AK Autoriteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 40.3 te Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik duke shkelur afatet ligjore te vlerësimit te tenderit dhe nxjerrjes se njoftimit mbi vendimin e AK-së

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 2

a) Dorëzimin i tenderëve është bërë me datë 04.05.2023, ku në të njëjtën ditë është publikuar procesverbali i hapjes së ofertave.

b) Publikimi i njoftimit mbi vendimin e AK-së dhe letrave standarde për tenderuesit është bërë me datë 29.12.2023.

c) Në Rregulloren për Prokurimin Publik 001/2022, në nenin 40, paragrafi 3, përcaktohet: "Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve."

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 2

Eksperti sqaron se AK nuk ka respektuar afatet e përcaktuar me nenin 40, paragrafi 3, të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022, për ekzaminimin vlerësimin, krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrjen e njoftimit mbi vendimin e AK-së. Kështu, procesi nga hapja e ofertave deri në njoftimin mbi vendimin e AK-së ka zgjatë 238 ditë kalendarike. Andaj, eksperti vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor 3

OE ankues pretendon se AK Autoriteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 10 dhe 11 të Ligjit për Prokurimin publik duke mos i dhënë qasje në ofertën e GOE të rekomanduar për Lot 2.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 3

d) OE ankues me datë 03.01.2024 përmes platformës e-prokurimi ka dorëzuar kërkesën për qasje me përmbajtjen si vijon: "*Kërkojmë qasje dhe kopjen e te gjitha dokumenteve te ofruara ne Dosjen e Ofertimit për operatoret ekonomik te rekomanduar me kontrate për Lot 1 , 2 , 3 , 4 , dhe dokumentet e tjera te kërkuara-ofruara nga OE gjate fazës se vlerësimit, ne harmoni me nenin 10 te LPP-se përveç sekreteve afariste, Raportin e Vlerësimit, si dhe dokumentet e mëposhtme për OE te rekomanduar me kontrate: 1. Vërtetim nga Administrata Tatimore, 2. Vërtetim nga Gjykata Themelore, Departamenti për Çështje Ekonomike, 3.Vërtetim nga Gjykata Themelore origjinal ose kopje e noterizuar ku vërteton. Se drejtuesit, menaxheret gjate dhjete viteve te kaluara nuk janë shpallur fajtore. Citoj; "Ne mbështetje te nenit 10 te LPP-se · paragrafi 2,3,4 Autoriteti Kontraktues do te sigurojë qasje ne mënyrë te rregullt dhe pa pengesa për te gjitha palët qe · kane kërkuar me shkrim qasje duke siguruar kopje te çfarëdo materiali për te cilin pala e tille është e interesuar, përjashtuar informatat sekrete afariste te cilat janë vërtetuar nga një autoritet përkatës, sipas paragrafit 3 te këtij neni.*"

e) Në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar nga OE në AK dhe në këtë ankesë, OE thekson se: "*ne ora 12:00 te datës 03.01.2023 i është mundësuar qasje e pjesshme sepse ne lidhje me GOE te rekomanduar për Për Lot 2: OE Empreus Shpk, Jaha Company Shpk, Premium Ks, Tofior, NNT ABC, Metag Insaat Ticaret nuk i janë ofruar dokumentet bazike mbi te cilat është bere vleresimi dhe rekomandimi me kontrate, ku pa asnjë vendim për klasifikim te dokumenteve janë fshehur nga ne dokumentet mbi kapacitetin Teknik financiar dhe profesional dhe dokumente te tjera te cilat nuk janë kërkuar fare te jene si sekret afarist përfshirë edhe Formularin e Dorëzimit te Tenderëve.*"

f) Në tenderin e dorëzuar nga GOE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 janë dorëzuar nga anëtarët e grupit kërkesat për sekret afarist.

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 3</u>

Eksperti sqaron se në parim AK ka zbatuar kërkesat e nenit 11 duke mbajtë si sekrete informatat e kërkuara të klasifikohen si informata sekrete afariste nga GOE i rekomanduar për Lot 2. Megjithatë, fillimisht AK gjatë klasifikimit të informatave sipas kërkesës së anëtarëve të GOE të rekomanduar është dashur që të bëjë ndarjen në kuptimin që kontratat dhe referencat

e lëshuara nga një autoritet publik të mos i klasifikojë si informatat sekrete afariste, përderisa nuk përmbajnë elemente që kërkohet që kontratat të mos jenë publike. Kjo për faktin se në listën e kontratave disa prej tyre janë kontrata të lidhura ndërmjet anëtarëve të grupit të rekomanduar për kontratë me institucione publike. Gjithashtu, konform nenit 11, paragrafi 4 i LPP-së AK është dashur që ta përgatisë një version të pastruar të çdo dokumenti, që e ka klasifikuar që ka element të informatës si informatë sekrete, dhe të njëjtin ta vënë në dispozicion për OE ankues. Për me shumë, nëse dokumenti përmban vetëm informacione që autoriteti kontraktues i ka klasifikuar si informacione sekrete afariste AK është dashur të përgatis dhe përfshijë në dokumentacionin në të cilin OE ankues ka qasje, një përmbledhje të përmbajtjes së përgjithshme të dokumentit sekret. Andaj, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 4

OE ankues pretendon se AK Autoriteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë për Lot 1 GOE i cili nuk plotëson kërkesën 7 të dosjes së tenderit lidhur me licencën për prodhimin e bazës se asfaltit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 4

a) AK, në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka paraqitur kërkesën: "*7. OE duhet te jete i licencuar leje për aktivitete te veçanta për prodhimin e bazës se asfaltit, prodhimin e bazës se betonit dhe OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes zhavorr*". Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "*Dëshmia 7- Kopja e licencës lejes për aktivitete te veçanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.*".

b) GOE i rekomanduar në tenderin e dorëzuar ka paraqitur dokumentet: "Leje Për Aktivitetet e Veçanta", e lëshuar me datë 30.04.2018, nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhc Minerale (më tej KPMM) me numër 586/KPMM/2018. Leja është lëshuar për bazë të

asfaltit për biznesin "SB CONSTRACTION" Sh.p.k. në kohëzgjatje deri me datë 18.04.2023. Gjithashtu është paraqitur dokumenti - "Kërkesë për Leje për Aktivitetet e Veçanta" (formular i KPMM) e cila mbanë vulën e protokollit të KPMM me datë 05.04.2023 dhe numër të protokollit 1318. Bashkangjitur është dorëzuar edhe Fatura e lëshuar nga KPMM në lidhje me kërkesën për vazhdim të lejes. Në fund është bashkangjitur edhe dokumenti "Marrëveshje për Furnizim me Asfalt" në mes të OE "R- Rukolli" dhe "SB Construction" në të cilën shënohet: "Me këtë vërtetojmë marrëveshjen e Shitjes (furnizimit) se materialit te gjitha llojeve te asfaltit sipas recepturave, kërkesave te projektit dhe nevojës ndërmjet: R & Rukolli SH.P.K. si blerës (qiramarrës) ne njërën ane dhe SB Construction SH.P.K. si shitës/furnizues (qiradhënës) ne anën tjetër. Marrëveshja lidhet për kohëzgjatjen e projektit dhe palët pajtohen qe do te respektojnë çdo kërkesë te projektit ne fjale siç është kërkuar ne dosje te tenderit. Kjo marrëveshje garanton pa vështirësi furnizimin me materialin e cekur me larte si dhe makinerisë se nevojshme për shtrimin e asfaltit ne çdo kohe dhe ne tere territorin e Kosovës. Kjo marrëveshje furnizimi me asfalt është valide për tenderin me titull: Zgjerimi i rrugës nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc, Loti 1,2,3,4 Nr. i prokurimit: 205 23 1843 511. SB Construction SH.P.K. posedon Bazën e Asfaltit te licencuar, me kapacitet prodhimit prej 150 t/h mete gjitha pajisjet dhe stafin e specializuar për kryerjen e punëve te asfaltimeve." Marrëveshja është nënshkruar me datë 18.04.2023 dhe është vulosur nga palët. Së bashku me marrëveshjen është dorëzuar edhe dokumenti i noterizuar me numër të LRP Nr.5399/2023 - Vërtetim nënshkrimi në të cilën shënohet " *Sot, me date 24.04.2023 para meje, Zyfer Aliu, Noter me seli ne Lipjan ,Rruga" Lidhja e Prizrenit" p.n, vërteton se Nënshkrimi i mëposhtëm i vene ne dokumentin privat te quajtur "Marrëveshje për furnizim me asfaIt", e dt.18.04.2023 është vene nga:1.z.Ragip Behrami i lindur ne Skenderaj, me vendbanim te përhershëm ne Skenderaj, shtetas i Republikës se Kosovës, madhore me zotësi te plote veprimi (I autorizuar i "R&Rukolli " sh.p.k.) 2.Z.Drilon Etemi, nga i ati Etem, i lindur ne Presheve-R. Serbise, me vendqëndrim ne Prishtinë, shtetas i Republikës se Maqedonisë se Veriut, madhor, me zotësi te plate veprimi (I autorizuar i "SB Construction sh.p.k.) Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e dokumentit te përpiluar jashtë zyrës se tij , noteri vetëm vërteton nënshkrimin e palës te vene ne praninë e tij dhe ne zyrën e tij. Veprimi i noterizimit u krye ne Lipjan, me dt.24.04.2023 ne selinë e Noterit Zyfer Aliu ne adresën e lartshënuar "*

c) Në vendimin e AK-së të datës 09.01.2024, në lidhje me këtë pretendim ankimor, AK është përgjigjur: "*Lidhur me pretendimet ankimore se OE i rekomanduar për kontrate Lot 1 nuk ka plotësuar kërkesat lidhur me Dëshmia 7- Kopja e licencës lejes për aktivitete te veçanta te vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. OE ka prezantuar të gjitha deshmitë apo rnarreveshje për furnizim qe kane te bëjnë me posedimin e lejeve për aktivitete te veçanta, mirëpo ne mungese te funksionimit te bordit qe bene lëshimin e këtyre lejeve OE nuk kane mundur te bëjnë vazhdimin edhe pse kane bere kërkesa me kohe për vazhdimin e te njëjtave*."

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 4</u>

Eksperti sqaron se GOE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Lejen për Aktivitetet e Veçanta, për bazë të asfaltit, e lëshuar nga KPMM me afat deri me datë 18.04.2023, që i bie të ketë pasur vlefshmëri në kohën e publikimit për kontratë, ndërsa leja ka skaduar para afatit për dorëzimin e tenderëve. Gjithashtu, GOE i rekomanduar ka dorëzuar edhe kërkesën e bërë në KPMM për vazhdimin e lejes. Megjithatë, marrë për bazë faktin se afati i lejes ka skaduar dhe faktit që GOE ka dorëzuar si dëshmi formularin për vazhdimin e lejes, si dokument zyrtar i KPMM-së, AK për të konstatuar se plotësohet apo jo kërkesa e dosjes së tenderit, përkatësisht GOE ka kapacitetin për të përmbushur kontratën është dashur të kërkojë informacione shtesë nga GOE apo KPMM se a ka subjekti licencë të vlefshme për veprimtarinë përkatëse. Andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar

<u>Pretendimi ankimor 5</u>

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesën për menaxherin e projektit.

<u>Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 5</u>

a) AK, në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka paraqitur kërkesën: " *1.Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore me se paku 5 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) në lëmin e*

kërkuar (ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve). Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "*Dëshmia 1.CV- per projektet e realizuara pas diplomimit-, diploma e noterizuar nga origjinali (noterizimi te mos jete me i vjetër se 6 muaj nga data e njoftimit për kontrate) Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt (noterizimi te mos jete me i vjetër se 6 muaj nga data e njoftimit për kontrate), si dhe Referenca për punët e mëparshme ne lëmin e kërkuar te lëshuar nga punëdhënësi*.".

b) GOE i rekomanduar në tenderin e dorëzuar ka paraqitur fajllin me emërtimin "6.1 Menaxheri i projektit" ku paraqiten: 1.CV e z.Ragip Behramaj, e nënshkruar. Në fund shënohet " Pas njoftimit me përmbajtjen e Kontratës, kjo Kontrate nga palët kontraktuese u nënshkrua me datën: 03.01.2023, ne Skenderaj, ne dy (2) kopje autentike, nga te cilat, secilës pale i mbetet nga një kopje." Më tej është prezantuar Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, në të cilën shënohet se z.Ragip Behramaj merr kualifikimin Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë. Diploma është lëshuar me datë 10.11.2004. Kopja e diplomës është e noterizuar.

c) Dokumenti i kontratës së punës me afat të pacaktuar i lidhur në mes të "R&Rukolli" Sh.p.k, me seli ne Skenderaj, dhe R.B, me kualifikimi Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv, ku specifikohet se i punësuari caktohet ne vendin e punës Menaxher projektesh te ndryshme ndërtimi. Më tej përcaktohet se i punësuari themelon marrëdhënie pune, në kohë të caktuar, duke filluar nga: 01.01.2023 deri me: 31.12.2023. Poashtu, është bashkangjitur dokumenti i noterizuar me numër të LRP Nr.4885/2023 - Vërtetim nënshkrimi, në të cilën shënohet: "*Sot, me datë 18.04.2023 para meje, Zyfer Aliu, Noter me seli ne Lipjan, Rruga "Lidhja e Prizrenit" p.n, vërteton se nënshkrimi i mëposhtëm i vënë në dokumentin privat të quajtur "Kontratë pune për kohë të caktuar", Ref H017/2013 e dt 01.01.2023 është vënë nga: 1.Z.Agim Rukolli, i lindur ne F.Rezallë-Skenderaj, me vendbanim te përhershëm ne Prishtinë, shtetas i Republikës se Kosovës, identiteti i te cilit konstatohet nga letërnjoftimi me nr personal, madhor me zotësi te plotë veprimi (Përfaqësuesi i "R&Rukolli " Sh.p.k). 2.Z.Ragip Behrami i lindur ne Skenderaj , me 03.03.1980. Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e dokumentit te përpiluar jashtë zyrës se tij, noteri vetëm vërteton nënshkrimin e palës të vënë në praninë e tij në zyre. Veprimi i*

noterizimit u krye në Lipjan, me dt.18.04.2023 në selinë e Noterit Zyfer Aliu në adresën e lartshënuar.".

d) OE të njëjtin pretendim e ka paraqitur edhe në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar në AK me datë 03.01.2024.

e) Në vendimin e AK-së të datës 09.01.2024, në lidhje me këtë pretendim ankimor, AK është përgjigjur: "*Lidhur me pretendimet ankimore se OE i rekomanduar për kontrate Lot 1 nuk ka plotësuar kërkesat lidhur stafin nuk qëndron ky pretendim sepse OE ka plotësuar kërkesat sipas DT. Prove shtese: Vendimi i OSHP-se Nr. 2023/0397 te dt, 04.12.2023 ne te cilin vendim kane qene te njëjtat pretendime ankimore lidhur me pajisjet, ne një aktivitet te MMPHI-se ne vitin e njëjtë 2023, ku OSHP pas trajtimit te pretendimeve ankimore lenë ne fuqi vendimin e AK-MMPHI-se.*"

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 5

Eksperti fillimisht sqaron se dorëzimi i tenderëve është bërë me datë 04.05.2023 dhe GOE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar kontratë të lidhur në mes të anëtarit të grupit OE "R&Rukolli" dhe z.Ragip Behrami. AK nuk ka respektuar afatet e përcaktuar me nenin 40 paragrafi 3, të Rregullores për Prokurimin Publik, për ekzaminimin vlerësimin, krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrjen e njoftimit mbi vendimin e AK-së. Kështu, procesi nga hapja e ofertave deri në njoftimin mbi vendimin e AK-së ka zgjatë 238 ditë kalendarike. Më tej, në lidhje me noterizimin e kontratës, eksperti sqaron se GOE ka paraqitur aktin noterial për vërtetimin e nënshkrimit të kontratës nga palët, në të cilin akt, noteri i referohet kontratës së dorëzuar nga GOE. Eksperti sqaron se në lidhje me procedurat noteriale nuk është kompetent të ekzaminojë aktet e lëshuara nga një noter dhe për çfarëdo dyshimi OE ankues mund të referojë çështjen në institucionin relevant. Andaj, duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, eksperti vlerëson se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 6

OE ankues pretendon se AK Autoriteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë për Lot 1 GOE i cili nuk plotëson kërkesën 4 te kapacitetit teknik

dhe profesional të dosjes së tenderit

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 6

a) AK, në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka paraqitur kërkesën: "*4. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ose gjeodet (shkolla e lartë), ose Bahcelor i diplomuar i gjodezisë me pesë vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit)) në lëmin e kërkuar (ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve).*".Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "*4 CV-për projektet e realizuara pas diplomimit-, diploma e noterizuar nga origjinali (noterizimi te mos jete me i vjetër se 6 muaj nga data e njoftimit për kontrate) Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt (noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit për kontrate), si dhe Referenca për punët e mëparshme ne lëmin e kërkuar te lëshuar nga punëdhënësi*."

b) GOE te rekomanduar ka dorëzuar diplomën e Universitetit të Prishtinës, Fakultetit i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës ku shënohet se Drilon Etemi, studimet i mbaroi me 6 shtator 2016 dhe mori titullin Bachelor i Gjeodezisë.

c) Është dorëzuar CV në të cilën në lidhje me përvojën e punës paraqitet angazhimi nga data 2009 deri me 2017, në pozicionin e punës Menaxher ne kompaninë Saba Bellça Sh.p.K, SB Construction SHPK.

d) Është dorëzuar KONTRATE PUNE PER KOHE TE PACAKTUAR, e lidhur në mes të : 'SABA BELCA DEGA NE KOSOVE'. me Nr. Biznesi 810728264, (Punëdhënësi), me: Drilon Etemi ne cilësinë e pozitës GJEODET - Menaxher me kualifikimi: Bachelor i Gjeodezisë. Në nenin 4 të kontratës thuhet se i punësuari themelon marrëdhënie pune ne kohe te pacaktuar, duke filluar nga: 01.06.2017.

e) Gjithashtu, është dorëzuar referenca e lëshuar nga Saba Bellca për Drilon Etemi, ku ndër të tjera shënohet "Work experience: (from 2012- ...)"

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 6

Eksperti sqaron se në lidhje me përvojën e gjeodetit, GOE ka dorëzuar CV në të cilën paraqitet vetëm përvoja e punës nga viti 2009-2017 e cila në ndërlidhje me kohën e diplomimit nuk përmbushë kërkesën e AK-së për pesë vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Pavarësisht këtij fakti, GOE i rekomanduar ka dorëzuar edhe kontratën e nënshkruar me datë 01.06.2017 me afat të caktuar si dhe referencën e paqartë që shënohet përvoja "2012-...". Në një situtë të tillë është e paqartë se a përmbushet kërkesa në lidhje me përvojën. Andaj, Eksperti rekomandon Panelin Shqyrtues që në lidhje me këtë pretendim ankimor, AK mund të kërkojë informacione shtesë në pajtim me dispozitat e LPP-së. Rrjedhimisht, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 7

OE ankues pretendon se AK Autoriteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë për Lot 1 GOE i cili nuk plotëson kërkesën 5 te kapacitetit teknik dhe profesional të dosjes së tenderit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 7

a) AK, në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka paraqitur kërkesën: " *5. Një (1) Inxhinier i diplomuar i komunikacionit me dy vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ose Bachelor i diplomuar i komunikacionit me tri vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) në lëmin e kërkuar (ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve).*"
   Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "*Dëshmia 5. CV- per projektet e realizuara pas diplomimit-, diploma e noterizuar nga origjinali (noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate) Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt (noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate), si dhe Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar nga punedhenesi*."

b) GOE te rekomanduar ka dorëzuar diplomën e znj. Xheneta Kolgeci, ku është paraqitur përvoja e punës si vijon: Pozita aktuale: inxhiniere e komunikacionit rrugore ne kompaninë NSH LIRJU – nga viti 2014 dhe vijon akoma:

i. Pervojë ne: Rrugë, Projekte të Sinjalizimit, Ekspertiza të aksidenteve.
ii. Pervoje te rugëve ne praktikat inxhinierike si: Planiflkim, Projektim,
iii. Mbikqyrje, Inspektim te rrugëv ne teren, Kontoll i kualitetit dhe rrugëve.
iv. Pervoje te rugëve ne pregaditjeu e specifikimit teknik per rugëve, paramase dhe parallogari, pergaditjen e tenderit i dokumenteve te rrugëve m: kontrolli admiuistrativ, teknik dhc financiar te projckteve dhe kontrollin e rrugëve.
v. Pervoje e rugëve ne projektimin e sinjalizimit, dhe organizimit te trafilmt ne qytet dhe rrugëv qytetit, si dhe pervoje te gjere te rrugëve mit te rugëv projekteve.
vi. Pervoje e dëshmuar ne ekzekutimin e punimeve te sinjalistikes horizontale dhe vertikale rrugore.

Gjithashtu në CV është paraqitur edhe lista me përvojat specifike si vijin:

vii. Angazhime në rolin e asistente së ekspertit të komunikacionit në Gjykatën Komunale në Suharekë dhe Prokurorinë Themelore të Prizrenit, ku është paraqitur lista e urdhëresave rrugëve m për ekspertiza.

Më tej janë paraqitur edhe angazhimet si vijon:

viii. Hartimi i Projektit per qasjen ne rrugëv Prishtinë Ferizaj
ix. Hartimi i Projektit per qasjen ne rrugëv Prishtinë Pej
x. Hartimi i Projektit per qasjen ne rrugëv Pejë Prishtinë
xi. Hartim i i Projcktit per qasjen ne rrugëv Ferizaj Prishtine
xii. Hartimi i Projektit per qasjcn ne rrugen Prishtin Shkup
xiii. Hartimi i Projcktit per qasjen në rrugën Prishtinë Vushtrri.
xiv. Projektim i rrethrrotullimit ne qytetin e Suharekes
xv. Punimi i projektit zbatues per rrugëv MamushTerrnje
xvi. Furnizimi dbe vendosja e shenjave te komunikacionit ne rrugëve e Drenasit
xvii. Shenjczimi horizontal clhe vertikal në Suhareke
xviii. Furnizimi dhe vendosja e Bus Shallterave per rrugëve
xix. Kontrate per uenkontraktimin e shërbimeve perofesionale me kompania Kosbau GmbH
xx. Furnizimi dhe vendosja e pahive elastike
xxi. Furnizimi dhe vendosja e sinjalizimit horizontal

xxii. Furnizimi dhe vendosja e sinjalizimit vertikal.
xxiii. Furnizimi me shenja te Komunikacionit
xxiv. Shenjezimi vertikal clhe horizontal i rrugëve
xxv. Vendosja e pengesave në rrugët lokale në Junik
xxvi. Mirembajtja e rrugëve gjatë sezonit veror 2017 Malisheve
xxvii. Sinjializimi vertikal dhe horizontal në komunën e Rahovecit
xxviii. Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal
xxix. Furnizimi me Shenja te Komunikacionit Aneks Kontrat
xxx. Furnizimi dhe punimi l sinjalizimit vertikal dhe portaleve ne oborrin e QKUK-s
xxxi. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal sistemi I unifikuar i adresave -Faza Finale
xxxii. Furnizimi dhe punimi i sinjalizimit vertikal dlhe portaleve nc oborrin e QKUK-s dhe furnizimi dbe montimi me sbenja orientuese lot l.
xxxiii. Furnizimi me shenja per shënjizimin Horizontal dhe Vertikal në Komunën e Malishevës
xxxiv. Sinjalizimi Horizintal dhe Vertikal i rrugëve në komunën e Rahovecit
xxxv. Kontrate per nenkontraktimtn e rrugëve mi profesionale -sinjalizimi
xxxvi. Kontrate per nenkontraktimin e rrugëve mi profesionale – Sinjalizimi Vcrtikal dbe Horizontal
xxxvii. Sinjalizimi hor izontal dhe vertical i rrugëve ne qytetin c Mitrovices
xxxviii. Sinjalizimi i rrugëve ne Qytetin e Obiliqit etj ...
xxxix. Projekti per qasje ne rrugëv magjistrale Studenqan
xl. Projekti per qasje ne rrugen magjistralc Vushtrri
xli. Projekti per qasje ne rrugëv magjistrale Lapllaselle
xlii. Sherbimet e rrugëve197mit te 197ugëve dhe sinjalistikës Rahovec

c) Gjithashtu është dorëzuar referenca e lëshuar nga N.Sh "Liriu" me tekstin si vijon: *Ne baze te kërkesës nga Znj.Xheneta Kolgeci për rekomandim lidhur me punët e kryera ne kompaninë NSH "Liriu" për periudhën 01.01.2014 – 31/12/2022 ne pozitën e inxhinierit te komunikacionit rekomandojmë mesa vijon: Znj.Xheneta Kolgeci gjate periudhës ne te cilën ka zhvilluar aktivitetin ne kompaninë tone ka bere punët profesionale ne pozitën e inxhinierit te komunikacionit. Ka treguar*

një seriozitet le plote lidhur me detyrat qe dalin për arritjen c rezultateve te mira ne aspektin e përfitimeve te kompanisë dhe rritjen e produktivitet në pune.

Vlen te theksohet aftësia e saje e punës në grup duke ruajtur raporte shume te mira dhe profesionale me gjithë stafin dhe klientelen e kompanisë!!. Ka dëshmuar aftësi ti! Mëdha edhe ne realizimin e punëve ne presion duke ruajtur saktësinë dhe profesionalizmin. Me bindje te plote se Znj.Xheneta Kolgeci do te jete punëtore, detyrat dhe përgjegjësitë qe dalin prej saje do ti kryej me përgjegjësi të plote morale dhe profesionale. Ne vijim do te bashkëngjisim një pjesë të projekteve ne te cilat ZNJ.Xheneta ka qene e kyçur si menaxhere e terrenit ne këto kantata:

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 7

Eksperti fillimisht sqaron se OE ankues pretendon se përvoja e znj.Xheneta Thaqi nuk korrespondon me kërkesën e dosjes së tenderit që në këtë rast është ndërtimi, rehabilitimi, apo rikonstruktimi i rrugëve. Duke marrë parasysh informatat në lidhje me përvojën në sinjalistikë rrugore, eksperti sqaron se sinjalistika është një element i rëndësishëm në ndërtimin, rehabilitimin, apo rikonstruktimit e rrugëve, sepse ka për qëllim të sigurojë informacion, udhëzim, paralajmërim dhe rregullim të trafikut dhe të përdoruesve të rrugës. Sinjalistika mund të përfshijë sinjale horizontale (si shenja në sipërfaqen e rrugës), sinjale vertikale (si tabela, semaforë, panele), sinjale luminore (si drita, reflektorë, kandela), sinjale akustike (si sirena, alarme, zile) dhe sinjale të tjera (si barriera, konuse, pllaka), rrjedhimisht janë elemente përbërëse e një projekti apo aktiviteti të rrugëve. Për me tepër ekzistojnë edhe informatat në lidhje me përvojën në hartim të projekteve, mbikëqyrje, inspektim të rrugëve. Duke qenë kështu eksperti sqaron se në analogji me këtë rast, KRPP në lidhje me kontrata të ngjashme ka dhënë opsionin se një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Andaj, eksperti rekomandon panelit shqyrtues që në rivlerësimin e këtij aktivitetit të prokurimit AK të precizojë konstatimin profesional se përvoja e të njëjtën hyn apo jo në domenin e kërkesës. Poashtu, AK konform nenit 72 mund të kërkojë informacion shtesë për përvojën e së njëjtën në mënyrë që të konstatojë plotësimin apo jo të kërkesës. Andaj, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 8

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë për Lot 1 ka dështuar të dëshmojë se përmbushë kërkesën për pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës DT, përkatësisht kërkesën 10 te Listës se pajisjeve Greder 12-16t - 3 cope.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 8

a) Në lidhje me pajisjet, AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ka paraqitur Pajisjet dhe Mekanizimin e Obligueshëm për secilin Lot, ku për Lot 1 është paraqitur tabela me 22 pajisjet, ndër të tjera edhe pozicioni 10 - Grejder 12-16t, sasia e kërkuar (2 copë). Si dëshmi është kërkuar për të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamionë rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj).

b) GOE i rekomanduar për Lot 1 ka dorëzuar dokumentin "8.00 Lista e pajisjeve" ku për pozicionin 10 janë paraqitur të dhënat për 6 grejderë si vijon:
   i. 1999; e mire; O&K F156; pesha 15.St; pronar Rukolli; Fature, Foto.
   ii. 1994; e mire; O&K F156; pesha 15.St; pronar Rukolli; Fature, DUD, Foto.
   iii. 2004; e mire; Volvo G 726 B; pesha 16t; pronar Rukolli; DUD, Foto.
   iv. 2008; e mire; CAT 140M; pesha 15.lt; Elmazaj Konstruksion; DUD; fature; Foto. kontrate.
   v. 10.5.2008; e mire; CAT 120M; pesha 14.lt; Elmazaj Konstruksion; DUD; fature; Foto. kontrate.
   vi. 1982; e mire; O&K F 105; pesha 9.2t; pronar Rukolli; DUD, Foto.
   vii. Në fund të listës shënohet: Kapacitetin e pajisjeve mund te kontrolloni ne ueb: https://www.lectura-specs.com/en/model

c) Gjithashtu, është dorëzuar dokumenti "8.07 Grejder-kerkesa10"
   i. Përshkrimi: Greder (Rrafshues) TIPI: O&K F156, Kapaciteti: 15.8 T, viti i prodhimit:

1999, Ngjyra: e Kuqe. Është dorëzuar fatura e shitblerjes nr. 45/2020 e lëshuar nga "Vëllëzrit Ramadani" e cila mbanë datën: 04.02.2021 me përshkrimin: Greder i perdorur Marka: O&K, Tipi: F156, Nr.serisë 107359, Viti i prodhimit: 1999, "grederi asht me defect trapi i parë", nr i DUD-it 9855/2020.

ii. Përshkrimi: Greder (Rrafshues) TIPI: O&K F156, Kapaciteti: 15.8 T, viti i prodhimit: 1994, Ngjyra: e Kuqe. Është dorëzuar fatura e shitblerjes nr. 45/2020 e lëshuar nga NP"EURO BAG" e cila mbanë datën: 23.11.2020 me përshkrimin: Greder i perdorur Marka: O&K, Tipi: F156, Ngjyra e kuqe, Viti i prodhimit: 1994, Shenja&nr: 106559.

iii. Poashtu është dorëzuar Dokumenti Unik Doganor me numër të referencës doganore 28550, datë 23.11.2020 ku paraqitën të dhënat e pajisjes: GREDER O&K tipi F156, Viti i prodhirnt-1994, Nr serik 106569 dhe peshë 15.800.00 kg (neto dhe bruto).

iv. Përshkrimi: Greder (Rrafshues) TIPI: Volvo G 726 B, Kapaciteti: 16T, viti i Prodhimit: 2004, Ngjyra: e Verdhë. Poashtu është dorëzuar Dokumenti Unik Doganor ku paraqitën të dhënat e pajisjes: Sheshuesit dhe niveluesit e perdorur Marka Volvo G 726 B, numri i series 036495 Viti i prodhimit-2004, Nr serik 106569 dhe peshë 20.000.00 kg (neto dhe bruto).

v. Përshkrimi: Greder (Rrafshues) TIPI: O&K F 105, Kapaciteti: 16T, Viti i Prodhimit: 1982, Ngjyra: e Gjelbër. Poashtu është dorëzuar Dokumenti Unik Doganor ku paraqitën të dhënat e pajisjes: Greder i perdorur, Marka Marka: O&K, Tipi: F 105, Ngjyra e kaltert, Viti i prodhimit: 1982, nr serik 3210807 dhe peshë 10.000.00 kg.

vi. Ofertë nr.310 "Teknoxgroup" ku përshkruhet modeli Cat 140 M me përshkrimin: Pesha e makines bazë: 16,581 kg. Pesha e makinës maximale me te gjitha opsionet 23,583 kg.

vii. Ofertë nr.323 "Teknoxgroup" ku përshkruhet modeli Cat 120 M me përshkrimin: Pesha standard e makines pa aksesor 17,534 kg dhe Pesha e makines me gjith aksesor 23,100 kg.

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 8</u>

Eksperti sqaron se nga 6 pajisjet – Greder të paraqitur në listën e pajisjeve nga GOE i rekomanduar për kontratë për Lot 1, sipas dëshmive të dorëzuara për pajisjen me numër

rendor 1 (O&K tipi F156 viti 1999) nuk ka paraqitur të dhëna për peshën si dhe nuk ka dorëzuar dëshminë – Dokumentin Unik Doganore. Për pajisjen me numër rendor 2 (O&K tipi F156 viti 1994) ka peshën në intervalin 12-16 T. Pajisja me numër rendor 3 (Volvo G 726 B) ka peshën 20.000.00 kg. Pajisja me numër rendor 4 (O&K, Tipi: F 105) ka peshën 10.000.00 kg, dhe pajisja me numër rendor 5 (Cat 140 M) ka peshën 23,583 kg. Si përfundim, eksperti sqaron AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së se në raport me vlerësimin për pajisjet. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë.

Pretendimi ankimor 9

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë ka dështuar të përmbushë kërkesën 8 të kapacitetit teknik dhe profesional të njoftimit për kontratë dhe dosje te tenderit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 9

a) AK, në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka paraqitur kërkesën: "8.Plani Menaxhimit te trafikut sa me i detajuar". Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "*Dëshmia 8.Planit të menaxhimit të trafikut i hartuar dhe nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit dhe i vulosur nga kompania Duke pasur parasysh frekuentimin e kësaj rruge (ku i ka përafërsisht 18,000 automjete për 24h, mesatarja vjetore), duhet të pregaditet sa më i detajuar (i përcjellur me skica dhe shenja përkatëse të trafikut rrugorë) duke e studiuar mirë edhe duke pasur parasysh gjendjen në teren të rrugës dhe strukturave (në mënyr që të mos ketë bllokim të komunikacionit)*."

b) GOE i rekomanduar për Lot 1 ka dorëzuar dokumentin "Plani i Menaxhimit të Trafikut në të cilin përshkruhet në mënyrë të detajuar me përshkrim, skica dhe shenja të trafikut. Plani është i nënshkruar nga Inxhinieria e komunikacionit: Xheneta Kolgeci mirëpo nuk është i vulosur.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 9

Sipas sqarimit të mësipërm, GOE i rekomanduar për Lot 1 kanë dorëzuar dokumentin e Planit të Menaxhimit te trafikut. Është evidente që dokumenti është i nënshkruar nga inxhinieri por nuk është vulosur nga OE. Megjithëse nuk është vulosur fakti që GOE e ka ngarkuar në platformë këtë dokument në mesin e dokumenteve tjera e bën përgjegjës për këtë dokument, rrjedhimisht mospasja e vulës nuk mund të konsiderohet mosplotësim i kërkesës. Andaj, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 10

OE ankues pretendon se AK nuk ka zbatuar ne mënyrë të drejtë kriterin për dhënie të kontratës ku ka rekomanduar operatorë te cilët sipas dëshmive, konstatohet se kane fare pak poentim sipas kritereve e kërkuara ne Dosjen e Tenderit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 10

a) Në njoftimin mbi vendimin e AK-së të publikuar me datë 29.12.2023 janë paraqitur OE-të e rekomanduar për dhënie të kontratë, ku janë rekomanduar për kontratë për Lot 1 - Grup i OE-ve "R & Rukolli"; "SABA BELCA" Dega në Kosovë; "ELMAZAJ KONSTRUKSION"; "Tekno - Konstrukt" SH.P.K. Lot 2 - Grup i OE-ve "EMPREUS" SH.P.K.; "JAHA COMPANY" sh.p.k.; "Premium - KS" SH.P.K.; "Toifor" Sh.p.k.; NNT "ABC" SH.P.K.; "METAG INSAAT TICARET" A.S., Lot 3 - Grup i OE-ve "Lika Trade" Sh.p.k.; "TOFI" doo; "Lika Company" SH.P.K. Lot 4 - Grup i OE "FAMIS CO-HC" SH.A; "KIT-AK", "Gradnje", d.o.o.; "KAG - Asphalt Company" SH.P.K.

b) Në raportin për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve të publikuar me datë 29.12.2023 paraqiten OE e rekomanduar për lote dhe poenat përkatës.

c) Në Rregulloren për Prokurimin Publik 001/2022, në nenin 27, paragrafi 9 thuhet: "Tenderët duhet të vlerësohen objektivisht dhe në mënyrë transparente krahas kritereve të peshuara të publikuara. Objektiviteti dhe transparenca arrihet në mënyrën më të mirë me

përdorimin e sistemit të vlerësimit me pikë ose shënimeve të pikëve të vlerësuara bazuar në kriteret e peshuara, që tregojnë një vlerësim krahasues të tenderëve nën secilin kriter."

d) Eksperti me datë 07.02.2024 ka kërkuar nga AK informacione në lidhje me poentimin e OE-ve sipas kitereve të përcaktuar në dosje të tenderit. AK me datë 08.02.2024 ka dërguar përmes emailit tabelën me vlerësimin me pikë për kriteret përktëse sipas komisioni të vlerësimit, për secilin lot, për OE-të që AK ka vlerësuar se janë të përgjegjshëm.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 10

Ashtu sikurse është sqaruar mesipër AK ka përpiluar tabelën me pikët për OE që ka vlerësuar se janë të përgjegjshëm megjithatë nuk ka paraqitur në raportin e vlerësimit apo vendimin e AK-së informatat për pikët e vlerësuara sipas kritereve që tregojnë vlerësim për secilin kriter bazuar në dëshmitë dokumentare të dorëzuara nga tenderuesit duke vepruar në kundërshtim paragrafin 9 të nenit 27 të RrPP. Andaj, duke marrë për bazë faktin e mungesë së transparencës për pikët e vlerësuara krahas kritereve, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 11

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke rekomanduar për kontratë për Lot 2, GOE i cili nuk ka dorëzuar marrëveshjen për themelimin e grupit në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 11

a) AK, në dosjen e tenderit, tek seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit, në nenin 11.1 Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik, kërkohet: "*a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës, b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të*

prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d.Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT."

b) GOE të rekomanduar për kontratë për Lot 2 ka dorëzuar deklaratat për themelimin e grupit në të cilat shënohet, ndër të tjera:

"8. Që të gjithë anëtarët e grupit të jenë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe, në rast se grupit i jepet kontrata, përmbushja e kontratës.

9. Të gjithë anëtarët do të jenë ligjërisht përgjegjës, bashkërisht dhe veçmas, për ekzekutimin e kontratës;

10. Që të gjitha palët të konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ato nuk po marrin pjesë veçmas dhe/ose në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtën procedurë prokurimi

11. Anëtari Udhëheqës do të autorizohet të detyrojë dhe të marrë udhëzime për dhe në emër të secilit dhe të gjithë partnerëve;

12. Ekzekutimi i Kontratës do të jetë përgjegjësi e Anëtarit Drejtues;

13. Anëtarët në konsorciumin janë të detyruar të qëndrojnë në konsorcium për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës;"

<u>Mendimi i ekspertit në lidhje me pretendimin ankimor 11</u>

Eksperti sqaron se GOE kanë dorëzuar dëshmitë sipas kërkesës së nenit 11.1 të dosjes së tenderit. Duke marrë parasysh që OE ankues në pretendimin ankimor e merr si analogji eliminimin e GOE "Groma Hold EOOD & RSM Company sh.p.k", eksperti sqaron se janë dy situata të ndryshme për faktin se në rastin e GOE "Groma Hold EOOD & RSM Company sh.p.k", në të dy deklaratat e anëtarëve të grupit mungon pjesa e fundit e tekstit të kërkesës "*në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës*", si dhe në kontratën e noterizuar për krijimin e grupit, të nënshkruar nga palët thuhet se kontrata do të ekzekutohet nëpërmjet partnerit "RSM Company Shpk" dhe se "Groma Hold EOOD", në cilësinë si partner në grup, të kryejë vetëm dhe ekskluzivisht shërbime konsulence për ekzekutimin e kontratës me klientin dhe nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi në lidhje me ekzekutimin e kontratës, kështu

duke bërë përjashtim nga përgjegjësia. Andaj pretendimi ankimor është i pabazuar në këtë pikë.

Pretendimi ankimor 12

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke rekomanduar për kontratë për Lot 4 OE i cili ka dorëzuar Planin Dinamik të palexueshëm.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 12

a) AK në dosjen e tenderit, tek Aneksi-1 Specifikimet teknike të detyrueshme, në pjesën 19. Kriteret e Propozuara për Dhënien e Kontratës, tek tabela e kritereve ka paraqitur kriterin numër rendor 5 Plani dinamik, me përshkrimin e kriterit "*Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë i detajuar.*" Pesha në poena është 0,10 dhe metoda e Vlerësimit është (pdo/Pd)x10, ku me poshtë është përshkruar "Pd - planin dinamik më i mirë i detajuar dhe më i shkurtë i ofertuesit" ; "pdo - planin dinamik i ofertuesit" dhe është dhënë përshkrimi: "*Plani Dinamik - duhet të prezantohet sa më i detajuar i mundshëm (duke i përfshirë të gjitha aktivitetet/pozicionet që janë të përfshira nëpër paramasa) nga ana e ofertuesit/Kontraktuesit*"

b) Më tej në aneksin në Aneksin 6. Kriteret për Dhënien E Kontratës, për Lot 1 ka paraqitur tabelën me kriteret ku me numër rendor 4 është vendosur nënkriteri "4.Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë i detajuar", me koeficient "0.10".

c) GOE të rekomanduar për kontratë për Lot 2 ka dorëzuar dokumentin "18 planu dinamic 1-3". Nga faqja 15 deri në faqen 22 janë paraqitur në mënyrë të detajuar pozicionet/aktivitetet të shtrira në 92 javë.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 12

Ashtu sikurse është sqaruar me sipër, GOE i rekomanduar për Lot 2 ka dorëzuar planin dinamik të detajuar me të gjitha pozicionet/aktivitetet sipas listës së çmimeve për lot 2. Është

evidente se në pozicioni 1.8.17 nuk ka të përcaktuar periudhën kohore brenda periudhës së përgjithshme prej 92 javësh të paraqitura në plan. Pavarësisht nga kjo, plani ofron një pasqyrë të qartë të periudhës së realizimit të kontratës si indikator matës i nënkritetit të planit dinamik me qëllim të vlerësimit të shkallës së peshimit krahas këtij nënkriteri. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 13

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke rekomanduar për kontratë për Lot 4, GOE i cili nuk ka dorëzuar marrëveshjen për themelimin e grupit në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 13

a) AK, në dosjen e tenderit, tek seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit, në nenin 11.1 Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik, kërkohet: "*a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës, b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d.Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.*"

b) GOE të rekomanduar për kontratë për Lot 4 ka dorëzuar deklaratat për themelimin e grupit në të cilat shënohet:

   i. "*Deklaratë, "Famis Co HC"sh.a. - Suhareke, Perfaqesuar nga Fadil Bytyçi – Drejtor, dhe KIT-*

AK Gradnje d.o.o. - Slovenia, Perfaqesuar nga Andrej Kitak – Drejtor, Dhe "KAG Asphalt Company sh.p.k., Perfaqesuar nga Bashkim Maliqi – Drejtor Me kete ne deklarojme se kompanit me em rate cekur me larte dote jene partner dhe do te realizojne punimet se bashku ne tenderin me emer: TITULLI: "Zgjerimi i Rruges Nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc, Loti 1,2,3,4", Numri Prokurimit: 205-23-1843-5-1-1.

ii. *Perfaqesuesit e dy kompanive deklarojn se nuk dote marrin pjese ne menyre individuale apo ne ndonje grup tjeter qe marrin pjese ne kete procedur te prokurimit."* Dokumenti është nënshkruar nga tre përfaqësuesit e sipërpërmendur dhe mbanë vulat e tri kompanive.

iii. *"Deklaratë, "Famis Co HC"sh.a. - Suhareke, Perfaqesuar nga Fadil Bytyçi - Drejtor, dhe KIT-AK Gradnje d.o.o. - Slovenia, Perfaqesuar nga Andrej Kitak – Drejtor, Dhe "KAG Asphalt Company sh.p.k., Perfaqesuar nga Bashkim Maliqi – Drejtor Me kete ne deklarojme se kompanit me em rate cekur me larte dote jene partner dhe dote realizojne punimet se bashku ne tenderin me emer: TITULLI: "Zgjerimi i Rruges Nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc, Loti 1,2,3,4", Numri Prokurimit: 205-23-1843-5-1-1.*

iv. *Perfaqesuesit e dy kompanive deklarojn se jane bashkerisht dhe individualisht pergjegjes per permbajtjen e grupit te tenderit dhe ne rast se grupit i jepet kontrata per ekzekutimin e kontrates"* Dokumenti është nënshkruar nga tre përfaqësuesit e sipërpërmendur dhe mbanë vulat e tri kompanive.

v. *"Deklaratë (Per Autorizimin e Partnerit Kryesor), Per realizimin e kesaj oferte ne tenderin me emer : "Zgjerimi i Rruges Nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc,Loti 1,2,3,4", Numri Prokurimit : 205-23-1843-5-1-1, Kompanite partnere autorizojn kompanin "Famis Co HC" sh.a. me Drejtor z Fadil Bytyçi, qe te veproj ne emer te grupit si udheheqese dhe perfaqesuese e bashkimit te operatoreve kundrejt autoritetit kontraktues - Kuvendi Komunal - Rahovec, duke kryer te gjitha veprimet ne emer dhe per llogari te bashkimit te shoqerive. Dokumenti është nënshkruar nga tre përfaqësuesit e sipërpërmendur dhe mbanë vulat e tri kompanive."*.

<u>Mendimi i Ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 13</u>

Ashtu sikurse është paraqitur me sipër, GOE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmitë për themelimin e grupit sipas kërkesave të nenit 11.1 të dosjes së tenderit. Përkundër që në deklarata shënohet "*përfaqësuesit e dy kompanive*", marrë për bazë faktin se në kreun e

dëshmisë përshkruhen emrat e tri kompanive dhe përfaqësuesit e tyre, si dhe faktit që deklaratat është nënshkruar dhe vulosur nga tri kompanitë, atëherë pjesa e tekstit ku përshkruhet "përfaqësuesit e dy kompanive" mund të jetë një gabim teknik që nuk i zhvlerëson deklaratat e dorëzuar nga anëtarët e grupit. Andaj, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 14

OE ankues pretendon se AK Autoriteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë për Lot 4 GOE i cili nuk plotëson kërkesën 4 te kapacitetit teknik dhe profesional të dosjes së tenderit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 14

a) AK, në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka paraqitur kërkesën: "*4. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ose gjeodet (shkolla e lartë), ose Bahcelor i diplomuar i gjodezisë me pesë vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) në lëmin e kërkuar (ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve)*.".Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "*4 CV- për projektet e realizuara pas diplomimit-, diploma e noterizuar nga origjinali (noterizimi te mos jete me i vjetër se 6 muaj nga data e njoftimit për kontrate) Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt (noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit për kontrate), si dhe Referenca për punët e mëparshme ne lëmin e kërkuar te lëshuar nga punëdhënësi*."

b) GOE të rekomanduar ka dorëzuar diplomën e Universitetit të Prishtinës, Fakultetit i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës ku shënohet se z.ARBER SHUKRI GASHI, u regjistrua ne vitin akademik 2014/2015.Studimet i mbaroi me 24 dhjetor 2019 ne: Departamenti i

Ndertimtarise, Programi Studimor: Gjeodezi dhe mori tituilin: Bachelor i Gjeodezise. Diploma mbanë datën 5 shkurt 2020.

Mendimi i Ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 14

Eksperti sqaron se sipas kërkesës së dosjes së tenderit, në rastin kur OE dorëzojnë dëshmitë e nivelit të studimeve Bachelor për gjeodetin, i njëjti duhet të ketë pesë vite përvojë profesionale pas diplomimit. Bazuar në faktin se GOE ka dorëzuar diplomën e nivelit Bachelor për z. Arber Gashi ku thuhet se ka mbaruar studimet me datë 24.12.2019 dhe diploma është lëshuar me datë 05.02.2020, atëherë i njëjti nuk përmbushë kushtin e kërkesës që të ketë përvojë 5 vjeçare pas diplomimit. Rrjedhimisht pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor 15

OE ankues pretendon se AK Autoriteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë për Lot 4 GOE i cili nuk plotëson kërkesën 6 te kapacitetit teknik dhe profesional të dosjes së tenderit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 15

a) AK, në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka paraqitur kërkesën: "*6.Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me tri vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ose Bahcelor i diplomuar i elektroteknikës me pesë vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) në lëmin e kërkuar (ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve)*." Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "*Dëshmia 6. CV- per projektet e realizuara pas diplomimit-, diploma e noterizuar nga origjinali (noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate) Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt (noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit per kontrate), si dhe Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar nga punedhenesi*."

b) GOE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar diplomën për z. Dukagjin Bajram Ramqaj, ku shënohet; u regjistrua ne vitin akademik 2008/2009 ne studimet master. Studimet i

mbaroi me 28 dhjetor 2015. Departamenti Elektronike, Titulli i fituar: Master i Shkencave te Inxhinierise Elektrike, Programi: Elektronike. Diploma mban datën e lëshimit 01.04.2016

Mendimi i Ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 15

Eksperti sqaron se sipas dëshmisë së dorëzuar, inxhinieri është diplomuar dhe ka marrë titullin Master i Shkencave te Inxhinierisë Elektrike, për dallim nga kërkesa që është inxhinier apo Bachelor i elektroteknikës. Me qëllim të sqarimit të këtij pretendimi, eksperti rekomandon panelin shqyrtues që të kërkojë nga AK që të bëjë verifikimin nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" në lidhje me programin e studimeve në kuptim të plotësimit apo jo të kërkesës së njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit.

Pretendimi ankimor 16

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë për Lot 4 ka dështuar të dëshmojë se përmbushë kërkesën për pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës DT, përkatësisht kërkesën 6 te Listës se pajisjeve, Ngarkues, kapac. 0.4 - 1 m3, ku sipas OE ankues pajsjet e prezantuara me numër rendor 2, 4, 5 nuk plotësojnë kërkesat për kapacitetin.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 16

a) Në lidhje me pajisjet, AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ka paraqitur Pajisjet dhe Mekanizimin e Obligueshëm për secilin Lot, ku për Lot 4, ndër të tjera edhe pozicioni 6 - Ngarkues, kapac. 0.4 - 1 m3, sasia e kërkuar (5 copë). Si dëshmi eshtë kërkuar për të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamionë rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj).

b) GOE i rekomanduar për Lot 4 ka dorëzuar listën e pajisjeve ku në lidhje me pozicionin 6 ka paraqitur të dhënat për pajisjet si vijon:

i. Radlader WA 75-3, vlti: 2000;
ii. Furkawa 345; V.P. 1993;
iii. Zettelmeyer ZL 602; V.P, l991;
iv. Liebherr L 544; V.P. 2000;
v. Kaeble SL 18 F; V.P. 1994;
vi. INPODAN DN35, vp.2017,

c) GOE ka dorëzuar dëshmitë në lidhje me pajisjet:
   i. Deklaratën unike doganore për pajisjen ngarkues me lopatë, tipi: Furkawa 345; viti i prodhimit 1993, në të cilën është vështirë të lexohen të dhënat tjera në menyrë që të përcaktohet kapaciteti i kovës.
   ii. Deklaratën unike doganore për pajisjen ngarkues me lopatë, tipi: Liebherr L 544; viti i prodhimit 2000, në të cilën nuk përcaktohet kapaciteti i kovës.
   iii. Deklaratën unike doganore për pajisjen ngarkues me lopatë, tipi: Kaeble SL 18 F; viti i prodhimit 1994, në të cilën nuk përcaktohet kapaciteti i kovës.

d) OE ankues bashkë me ankesë ka dorëzuar edhe tri imazhe nga interneti. Në imazhin e parë paraqitet pajisja Furkawa 345 nga faqja e internetit https://www.lectura-specs.com, në të cilën paraqitën të dhënat për kapacitetin e kovës prej 3m3. Ngjashëm edhe për pajisjen Liebherr L 544 janë paraqitur të dhënat nga faqja e njëjtë në internet ku shënohet se kapaciteti i kovës është 3m3. Në fund, është paraqitur edhe një fotografi e pajisjes Kaeble SL 18 F, viti i prodhimit 1994.

Mendimi i Ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 16

Eksperti sqaron se sipas dëshmive të dorëzuara nga GOE i rekomanduar për kontratë nuk mund të konstatohet se pajisjet janë konform kërkesës në kuptimin e kapacitetit të kovës 0.4 - 1 m3. Në anën tjetër sipas dëshmive të dorëzuara nga OE ankues të dhënat tregojnë se kapaciteti i kovës është mbi intervalin e përcaktuar nga AK. Më tej eksperti ka hulumtuar dhe ka gjetur se sipas katalogut të produktit Furukawa 345, kapaciteti i kovës është 2,8-3.3 m3 (https://www.lectura-specs.com/en/datasheet-viewer/32622). Më tej në lidhje me pajisjes

Liebherr L 544, sipas katalogut të kësaj pajisje përmbajtja e kovës është në kapacitetin 3-6 m3 (https://www.lectura-specs.com/en/datasheet-viewer/12178). Në fund në lidhje me pajisjen Terex-Kaelble SL 18 F sipas të dhënave në faqen https://www.lectura-specs.com/ kapaciteti i kovës është 3.6 m3. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor 17

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë ka dështuar të dëshmojë se përmbushë kërkesën për pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës DT, përkatësisht kërkesën 16 te Listës se pajisjeve, Cilindrat me rrota të kombinuara(gomë dhe hekur), min. 6.5 t, ku sipas OE ankues pajisjet e prezantuara me numër rendor 3 dhe janë cilindra hekur-hekur.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 17

a) Në lidhje me pajisjet, AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ka paraqitur Pajisjet dhe Mekanizimin e Obligueshëm për secilin Lot, ku për Lot 4, ndër të tjera edhe pozicioni 16 te Listës se pajisjeve, Cilindrat me rrota të kombinuara(gomë dhe hekur), min. 6.5 t, sasia e kërkuar (5 copë). Si dëshmi është kërkuar për të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamionë rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj).

b) GOE i rekomanduar për Lot 4 ka dorëzuar listën e pajisjeve ku në lidhje me pozicionin 16 ka paraqitur të dhënat për pajisjet si vijon:
   i. Dynapack CC421C, vp.2003,
   ii. VSH100.vp1990, nr.serik 0786/1990,
   iii. Hamm Walze; Tipi: HD 075VH1730115
   iv. Hamm Walze; Tipi: HD 075VH1870057
   v. DV 8k v.p1991 1533971,
   vi. Dynapack CA512D, v.p2007, 7042079 (Huazim)

c) GOE i rekomanduar ka dorëzuar dëshmitë në lidhje me pajisjet e sipërpërmendura si vijon:

i. Certifikatë shitjeje ku në mesin e pajisjeve evidentohet pajisja Model CC421C
ii. Deklaratën unike doganore për pajisjen VSH-100 viti i prodhimit 1990.
iii. Deklaratën unike doganore për pajisjen Hamm Walze; Tipi: HD 0 75V me numër serik H1730115
iv. Deklaratën unike doganore për pajisjen Hamm Walze; Tipi: HD 0 75V me numër serik H1870057.

d) GOE ankues ka bashkangjitur imazhe të pajisjeve VSH100, Hamm Walze HDO 75 ku shihet se pajisje nuk kanë rrota të gomës por janë cilindër me hekur.

Mendimi i Ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 17

Eksperti sqaron se në lidhje me pajiset që pretendohet se nuk plotësojnë kërkesën e AK-së, GOE i rekomanduar nuk ka paraqitur fotografi sikurse është kërkuar. Për pajisjen me numër rendor 1 në ueb faqen e prodhuesit Dynapac paraqiten të dhënat ku vërehet se pajisja nuk ka rrotë të gomës por është hekur.
https://pdf.dynapac.com/user_files/files/Technical%20data/CC421%20%28h1789%2D3%29.pdf .
Poashtu në lidhje me pajisjen me numër rendor 2 në të dhënat e paraqitura në faqe të ndryshme në internet rezulton se pajisja nuk ka rrota gome por hekur.
Në fund, në lidhje me pajisjet Hamm Walze HDO 75V sipas të dhënave në faqen Lectura rezulton se pajisja poashtu nuk ka rrota gome por hekur.
https://specs.lectura.de/de/type/baumaschinen/walzen-tandem-vibrowalzen-hamm/hd-o75-v-987133.
Andaj, si përfundim eksperti sqaron se duke marrë për bazë faktin që AK nuk ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara që konfirmojnë se pajisjet - Cilindrat janë me rrota të kombinuara. Për me shumë bazë të dëshmive të dorëzuara me ankesë dhe të dhënave në ueb faqen e prodhuesit dhe ueb faqen Lectura rezulton se pajisjet në pozicionet 1, 2, 3 dhe 4 janë cilindra me rrota hekur-hekur.

Pretendimi ankimor 18

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë ka dështuar të dëshmojë se përmbushë kërkesën për pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës DT, përkatësisht kërkesën 17 te Listës se pajisjeve, Cilindrat me rrota hekuri me vibrim min, 6.5 t ku sipas OE ankues pajisjet e prezantuara me numër rendor 3 dhe janë cilindra hekur hekur. Rrjedhimisht pretendimi ankimor është i bazuar.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 18

a) Në lidhje me pajisjet, AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ka paraqitur Pajisjet dhe Mekanizimin e Obligueshëm për secilin Lot, ku për Lot 4, ndër të tjera edhe pozicioni 17 te Listës se pajisjeve, 17 te Listës se pajisjeve, Cilindrat me rrota hekuri me vibrim min., 6.5 t, sasia e kërkuar (5 copë). Si dëshmi është kërkuar për të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamionë rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj).

b) GOE i rekomanduar për Lot 4 ka dorëzuar listën e pajisjeve ku në lidhje me pozicionin 17 ka paraqitur të dhënat për pajisjet si vijon:
   i. Hamm; Tipi: HD 75.4 K; V.P 2008; H1870034.
   ii. Hamm; Tipi: HD 75.4 K; V.P 2008; H1730549.

c) GOE i rekomanduar ka dorëzuar dëshmitë në lidhje me pajisjet e sipërpërmendura si vijon:
   i. Deklaratën unike doganore për pajisjen Hamm; Tipi: HD 75.4 K; viti i prodhimit 2008; numri serik: H1870034

Mendimi i Ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 18

Eksperti sqaron se në lidhje me pajiset që pretendohet se nuk plotësojnë kërkesën e AK-së, GOE i rekomanduar nuk ka paraqitur fotografi sikurse është kërkuar. Për pajisjen me numër rendor 1 dhe 2 eksperti ka gjetur se në katalogun e pajisjes shihet qartë se cilindri ka rrota gome në pjesën e prapme. https://www.lectura-specs.com/en/datasheet-viewer/14650 .

Andaj, si përfundim eksperti sqaron se duke marrë për bazë faktin që GOE i rekomanduar nuk ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara që konfirmojnë se pajisjet - Cilindrat janë me rrota hekuri, si dhe në bazë të dhënave në katalogun e pajisjes i qasshëm në ueb faqen Lectura ku rezulton se pajisjet në pozicionet 1 dhe 2 janë cilindra me rrota të kombinuara dhe jo hekur, pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor 19

OE ankues pretendon se OE-të janë të papërgjegjshëm dhe duhet te eliminohen nga procedura e prokurimit, pasi qe kanë dështuar që te ofrojnë dëshmitë lidhur me Kërkesat e përshtatshmërisë sipas Dosjes se Tenderit përkatësisht lidhur me piken :

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 19

a) AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, tek kërkesat e përshtatshmërisë ka vendosur kërkesat: "*b)Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës*". Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "b)Vërtetim nga Administrata Tatimore". Poashtu, është vendosur kërkesa "c)Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë" - të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës" ku dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është "*c)Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike – origjinal kopje*".

b) Në nenin25 paragrafi 9 i RrPP në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë thuhet: "*Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më shumë se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim*

të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se." Më tej në paragrafin 10 thuhet: "*Në raste kur lëshimi i dokumenteve ose çertifkatave, nën kërkesat e përshtatshmërisë ose përshtatjes profesionale nuk janë të arritshme për arsye objektive, ose kur këto dokumente nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat evidenca duhet të prodhohet, një deklaratë e shkruar në betim nga OE mund të pranohet si evidencë e mjaftueshme. Pavarësisht nga neni 65 i LPP –së dhe Neni 66 i LPP-se*"

c) Eksperti ka gjetur se AK nuk kishte publikuar njoftimin paraprak në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, konform nenit 39, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3, i LPP-së, ku thuhet "*1. Kur një autoritet kontraktues ka për qëllim dhënien, gjatë periudhës së ardhshme 12 mujore të, një ose më shumë kontratave të furnizimit, të shërbimeve apo të punëve, që vetëm ose bashkë, kanë një vlerë të parashikuar prej pesë qind mijë (500.000) Euro, lidhur me secilën kategori te përmendur autoriteti kontraktues do të përgatisë njoftimin paraprak që përcakton: 1.3. në raste të kontratave të pritura të punëve, karakteristikat thelbësore të kontratave të punëve të cilat autoriteti kontraktues synon që ti jep brenda një periudhe të tillë dymbëdhjetë (12) mujore*."

<u>Mendimi i Ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 19</u>

Eksperti sqaron se sipas nenit 25 paragrafi 9 i RrPP vërtetimet ne lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) kërkohet të dorëzohen nga një tenderues të cilin AK ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë dhe se këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK-së. Eksperti më tej sqaron se në një rast të ngjashëm paneli shqyrtues kishte vendos sipas vendimit OSHP: 2023/0194. Andaj, eksperti sqaron se pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

IV. PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË ANKESËS 2024/0058, PARASHTRUAR NGA OE: GRANITI SH.P.K.:

Sqarim hyrës: Parashtruesi i ankesës – OE Graniti SH.P.K (më tej OE ankues) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 03.01.2024, përderisa AK me datë 09.01.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. GOE ankues ka dorëzuar ankesë për Lot 1 dhe Lot 4. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me tenderët e OE të rekomanduar për Lot 1 dhe 4.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së duke e eliminuar OE ankues në Lot 2, 3 dhe 4 për pajisje grejder.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 1

a) Në lidhje me pajisjet, AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ka paraqitur Pajisjet dhe Mekanizimin e Obligueshëm për secilin Lot, ndër të tjera edhe pozicioni 10 – Grejder 12-16 t, sasia e kërkuar: Lot 1 – 2 copë, Lot 2,3 dhe 4 - 3 copë. Si dëshmi është kërkuar për të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamionë rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj).

b) OE ankues ka dorëzuar listat e makinerisë për secilin Lot, ku në lidhje me pozicionin 10 ka paraqitur të dhënat për pajisjet si vijon:

   i. O&K 156.6 A (pronë-Granit)
   ii. HBM BG 190 (pronë-Papenburg)
   iii. HBM BG 160-TA-3 (pronë-Papenburg)
   iv. Faun 105 (pronë-Granit)

c) Në lidhje me këto pajisje, GOE ka dorëzuar dëshmitë si vijon:

i. Deklarata unike doganore të datës 05.03.2021, në të cilën shënohen të dhënat për pajisjen: Marka Orenstein-Koppel, Tipi: 156.6A, ngjyrë e verdhë, viti i prodhimit 2005, numri serik 107646, pesha 16,200.oo kg.

ii. Deklarata unike doganore të datës 18.02.20004, në të cilën shënohen të dhënat për pajisjen: Tipi: HBM BG 190 TA, ngjyrë e verdhë, viti i prodhimit 1999, pesha 18,000.oo kg.

iii. Deklarata unike doganore të datës 18.02.20004, në të cilën shënohen të dhënat për pajisjen: Tipi: HBM BG 160 TA, ngjyrë e verdhë, viti i prodhimit 2005, pesha 14,880.oo kg.

iv. Kontratën mbi shitblerjen, e lidhur me datë 13.10.2006, ku OE Graniti në cilësinë e blen pajisjen me të dhënat: Greder, marka FAUNWERKKISSINO, Tipi 105, viti i prodhimit 1984. Në kontratë nuk ka të dhëna në lidhje me peshën.

d) Në lidhje me këtë pretendim, AK në vendimin e datë 09.01.2024 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ka dhënë arsyetimin si vijon: "*Ne Listën e Pajisjeve është kërkuar Pika 10, Grejder 12-16t, janë kërkuar 3 Greidera. Ndersa Operatori ka ofruar 4 grejdera, 2 prej te cilëve e tejkalojnë kapacitetin e kërkuar; 1Grejder me kapacitet 16,2t, 1greider me kapacitet 18 t, 1 grejder me kapacitet 14.00 t. Ndërsa për pajisjen nr. 4 (Faun 105) ka ofruar kontratë te shitblerjes pa te dhëna mbi peshën e pajisjes, mirëpo pas hulumtimit ne Internet komisioni i vlersirnit konstaton se Grederi Faun 105 ka peshën prej 12,400 kg. dhe si i tille OE është i përgjegjshëm vetëm ne Lot-in 1, pasi plotëson kërkesat e përcaktuara ne DT dhe njoftimit për* kontratë. *Kurse ne Lot- 2. Lat- 3, dhe Lot-4, OE është i pa përgjegjshëm pasi nuk arrin te plotësoj kërkesat e përcaktuar ne DT.*

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 1</u>

Eksperti sqaron se në lidhje me pajisjet Greider, AK ka përcaktuar kërkesën për sasitë të cilat dallojnë sipas Lote-ve. Përkatësisht, për Lot 1 kërkesa është 2 greider me peshën në intervalin 12-16T. Ndërsa për lot 2, 3 dhe 4, janë kërkuar nga 3 greider. Sipas dëshmive të dorëzuara nga GOE vetëm njëri greider (HBM BG 160 TA) plotëson kërkesën për intervalin e peshës 12-16T. Ndërsa për njërin nuk janë paraqitur të dhëna për peshën, dhe sipas AK gjatë hulumtimit në internet është gjetur se plotëson peshën. Andaj, sipas sqarimit të mësipërme sipas dëshmive të

dorëzuara GOE ka në dispozicion 4 pajisje prej të cilave 2 tejkalojnë intervalin e peshës sipas kërkesës së AK-së dhe duke marrë për bazë faktin se për Lot 2, 3 dhe 4 janë kërkuar 3 greider, pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 2

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 5 i LPP-së dhe nenin 27 paragrafi 9 i RrPP-së duke vendosur vetëm piket totale të OE-ve të përzgjedhur.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 2

a) Në njoftimin mbi vendimin e AK-së të publikuar me datë 29.12.2023 janë paraqitur OE-të e rekomanduar për dhënie të kontratë, ku janë rekomanduar për kontratë për Lot 1 - Grup i OE-ve "R & Rukolli"; "SABA BELCA" Dega në Kosovë; "ELMAZAJ KONSTRUKSION"; "Tekno - Konstrukt" SH.P.K.. Lot 2 - Grup i OE-ve "EMPREUS" SH.P.K.; "JAHA COMPANY" sh.p.k.; "Premium - KS" SH.P.K.; "Toifor" Sh.p.k.; NNT "ABC" SH.P.K.; "METAG INSAAT TICARET" A.S., Lot 3 - Grup i OE-ve "Lika Trade" Sh.p.k.; "TOFI" doo; "Lika Company" SH.P.K. Lot 4 - Grup i OE "FAMIS CO-HC" SH.A; "KIT-AK", "Gradnje", d.o.o.; "KAG - Asphalt Company" SH.P.K.

b) Në raportin për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve të publikuar me datë 29.12.2023 paraqiten OE e rekomanduar për lote dhe poenat përkatës.

c) Në Rregulloren për Prokurimin Publik 001/2022, në nenin 27, paragrafi 9 thuhet: "Tenderët duhet të vlerësohen objektivisht dhe në mënyrë transparente krahas kritereve të peshuara të publikuara. Objektiviteti dhe transparenca arrihet në mënyrën më të mirë me përdorimin e sistemit të vlerësimit me pikë ose shënimeve të pikëve të vlerësuara bazuar në kriteret e peshuara, që tregojnë një vlerësim krahasues të tenderëve nën secilin kriter."

e) Eksperti me datë 07.02.2024 ka kërkuar nga AK informacione në lidhje me poentimin e OE-ve sipas kitereve të përcaktuar në dosje të tenderit. AK me datë 08.02.2024 ka dërguar përmes emailit tabelën me vlerësimin me pikë për kriteret përktëse sipas komisioni të vlerësimit, për

secilin lot, për OE-të që AK ka vlerësuar se janë të përgjegjshëm.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 2

Ashtu sikurse është sqaruar me lartë AK ka përpiluar tabelën me pikët për OE që ka vlerësuar se janë të përgjegjshëm megjithatë nuk ka paraqitur në raportin e vlerësimit apo vendimin e AK-së informatat për pikët e vlerësuara sipas kritereve që tregojnë vlerësim për secilin kriter bazuar në dëshmitë dokumentare të dorëzuara nga tenderuesit duke vepruar në kundërshtim paragrafin 9 të nenit 27 të RrPP. Andaj, duke marrë për bazë faktin e mungesë së transparencës për pikët e vlerësuara krahas kritereve, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 3

OE ankues pretendon se AK Autoriteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë për Lot 1 GOE i cili nuk plotëson kërkesën 7 të dosjes së tenderit lidhur me licencën për prodhimin e bazës se asfaltit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 3

a) AK, në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka paraqitur kërkesën: " *7. OE duhet te jete i licencuar leje për aktivitete te veçanta për prodhimin e bazës se asfaltit, prodhimin e bazës se betonit dhe OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes zhavorr*". Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "*Dëshmia 7- Kopja e licencës lejes për aktivitete te veçanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.*".

b) GOE i rekomanduar në tenderin e dorëzuar ka paraqitur dokumentet: "Leje Për Aktivitetet e Veçanta", e lëshuar me datë 30.04.2018, nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhc Minerale (më tej KPMM) me numër 586/KPMM/2018. Leja është lëshuar për bazë të asfaltit për biznesin "SB CONSTRACTION" Sh.p.k. në kohëzgjatje deri me datë 18.04.2023.

Gjithashtu është paraqitur dokumenti - "Kërkesë për Leje për Aktivitetet e Veçanta" (formular i KPMM) e cila mbanë vulën e protokollit të KPMM me datë 05.04.2023 dhe numër të protokollit 1318. Bashkangjitur është dorëzuar edhe Fatura e lëshuar nga KPMM në lidhje me kërkesën për vazhdim të lejes. Në fund është bashkangjitur edhe dokumenti "Marrëveshje për Furnizim me Asfalt" në mes të OE "R- Rukolli" dhe "SB Construction" në të cilën shënohet: "Me këtë vërtetojmë marrëveshjen e Shitjes (furnizimit) se materialit te gjitha llojeve te asfaltit sipas recepturave, kërkesave te projektit dhe nevojës ndërmjet: R & Rukolli SH.P.K. si blerës (qiramarrës) ne njërën ane dhe SB Construction SH.P.K. si shitës/furnizues (qiradhënës) ne anën tjetër. Marrëveshja lidhet për kohëzgjatjen e projektit dhe palët pajtohen qe do te respektojnë çdo kërkesë te projektit ne fjale siç është kërkuar ne dosje te tenderit. Kjo marrëveshje garanton pa vështirësi furnizimin me materialin e cekur me larte si dhe makinerisë se nevojshme për shtrimin e asfaltit ne çdo kohe dhe ne tere territorin e Kosovës. Kjo marrëveshje furnizimi me asfalt është valide për tenderin me titull: Zgjerimi i rrugës nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc, Loti 1,2,3,4 Nr. i prokurimit: 205 23 1843 511. SB Construction SH.P.K. posedon Bazën e Asfaltit te licencuar, me kapacitet prodhimit prej 150 t/h mete gjitha pajisjet dhe stafin e specializuar për kryerjen e punëve te asfaltimeve." Marrëveshja është nënshkruar me datë 18.04.2023 dhe është vulosur nga palët. Së bashku me marrëveshjen është dorëzuar edhe dokumenti i noterizuar me numër të LRP Nr.5399/2023 - Vërtetim nënshkrimi në të cilën shënohet " *Sot, me date 24.04.2023 para meje, Zyfer Aliu, Noter me seli ne Lipjan ,Rruga" Lidhja e Prizrenit" p.n, vërteton se Nënshkrimi i mëposhtëm i vene ne dokumentin privat te quajtur "Marrëveshje për furnizim me asfaIt", e dt.18.04.2023 është vene nga:1.z.Ragip Behrami i lindur ne Skenderaj, me vendbanim te përhershëm ne Skenderaj, shtetas i Republikës se Kosovës, madhore me zotësi te plote veprimi (I autorizuar i "R&Rukolli " sh.p.k.) 2.Z.Drilon Etemi, nga i ati Etem, i lindur ne Presheve-R. Serbise, me vendqëndrim ne Prishtinë, shtetas i Republikës se Maqedonisë se Veriut, madhor, me zotësi te plate veprimi (I autorizuar i SB Construction sh.p.k.) Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e dokumentit te përpiluar jashtë zyrës se tij ,noteri vetëm vërteton nënshkrimin e palës te vene ne praninë e tij dhe ne zyrën e tij. Veprimi i noterizimit u krye ne Lipjan, me dt.24.04.2023 ne selinë e Noterit Zyfer Aliu ne adresën e lartshënuar "*

c) Në vendimin e AK-së të datës 09.01.2024, në lidhje me këtë pretendim ankimor, AK është përgjigjur: "*Lidhur me pretendimet ankimore se OE i rekomanduar për kontrate Lot 1 nuk ka plotësuar kërkesat lidhur me Dëshmia 7- Kopja e licencës lejes për aktivitete te veçanta te vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. OE ka prezantuar të gjitha deshmitë apo rnarreveshje për furnizim qe kane te bëjnë me posedimin e lejeve për aktivitete te veçanta, mirëpo ne mungese te funksionimit te bordit qe bene lëshimin e këtyre lejeve OE nuk kane mundur te bëjnë vazhdimin edhe pse kane bere kërkesa me kohe për vazhdimin e te njëjtave*."

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 3

Eksperti sqaron se GOE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Lejen për Aktivitetet e Veçanta, për bazë të asfaltit, e lëshuar nga KPMM me afat deri me datë 18.04.2023, që i bie të ketë pasur vlefshmëri në kohën e publikimit për kontratë, ndërsa leja ka skaduar para afatit për dorëzimin e tenderëve. Gjithashtu, GOE i rekomanduar ka dorëzuar edhe kërkesën e bërë në KPMM për vazhdimin e lejes. Megjithatë, marrë për bazë faktin se afati i lejes ka skaduar dhe faktit që GOE ka dorëzuar si dëshmi formularin për vazhdimin e lejes, si dokument zyrtar i KPMM-së, AK për të konstatuar se plotësohet apo jo kërkesa e dosjes së tenderit, përkatësisht GOE ka kapacitetin për të përmbushur kontratën është dashur të kërkojë informacione shtesë nga GOE apo KPMM se a ka subjekti licencë të vlefshme për veprimtarinë përkatëse. Andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar..

Pretendimi ankimor 4

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë për Lot 1 ka dështuar të dëshmojë se përmbushë kërkesën për pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës DT, përkatësisht kërkesën 16 te Listes se pajisjeve, Cilindrat me rrota të kombinuara(gomë dhe hekur), min. 6.5 t, ku pajisjet e prezantuara me numër rendor 1, 4, 5 dhe 5 nuk plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 4

a) Në lidhje me pajisjet, AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ka paraqitur Pajisjet dhe Mekanizimin e Obligueshëm për secilin Lot, ndër të tjera edhe pozicioni 16 te Listës se pajisjeve, Cilindrat me rrota të kombinuara(gomë dhe hekur), min. 6.5 t, sasia e kërkuar: Lot 1 është 5 copë. Si dëshmi është kërkuar për të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamionë rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj).

b) GOE i rekomanduar për Lot 1 ka dorëzuar listën e pajisjeve ku në lidhje me pozicionin 16 ka paraqitur të dhënat për pajisjet si vijon:

   i. 1998; e mire; AMMANN 635 D; nr. shasise 89735; pesha 8t; pronar Saba Belca; NR(RO) VRAAC-42.
   ii. 2007; e mire; HAMM HD 075K; nr. shasise HI 730653; pesha 7.335t; pronar Saba Belca; Fature NO. 62/V/15.
   iii. 1988; e mire; HAMM KHD.DV ; nr. shasise 1530876152530; pesha 9.5t; pronar Saba Belca; NO. VRAAK-33.
   iv. 1997; e mire; HYSTER C 530 A; nr. shasise 1521 N; pesha 7t; pronar Saba Belca; NR(RO) VRAAD-80.
   v. 1990; e mire; CASE W602BD; nr. serik JKC9103402; pesha 7.5t; pronar Rukolli; DUD 3042;
   vi. 2009; e mire; Dynapac CC 232 HF; nr. serik 62011233; pesha 7.2t; Elmazaj Konstruksion; Fature; Foto.
   vii. 2009; e mire; Dynapac CC 232 HF; nr. serik 341562 CHF; pesha 7.2t; Elmazaj Konstruksion; Fature; Foto.

c) GOE i rekomanduar për Lot 1 ka dorëzuar dëshmi e regjistrimit të lëshuar nga Republika e Serbisë për pajisjen AMMANN, modeli 653D mirëpo nuk është dorëzuar ndonjë dëshmi tjetër. Në lidhje me këtë pajisje eksperti ka kërkuar në ueb faqën https://www.lectura-specs.com por nuk ka informata për një pajisje të tillë. Ndërsa në kërkimin në internet, të

gjitha informatat e shfaqura tregojnë se pajisja është me të gjitha rrotat hekur.

d) Për pajisjen HYSTER C 530 është dorëzuar dëshmi e regjistrimit e lëshuar nga Republika e Serbisë mirëpo nuk është dorëzuar ndonjë dëshmi tjetër. Në lidhje me këtë pajisje eksperti ka kërkuar në ueb faqën https://www.lectura-specs.com por nuk ka informata për një pajisje të tillë. Ndërsa në kërkimin në internet, të gjitha informatat e shfaqura tregojnë se pajisja është me të gjitha rrotat gome.

e) Për pajisje Dynapac CC 232 HF është dorëzuar fatura e shitjes të lëshuar nga Delia Group për pajisjen Dynapac CC 232 HF me nr. serik 341562 si dhe ka bashkangjitur fotografinë ku shihet se pajisja është me rrota hekuri dhe jo rrota të kombinuara (gomë dhe hekur).

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 4

Sipas sqarimeve të mësipërme, eksperti vlerëson se GOE i rekomanduar për kontratë për Lot 1, në lidhje me përmbushjen e kërkesës së pajisjeve për pozicionin 16, nga 7 pajisjet e ofruara, për njërën pajisjeve (CC 232 HF me nr. serik 341562) sipas dëshmive të dorëzuara shihet që nuk është konform kërkesës së AK-së. Ndërsa për dy pajisjet tjera (AMMANN, modeli 653D dhe HYSTER C 530) në bazë të kërkimit në internet është evidente se pajisjet nuk janë me rrota të kombinuara por me rrota hekur-hekur. Andaj pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë.

Pretendimi ankimor 5

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë për Lot 1 ka dorëzuar të dhëna të pasakta në listën e kontratave të realizuara

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 5

a) AK në aneksin të dosjes së tenderit tek pjesa 19 Kriteret e propozuara për dhënie të kontratës, ka kërkuar: "*Lista e kontratave te realizuara përfunduara ne lëmine e kërkuar për*

periudhën e shkuar tre vjeçare nga data e njoftimit për kontrate. Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve duke dëshmuar me Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare"

b) Më tej AK, në dosjen e tenderit në Aneksi 6. Kriteret për Dhënien e Kontratës, në të katër lotët ka paraqitur kriterin 2 - Përvoja për punë të ngjashme në 3 vitet e fundit.

c) Në listën e kontratave për anëtarin Elmazaj të GOE të rekomanduar për Lot 1, janë prezantuar dy kontrata:
   i. Ndërtimi i Urës se Gjonit – Brataj - Ura e Laskos ne qarkun Selenice, Qarku Vlore, shuma e kontratës 11,507,944.80-euro Përfituesi/Investitori: Fondi Shqiptar 1 Zhvillimit, Strabag Trema Engineering 2.
   ii. Mbrojte Lumin Vjosë Perras Fier - shuma e kontratës 342,800.88 €, Përfituesi/Investitori: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier.

d) GOE ka dorëzuar dokumentin marrëveshje nënkontratë nr.1030.01 të nënshkruar në mes të Trema Engineering 2 dhe Elmazaj Konstruksion në vlerë prej 1,111,756,085 lekë (pa tvsh) për aktivitetin Ndërtimi i Urës se Gjonit – Brataj - Ura e Laskos ne qarkun Selenice, Qarku Vlore. Poashtu është dorëzuar dokumenti me numër të protokollit 828/3 i Fondit Shqiptar të Zhvillimit i datës 21.04.2020 ku konfirmohet se nuk ka asnjë kundërshtim në lidhje me caktimin Elmazaj L.T.D si nënkontraktor për një pjesë të punimeve. Gjithashtu janë dorëzuar certifikata e marrjes në dorëzim të objektit (e përkohshme) për projektin Ndërtimi i Urës se Gjonnit – Brataj - Ura e Laskos, e cila mbanë datën 26.05.2021. Në pikën 9 shënohet se vlera përfundimtare e kontratës është 11,507,944.8 euro me tvsh. Dokumenti është i nënshkruar nga Strabag AG dhe Elmazaj Konstruksion Sh.p.k.

e) GOE ka dorëzuar dokumentin Kontratë Publike e nënshkruar në mes të Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier dhe "Elmazaj Konstruksion & Bahas" me titull "Mbrojte ne Lumin Vjose Ferras Fier". Kontrata është nënshkruar me datë 19.06.2019, vlera e kontratës me TVSH është 38,334.987.2 lekë. Poashtu është dorëzuar Formulari i Vlerësimit i lëshuar nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier ku konfirmohet se vlera e realizuar është 38,332,751

lekë. Dokumenti është i vulosur dhe nënshkruar. Poashtu është dorëzuar Certifikate e Marrjes se Përkohshme e Dorëzimit te Punimeve e lëshuar me date 19.06.2019, ku thuhet: "*Konform kontratës Nr. l 14/22Prot. c date 19.06.2019 se lidhur ndërmjet Titullarit te Autoritetit Kontraktor te Drejtoria e Ujitjes dhe Kanalizimit FIER, te përfaqësuar nga Drejtori Z.Ledio GJYLA* dhe *Kontraktorit B.O.E" ELMAZAJ KO STR KSION" sh.p.k & "BAH AS" sh.p.k përfaqësuar nga "ELMAZAJ KONSTRUKSION" shpk me administrator z. Shkelqim ELMAZAJ ne datën 20.11.2019, u be kontrolli i punimeve te kryera dhe u procedua për lëshimin e Certifikatës se Marrjes se Përkohshme ne Dorëzim te Punimeve objekt i kësaj kontrate. Çmimi përfundimtar i kontratës është : 38,332,751 (tridhjetë e tete milion e treqind e tridhet e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një)leke, me TVSH. Garancia e Punimeve është 1,916,637.5 (një million e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mije e gjashtëqind e tridhjete e shtatë pike pese)leke me TVSH dhe mbahet për 1 (një) vit. Këtij dokumenti i bashkëngjitet Situacioni Përfundimtar i punimeve si eshtë Akt - Kolaudimi i punimeve. Periudha e ekzekutim it te kontratës ka qenë 60 (gjashtëdhjetë) dite , duke filluar nga data 01.08.2019. Punimet e ndërtimit kane përfunduar ne dt. 01.10.2019*"

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 5</u>

Eksperti sqaron se në bazë të tabelës së pranuar nga AK për vlerësimin e ofertave, AK ka marrë për bazë kontratat e GOE të rekomanduar për Lot 1 në vlerë 21,950,984.oo euro, në kuadër të kriterit - Përvoja për punë të ngjashme në 3 vitet e fundit. Pa paragjykuar se cilat kontrata janë marrë për bazë nga AK gjatë vlerësimit të ofertave, eksperti sqaron se sipas të dhënave të mësipërme në lidhje me kontratën me numrin rendor 1 janë dorëzuar dëshmitë që anëtari i GOE ka kryer punët në cilësinë e nënkrontraktorit në vlerën përkatëse brenda periudhës sikurse specifikohet në kërkesën e AK-së. Ndërsa në lidhje me kontratën me numër rendor 2 të anëtarit "Elmazaj Konstruksion", sipas të dhënave kontrata ka përfunduar në vitin 2019 dhe nuk do të duhej të merrej për bazë për faktin se është jashtë intervalit të kërkesës e që është periudhën e shkuar tre vjeçare nga data e njoftimit për kontratë. Andaj pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 6

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë për Lot 1 ka dorëzuar të dhëna të pasakta në listën e kontratave të realizuara për anëtarin "R&Rukolli"

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 6

a) Në listën e kontratave për anëtarin "R&Rukolli" të GOE të rekomanduar për Lot 1, janë prezantuar 7 kontrata.

b) Për kontratën me numër rendor 1, është dorëzuar kontrata publike e nënshkruar në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Grupit të OE-ve "R&Rukolli"& "Bageri shpk" kontrata është nënshkruar me datë 28.12.2017 dhe çmimi total i punimeve është 1,500,347.55 euro. Gjithashtu është dorëzuar edhe Aneks Kontrata për këtë aktivitet. Në fund është dorëzuar edhe raporti i pranimit nga Komisioni i Ministrisë së Infrastrukturës ku në konstatimet përfundimtare thuhet: *"Ekzekutues i punimeve eshte kompania: N.N R & Rukolli & Bageri"shpk, data e fillirnit te puneve: 12.04.2018, dhe sipas ditarit ndërtimor punët kanë përfunduar me:13.04.2022. Propozimi i komisionit: Te PRANOHEN punimet dhe te behet Llogaria Përfundimtare, vlera e kontratës: 1,500,347.55€, aneks kontrata Nr.06/2021: 149,785.99€"*

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 6

Lidhur me pretendimin ankimor se nuk duhet të merren për bazë kontratat anëtarit të GOE (R&Rukolli) pasi që njëjtat janë realizuar në kuadër të grupeve të OE-ve me OE tjerë pa u specifikuar përqindja e ndarjes së punëve, eksperti sqaron se një situatë e tillë nuk parashihet me rregullativën për prokurim publik në Kosovë. Duke qenë kështu, gjatë vlerësimit është e rëndësishme që të jenë dorëzuar dëshmitë sipas kërkesës së AK-së në kuptimin e natyrës dhe të jenë të përfunduara në brenda periudhës prej 3 vitesh nga njoftimi për kontratë. Andaj, pretendimi ankimor është i pabazuar në këtë pikë.

Pretendimi ankimor 7

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë për Lot 4 ka dorëzuar të dokumente në gjuhën sllovene dhe si të tilla bien në kundërshtim me nenin 12 të LPP-së.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 7

a) Anëtari i GOE të rekomanduar për kontratë për Lot 4, KIT-AK, Gradnje, d.o.o., ka dorëzuar dokumentet në vijim në gjuhën sllovene:

   i. Ekstrakt i rregullt nga regjistri gjyqësor / biznesi
   ii. Dokumentet në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar

b) Në nenin 13, paragrafi 4 i LPP-së në lidhje me përdorimin e gjuhëve thuhet: "*Një operator ekonomik* mund *të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze*"

c) Në lidhje me përdorimin e gjuhëve në procedurë të prokurimit, KRPP me datë 22.06.2023 ka publikuar sqarimin si vijon: "*Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron këtë: OPINION, Neni 13.4 i LPP-së në lidhje me gjuhët zyrtare të procedurës së tenderimit përcakton: "Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze". Kjo dispozitë në mënyrë të qartë përshkruhet në dokumentet standarde të tenderit. Sipas dispozitës së lartpërmendur, tenderët mund të dorëzohen vetëm në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Ligji siç shihet nuk lejon ndonjë përjashtim në rastin e lartpërmendur. Në LPP dhe legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, nuk përcaktohet zgjidhja për AK-në se si duhet të veprojë në rast se një tenderues paraqet ndonjë nga dokumentet e tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së. Në rast se një operator ekonomik dorëzon specifikimet teknike në një gjuhë tjetër (psh. në Gjuhën Gjermane, Italiane apo cilëndo gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me këtë ligj), me pasojë që Komisioni i Vlerësimit nuk është në pozitë që të vlerësoj tenderin. Në këtë rast, duhet të merren*

parasysh si në vijim: 1) neni 13.4 nuk lejon asnjë përjashtim nga gjuhët e përmendura. As format standarde të cilat imponojnë AK për të miratuar të gjitha ose disa nga gjuhët e përcaktuara në nenin 13.4. Përveç kësaj, duhet të ceket se LPP-ja, përveç gjuhës shqipe dhe serbe, tashmë e lejon përdorimin edhe të Gjuhës Angleze. Zgjedhja e ligjvënësit është bërë në faktin se, duke qenë Gjuha Shqipe dhe Serbe jo shumë e përhapur, Gjuha Angleze lejon pjesëmarrjen e Operatoreve të huaj Ekonomik, pasi që është gjuha që përdoret ndërkombëtarisht; 2) në rastin e përmendur, është menduar, se specifikimet teknike të produktit të ofruar nga OE në fjalë do të duhet të ishin në dispozicion, jo vetëm në gjuhën e tenderuesit, por edhe në gjuhën angleze. Specifikimet teknike të çdo produkti që ka relevancë ndërkombëtare zakonisht janë në dispozicion në gjuhën angleze. Kur ato nuk janë në dispozicion, OE në fjalë duhet të ketë dorëzuar, në vend të specifikimeve teknike në gjuhën e tenderuesit, një përkthim të certifikuar në anglisht për specifikimet teknike. Pra, sjellja e dokumenteve në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me ligj, është neglizhencë e OE. 3) Dispozita e lartpërmendur e LPP-së e cila përcakton përdorimin e gjuhëve gjatë procedurave të tenderimit është e përshkruar në mënyrë që të vë komisionin vlerësues në pozitë më të mirë për të vlerësuar përmbajtjen e tenderit. Në parim, prodhimi i dokumenteve i cili nuk është i shoqëruar me një përkthim zyrtar është ekuivalente me mos-prodhim të të njëjtit, pasi që pengon autoritetin kontraktues që të ketë njohuri të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë për elementet përkatëse të tenderit. 4) Parimi i lartpërmendur mund të ketë një shmangie kur nuk ka të bëjë me pjesë thelbësore të tenderit, si për shembull broshura, anekse ose dokumente të tjera që kanë karakter jo të detyrueshëm, por thjesht dorëzohen nga OE për të përshkruar më mirë produktin e ofruar. Specifikimet teknike pjesë thelbësore e tenderit, prandaj, tenderi i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet. Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument."

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 7</u>

Eksperti sqaron se neni 13, përkatësisht paragrafi 4 i LPP-së përcakton qartë gjuhët në të cilat pranohen dokumentet e tenderuesve. Më tej KRPP ka dhënë opinionin ku thuhet se sjellja e dokumenteve në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me ligj, është neglizhencë e OE. Megjithatë, në përfundim të opinionit të KRPP thuhet se për cilindo dokument të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument. Andaj pretendimi ankimor është pjesërisht

i bazuar.

Pretendimi ankimor 8

OE ankues pretendon se nga lista e kontratave të prezantuara nga anëtari FAMIS CO HC i GOE të rekomanduar për Lot 4, 3 prej tyre nuk është dashtë te merren parasysh meqë janë në vazhdim.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 8

a) Eksperti me datë 07.02.2024 ka kërkuar nga AK informacione në lidhje me poentimin e OE-ve sipas kritereve të përcaktuar në dosje të tenderit. AK me datë 08.02.2024 ka dërguar përmes emailit tabelën me vlerësimin me pikë për kriteret përkatëse sipas komisioni të vlerësimit, për secilin lot, për OE-të që AK ka vlerësuar se janë të përgjegjshëm. Në lidhje me Lot 4 ku është rekomanduar për kontratë GOE "FAMIS CO-HC" SH.A; "KIT-AK", "Gradnje", d.o.o.; "KAG - Asphalt Company" SH.P.K, në tabelën e poentimit AK ka shënuar tek nënkriteri për përvojën për punë të ngjashme në tri vitet e fundit vlerën prej 33,1646.55 euro si vlerë e kontratave në tri vitet e fundit nga ky grup i OE-ve.

b) Sipas listës së projekteve të dorëzuar të anëtarëve të këtij grupi, vlera e paraqitur për të gjithë anëtarët e grupit është 55,564,218.77 euro.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 8

Në lidhje me listën e kontratave duke parë dallimin e vlerës së kontratave që janë prezantuar në listat e kontratave të dorëzuara i bie që AK nuk ka marrë për bazë të gjitha kontratat e prezantuara në listat e kontratave. Megjithatë është e paqartë se cilat kontrata janë marrë për bazë. gjatë vlerësimit është e rëndësishme që të jenë dorëzuar dëshmitë sipas kërkesës së AK-së në kuptimin e natyrës dhe të jenë të përfunduara në brenda periudhës prej 3 vitesh nga njoftimi për kontratë.

V. PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË ANKESËS 2024/0058, TË PARASHTRUAR NGA GOE: NDËRTIMI ING SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM ; Adnan Bislimi B.I.; ADEA CONSTRUCTION SH.P.K.; Agim Morina B.I.; RIVIERA COMPANY 2008; NDREGJONI:

Parashtruesi i ankesës – GOE: NDËRTIMI ING SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM ; Adnan Bislimi B.I.; ADEA CONSTRUCTION SH.P.K.; Agim Morina B.I.; RIVIERA COMPANY 2008; NDREGJONI (më tej GOE ankues) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 03.01.2024, përderisa AK me datë 09.01.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. GOE ankues ka dorëzuar ankesë për Lot 1. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të GOE ankues dhe të njëjtat janë paraqitur edhe në kërkesën për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesën për gjendjen ekonomike dhe financiare pika 2.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 1

a) Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të publikuar nga AK me datë 29.12.2023, për GOE NDËRTIMI ING SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM ; Adnan Bislimi B.I.; ADEA CONSTRUCTION SH.P.K.; Agim Morina B.I.; RIVIERA COMPANY 2008; NDREGJONI, është dhënë arsyetimit: "*OE ka dështuar te plotësoj nenin 8.1 dhe 8.2 - Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare pika 2 .Kapital financiar te mjaftueshëm për realizimin e kontratës (lideri i grupit duhet te ketë min 40% te mbështetjes bankare), Pjesën e I-re 1,600,000.00 euro, - Pjesën e II-te 1,400,000,00 euro, Pjesën e III-te 1,200,000,00 euro, Pjesën e IV-te 2,000,000,00 euro. Dështmia e kërkuar: Deklarate nga banka qe dështmon se OE ka mjete te gatshme ne xhirollogari ose qasje ne kredi te pakushtëzuar, dokumenti te jete origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni. Bankar. Operatori ekonomik nuk ka ofruar dokumentin e Bankës sipas DT - ka ofruar qasje ne kredi te Kushtëzuar dhe lideri i konzorciumit nuk ka mbështetje bankare ne vlerë prej 40%.*".

b) AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit tek kërkesat për Kapaciteti ekonomik dhe financiar, ka vendosur kërkesën nr. 2 si vijon: "Kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (lideri i grupit duhet te ketë min 40% te mbështetjes bankare), - Pjesën e I-re 1,600,000.00 euro, - Pjesën e II-te 1,400,000,00 euro, Pjesën e III-te 1,200,000,00 euro, Pjesën e IV-te 2,000,000,00 euro." Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: " Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi te pakushtëzuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni. Bankar."

c) GOE, lidhur me këtë kërkesë ka dorëzuar dëshmitë si vijon:

i. Konfirmimi bankar nga banka TEB me datë 06.04.2023, lëshuar për OE "NDERTIMI ING SHPK", me numër të biznesit 811371640, ku tek informata për llogaritë shënohet: "Bilanci i llogarisë 584,326.74 euro".

ii. Konfirmim Bankar, të lëshuar nga banka "Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C" me datë 23.03.2023, në të cilën shënohet: "*Me ane te kësaj shkrese konfirmojmë se "Ndërtimi ING SHPK" me adresën Malishevë, me regjistrimin e biznesit nr. 811371640 dhe llogarinë nr. 1505001005722213 është klient i Raiffeisen Bank ne Kosove. Kompania Ndërtimi ING SHPK" ka qarkullim me bankën tone (gjendja e llogarisë me date 23.03.2023 është 315,291.74 Euro) si dhe ka te aprovuar kredi ne vlere rreth 100 mije Euro, mbitërheqje ne shume 5,000 mije, qe përdoren për nevoja te biznesit.*"

iii. Konfirmimi bankar nga banka TEB me datë 06.04.2023, lëshuar për BURIM ZABELAJ Bl, me numër të biznesit 811152941, ku tek informata për llogaritë shënohet: Bilanci i llogarisë 331,070.74 euro. Më tej tek informatat mbi kreditë shënohet: 90,000.00 (risku: 60,187.00 euro), limiti i mbitërheqjes 90,000.00 euro, limiti i kredit kartelës 5,000.00.

iv. Konfirmim Bankar, të lëshuar nga banka Banka Ekonomike me datë 12.04.2023, në të cilën shënohet: "*Me ane te këtij konfirmimi, Banka Ekonomike SH.A Prishtine, konfirmon se Subjekti BURIM ZABELAJ BI me pronar BURIM ZABELAJ me numër te Biznesit 811152941 është bartës/e i/e llogarisë rrjedhëse pranë Bankës Ekonomike. Kompania BURIM ZABELAJ BI ka qarkullim ne bankën tone, Gjendja e llogaris me date 12.04.2023 është*

543,878.57euro, si dhe ka te aprovuar Kredi ne shume prej 200,000.00 euro dhe mbitërheqje ne shume prej 290.000.00euro dhe CC 10,000.00 euro, qe do te përdoren për nevoja te Biznesit, Në total gjendje ne bankën ekonomike me mjete te gatshme dhe me kredi është 1,033,878.57euro."

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 1

Eksperti sqaron se sipas dëshmive të dorëzuara nga GOE, anëtari "Ndërtimi ING SHPK" ka mjete të gatshme 584,326.74 euro në bankën TEB, ndërsa në bankën Raiffeisen ka mjete 315,291.74 euro, kredi të aprovuar rreth 100,000.oo euro, mbitërheqje 5,000.oo euro. Pra anëtari i grupit "Ndërtimi ING SHPK" kishte mjete në llogari 899,618.48 euro si dhe 105,000.oo euro kredi dhe mbitërheqje të aprovuar. Anëtari tjetër BURIM ZABELAJ BI (World Medium) sipas dëshmive të dorëzuara kishte mjete të gatshme 331,070.74 euro, 90,000.oo (prej tyre 60,187.oo shënohet risku) dhe 5,000.oo limiti i kredit kartelës. Ndërsa në Bankën Ekonomike kishte 543,878.57 euro mjete në llogari si dhe kredi të aprovuara 200,000.00 euro, mbitërheqje 290,000.oo euro dhe kreditë kartelë 10,000.oo euro. Pra anëtari BURIM ZABELAJ BI (World Medium) kishte gjithsej mjete në llogari 874,949.31 euro, dhe qasje në kredi, mbitërheqje dhe kreditë kartelë në vlerë prej 505,000.00, duke mos llogaritur pjesën e kredisë në bankën TEB ku një pjesë është evidentuar si risk.

		Ndërtimi ING SHPK	BURIM ZABELAJ BI (World Medium)
TEB sh.a	Mjete ne llogari	€ 584,326.74	€ 331,070.74
	Kredi		
	Kredit kartelë		€ 5,000.00
Raiffeisen	Mjete ne llogari	€ 315,291.74	
	Kredi te aprovuar	€ 100,000.00	
	Mbitërheqje	€ 5,000.00	
Banka Ekonomike	Mjete ne llogari		€ 543,878.57
	Kredi		€ 200,000.00
	Mbitërheqje		€ 290,000.00
	Kredit kartelë		€ 10,000.00
		€ 1,004,618.48	€ 1,379,949.31
Gjithsej			€ 2,384,567.79

Pra, sipas dëshmive të dorëzuara GOE plotëson kërkesën e njoftimit për kontratë dhe dosjes

të tenderit mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, pika 2, përfshirë edhe kushtin prej minimum 40% të shumës për liderin e grupit. Në rast të dyshimit të kushtëzimeve apo cilitdo dyshim në lidhje me këtë kërkesë (por pa u kufizuar vetëm në këtë kërkesë) konform nenit 52, paragrafi 7 të LPP-së, AK do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit. Rrjedhimisht, pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë.

Pretendimi ankimor 2

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesën planin dinamik.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 2

a) Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të publikuar nga AK me datë 29.12.2023, për GOE NDËRTIMI ING SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM ; Adnan Bislimi B.I.; ADEA CONSTRUCTION SH.P.K.; Agim Morina B.I.; RIVIERA COMPANY 2008; NDREGJONI, është dhënë arsyetimit: "*Plani dinamik jo i plotësuar sipas kërkesave te DT-se. Ne dosje te tenderit kërkohet Plani Dinamik - te prezantohet sa me i detajuar i mundshëm duke i përfshirë te gjitha aktivitetet dhe pozicionet qe janë te përfshira neper paramasa nga ana e ofertuesit/Kontrakh1esit, ndërsa OE nuk ka ofruar te dhëna sipas kërkesës se DT-se.*"

b) AK në dosjen e tenderit, tek Aneksi-1 Specifikimet teknike të detyrueshme, në pjesën 19. Kriteret e Propozuara për Dhënien e Kontratës, tek tabela e kritereve ka paraqitur kriterin numër rendor 5 Plani dinamik, me përshkrimin e kriterit "Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë i detajuar." Pesha në poena është 0,10 dhe metoda e Vlerësimit është (pdo/Pd)x10, ku me poshtë është përshkruar "Pd - planin dinamik më i mirë i detajuar dhe më i shkurtë i ofertuesit" ; "pdo - planin dinamik i ofertuesit" dhe është dhënë përshkrimi: "*Plani Dinamik - duhet të prezantohet sa më i detajuar i mundëshëm (duke i përfshirë të gjitha aktivitetet/pozicionet që janë të përfshira nëpër paramasa) nga ana e ofertuesit/Kontraktuesit*"

c) Më tej në aneksin në Aneksin 6. Kriteret për Dhënien E Kontratës, për Lot 1 ka paraqitur tabelën me kriteret ku me numër rendor 4 është vendosur nënkriteri "4.Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë i detajuar", me koeficient "0.10".

d) GOE ankues ka dorëzuar dokumentin e Planit Dinamik për Lot 1, ku janë paraqitur 14 pozicionet/aktivitetet si në vijim: *1.Punët Përgatitore , 2.Pastrimi i Terenit, 3 Pun et Tokësore, Aksi kryesore, 4 Punet Tokësore, Aksi sekondare, 5 Konstruksioni i Rrugës, Aksi kryesore, 6. Konstruksioni i Rrugës, Aksi sekondare, 7. lëshesat Rrethore, 8 Sinjalistika Vertikale dhe Pajisjet mbrojtëse, 9.KANAUZIMI ATMOSFERIK, 10 ELEKTRIKA, 11.URA 1, 12.URA 2, 13.URA 3 dhe 14.Punet tjera*. Gjithashtu është paraqitur edhe shtrirja kohore për realizimin që përfshinë periudhën prej 25 muajve. Në fund të dokumentit është shënuar "*Të gjitha punët do të kryhen brenda afatit kohor prej 25 muajve*".

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 2</u>

Plani dinamik është kërkesë e vendosur nga AK në aneksin 1 të dosjes së tenderit në kuadër të kritereve të propozuara të kriterit për dhënie të kontratës, përkatësisht si nënkriter i përcaktuar nga AK në aneksin 6 të dosjes së tenderit me qëllim të përzgjedhjes së OE sipas kriterit tenderi me çmimin ekonomikisht me i favorshëm. Formulimi i kërkesës është relativ dhe jo i qartë e aq më tepër duke përdor fjalën "sa më i detajuar i mundshëm", pra duke e lënë në mundësinë e OE-ve që sipas mundësisë së tyre të thellohen në detaje. Më tej mënyra e formulimit të kriterit "*Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë i detajuar*." krijon përshtypjen që kriteri vlerësohet në dy nënndarje, fillimisht sa më i shkurtë për nga afati kohore dhe pjesa e dytë sa më mirë që është i detajuar. Sipas tabelës së poentimit të dërguar nga AK, gjatë vlerësimit është marrë për bazë vetëm afati kohor i deklaruar nga OE-të për realizimin e punëve në lotin përkatës. Andaj, duke marrë për bazë një formulim të tillë i cili për AK është subjektiv në kuptimin e vlerësimit të këtij kriteri, si dhe faktit që OE ka dorëzuar një plan i cili mund të konsiderohet më pak i detajuar mirëpo i cili jep një pasqyrë të qartë të indikatorit vlerësues "kohë", prandaj çështja e aspektit "sa më i detajuar" është vlerësim subjektiv. Rrjedhimisht, pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar

VI. PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË ANKESËS 2024/0059, TË PARASHTRUAR NGA GOE: N.N. 100 % DESIGN SH.P.K.; HAXHA KOM SH.P.K.; HAXHA COMPANY SH.P.K.; INTEGRAL SH.P.K.; MILENIUM KONSTRUCTION SH.P.K.; CAPITAL SH.P.K.:

Sqarim hyrës: Parashtruesi i ankesës – GOE: N.N. 100 % DESIGN SH.P.K.; HAXHA KOM SH.P.K.; HAXHA COMPANY SH.P.K.; INTEGRAL SH.P.K.; MILENIUM KONSTRUCTION SH.P.K.; CAPITAL SH.P.K (më tej GOE ankues) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 03.01.2024, përderisa AK me datë 09.01.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. GOE ankues ka dorëzuar ankesë për Lot 1, 2, 3 dhe 4. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të GOE ankues dhe të njëjtat janë paraqitur edhe në kërkesën për rishqyrtim. Në këtë ankesë gjithashtu janë paraqitur pretendime ankimore në lidhje me OE-të e rekomanduar për Lot 1 dhe 4.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se nuk qëndron arsyeja e eliminimit lidhur me kërkesën për kapacitetin ekonomik dhe financiar numër 2, të dosjes së tenderit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 1

a) Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të publikuar nga AK me datë 29.12.2023, për GOE ankues, është dhënë arsyetimit: "*OE ka dështuar te plotësoj kërkesat e përcaktuara ne Njoftimin e kontratës dhe DT i mungojnë: N.N. 100 % Design Sh.p.k.; Haxha Korn SH.P.K.; Haxha Company SH.P.K.; INTEGRAL Sh.p.k.; MILENIUM KONSTRUCTION SH.P.K.; CAPITAL SH.P.K., OE ka dështuar te plotësoj nenin 8.1 dhe 8.2 - Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare pika 2 .Kapital financiar te mjaftueshëm për realizimin e kontratës (lideri i grupit duhet te ketë min 40% te mbështetjes bankare), Pjesën e I-re 1,600,000.00 euro, - Pjesën e 11-te 1,400,000,00 euro, - Pjesën e III-te 1,200,000,00 euro, Pjesën e IV-te 2,000,000,00 euro, Dështmia e kërkuar: Deklarate nga banka qe dështmon se OE ka mjete te gatshme ne xhirollogari ose qasje ne kredi te pakushtëzuar, dokumenti te jete origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni. Bankar. - Operatori ekonomik nuk ka ofruar dokumentin e Bankës sipas DT - ka ofruar qasje ne kredi te Kushtëzuar dhe LIDERI I KONZORCIUMIT NUK KA MBESHTETJE BANKARE NE VLERJ PREJ 40%.*".

b) AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit tek kërkesat për Kapaciteti ekonomik dhe financiar, ka vendosur kërkesën nr. 2 si vijon: "Kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (lideri i grupit duhet te ketë min 40% te mbështetjes bankare), - Pjesën e I-re 1,600,000.00 euro, - Pjesën e II-te 1,400,000,00 euro, Pjesën e III-te 1,200,000,00 euro, Pjesën e IV-te 2,000,000,00 euro." Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: " Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi te pakushtëzuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni. Bankar."

c) GOE, lidhur me këtë kërkesë ka dorëzuar dokumentin e lëshuar nga banka BANKA KOMBETARE TREGTARE KOSOVE sha, me datë 07.04.2023, numër protokolli: 57/2023 me subjekt: "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc,Loti 1,2,3,4 205-23-1843-5-1-1", dhe tekstin si vijon: *"Theksojmë se "100% DESIGN" SHPK, me numër Unik identifikues 810618621 me përfaqësues Avni Lushtaku, është klient i bankës tone. Kemi diskutuar qëllimin e Kompanisë ne fjale për mbështetje financiare sipas Referencës: Projekti "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc,Loti 1,2,3,4 205-23-1843-5-1-1". II 100% DESIGN" SHPK aktualisht është klient aktiv ne bankën tone dhe banka është e hapur te përkrahë çdo kërkesë te tij bazuar ne politikat e matjes dhe menaxhimit te riskut lidhur me mbështetjen financiare bazuar ne Referenca: "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc,Loti 1,2,3,4 205-23-1843-5-1-111. Ne këtë kuadër, ne rast se Shoqëria e firon te drejtën e zhvillimit te projektit ne fjale, Banka Kombëtare Tregtare Sh.a. do ta ofroje mundësinë e financimit re Shoqërisë "100% DESIGN " SHPK, për financimin e këtij projekti prej se paku deri ne 2,000,000.00 € (dy milion EUR) gjithmonë konform kritereve te kreditimit te vendosura nga Banka Qendrore, procedurave dhe rregulloreve te brendshme te Bankës Kombëtare Tregtare Kosove Sha., si dhe procedurave re Bankës Kombëtare Tregtare Kosove Sha dhe legjislacionit ne fuqi. Dëshirojmë t'ju informojmë se Banka merr ne konsiderate me interes te veçantë çdo kërkesë financiare qe lidhet ne qëllimin e përmendur me larte."* Dokumenti është nënshkruar nga Fatmir Shahini – Drejtues i Korporatave dhe Florie Hajrizi Braha – Drejtuese e Degës. Poashtu dokumenti është i vulosur.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 1

Eksperti sqaron se në konstatimin e AK se GOE nuk plotëson këtë kërkesë nuk është dhënë asnjë sqarim konkret se cilin element dështmia e dorëzuar nuk plotëson kërkesën. Sipas dështmisë së dorëzuara GOE plotëson kërkesën e njoftimit për kontratë dhe dosjes të tenderit mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, pika 2, përfshirë edhe kushtin prej minimum 40% të shumës për liderin e grupit, duke marrë për bazë deklaratën nga banka për mundësinë e financimit deri në dy milion euro. Në rast të dyshimit të kushtëzimeve apo cilitdo dyshim në lidhje me këtë kërkesë (por pa u kufizuar vetëm në këtë kërkesë) konform nenit 52, paragrafi 7 të LPP-së, AK ka mundur të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit. Rrjedhimisht, pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë.

Pretendimi ankimor 2

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesën planin dinamik.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 2

a) Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të publikuar nga AK me datë 29.12.2023, për GOE ankues, është dhënë arsyetimit: "- *Plani dinamik jo i plotësuar sipas kërkesave te DT-se. Ne dosje te tenderit kërkohet Plani Dinamik - te prezantohet sa me i detajuar i mundeshem duke i perfshire te gjitha aktivitetet dhe pozicionet qe jane te perfshira neper paramasa nga ana e ofertuesit/Kontraktuesit, ndersa OE nuk ka ofruar te dhena sipas kerkeses se DT-se.*"

b) AK në dosjen e tenderit, tek Aneksi-1 Specifikimet teknike të detyrueshme, në pjesën 19. Kriteret e Propozuara për Dhënien e Kontratës, tek tabela e kritereve ka paraqitur kriterin numër rendor 5 Plani dinamik, me përshkrimin e kriterit "Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë i detajuar." Pesha në poena është 0,10 dhe metoda e Vlerësimit është (pdo/Pd)x10, ku me poshtë është përshkruar "Pd - planin dinamik më i mirë i detajuar dhe më i shkurtë i ofertuesit" ; "pdo - planin dinamik i ofertuesit" dhe është dhënë

përshkrimi: "*Plani Dinamik - duhet të prezantohet sa më i detajuar i mundëshëm (duke i përfshirë të gjitha aktivitetet/pozicionet që janë të përfshira nëpër paramasa) nga ana e ofertuesit/Kontraktuesit*"

c) Më tej në aneksin në Aneksin 6. Kriteret për Dhënien E Kontratës, për Lot 1 ka paraqitur tabelën me kriteret ku me numër rendor 4 është vendosur nënkriteri "4.Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë i detajuar", me koeficient "0.10".

d) GOE ankues ka dorëzuar Planet Dinamik ku janë paraqitur pozicionet kryesore dhe në secilin plan përkatës përshkruhet kohëzgjatja për kryerjen e punëve sipas lotëve në ditë pune.

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 2</u>

Plani dinamik është kërkesë e vendosur nga AK në aneksin 1 të dosjes së tenderit në kuadër të kritereve të propozuara të kriterit për dhënie të kontratës, përkatësisht si nënkriter i përcaktuar nga AK në aneksin 6 të dosjes së tenderit me qëllim të përzgjedhjes së OE sipas kriterit tenderi me çmimin ekonomikisht me i favorshëm. Formulimi i kërkesës është relativ dhe jo i qartë e aq më tepër duke përdor fjalën "sa më i detajuar i mundshëm", pra duke e lënë në mundësinë e OE-ve që sipas mundësisë së tyre të thellohen në detaje. Më tej mënyra e formulimit të kriterit "*Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë i detajuar*." krijon përshtypjen që kriteri vlerësohet në dy nënndarje, fillimisht sa më i shkurtë për nga afati kohore dhe pjesa e dytë sa më mirë që është i detajuar. Sipas tabelës së poentimit të dërguar nga AK, gjatë vlerësimit është marrë për bazë vetëm afati kohor i deklaruar nga OE-të për realizimin e punëve në lotin përkatës. Andaj, duke marrë për bazë një formulim të tillë i cili për AK është subjektiv në kuptimin e vlerësimit të këtij kriteri, si dhe faktit që OE ka dorëzuar një plan i cili mund të konsiderohet më pak i detajuar mirëpo i cili jep një pasqyrë të qartë të indikatorit vlerësues "kohë", prandaj çështja e aspektit "sa më i detajuar" është vlerësim subjektiv. Rrjedhimisht, pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 3

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-së dhe nenin 59 të LPP-së kur ka vendosur se GOE ankues nuk plotëson kërkesën për pajisjet dhe mekanizmat.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 3

a) Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të publikuar nga AK me datë 29.12.2023, për GOE ankues, është dhënë arsyetimit: "*Pjaisja nr.4. Gredier Caterpillar, 120 m, viti 2018 me targa AK.TM 67. Ne clokumentacionin e prezentuar per kete pajsijc mungon pesha e pajisjes. Mirpeo pas kekrimit ne internet verletohet se kjo pajisje është 16.900 kg, me c'rast nuk eshte ne perputhje me kerkesat e DT-se. Pajisja nr.5. Greider Caterpillar, tip 14G, viti 2003. Ne DUD te prezentuar nga OE pesha e pajisjes eshte 20.000kg (20t), dhe si i title nuk eshte ne perputhje me kerkesat e DT-sc. - 2. Lot- 3, dhe Lot-4, OE eshte i pa pergjegjshem pasi nuk arrin te plotesoj kerkcsat e percaktuar ne DT.*"

b) Në lidhje me pajisjet, AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ka paraqitur Pajisjet dhe Mekanizimin e Obligueshëm për secilin Lot, ndër të tjera edhe pozicioni 10 – Grejder 12-16 t, sasia e kërkuar: Lot 1 – 2 copë, Lot 2,3 dhe 4 - 3 copë. Si dëshmi është kërkuar për të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamionë rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj).

c) GOE ankues në kërkesën për rishqyrtim dhe ankesë nuk ka dorëzuar provë për të mbështetur këtë pretendim.

d) OE në tenderin e dorëzuar ka dorëzuar dokumente në lidhje me pozicionin 10 si vijon:

   1) Deklaratën unike doganore me numër të referencës 4182, të datës 19.07.2019 me përshkrimin e pajisjes: Grader O&K tipi: F106.6/F156.6A, nr.serik: 527558, viti i prodhimit 2006 dhe peshë 16,200,oo kg.
   2) Deklaratën unike doganore me numër të referencës 18034, të datës 13.11.2008 me

përshkrimin e pajisjes: Grader HBM SHM3, nr.serik: 2700620511, viti i prodhimit 1996 dhe peshë 9,250,oo kg.

3) Deklaratën unike doganore me numër të referencës 12622, të datës 10.06.2020 me përshkrimin e pajisjes: : Grader O&K tipi: F106.5A, nr.serik: 253008, dhe peshë 11,500,oo kg.
4) Deklaratën unike doganore me përshkrimin e pajisjes: : Grader Bomag tipi: 190 TA, viti i prodhimit 2001, dhe peshë 19,000,oo kg.
5) Deklaratën unike doganore me përshkrimin e pajisjes: : Grader Bomag tipi: 190 TA, viti i prodhimit 1999, dhe peshë 18,000,oo kg.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 3

Fillimisht eksperti sqaron se konstatimi i AK-së në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar përbën pasaktësi në lidhje me pajisjet pasi që GOE ankues nuk ka dorëzuar dëshmi për pajise të tilla. Më tej eksperti sqaron se nga dëshmitë e dorëzuara nga GOE ankues për 5 pajisjet – Greder, pesha e tyre nuk është në intervalin e peshës sipas kërkesës së AK-së në aneksin 1 të dosjes së tenderit (12-16T). Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 4

GOE ankues pretendon se AK Autoriteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë për Lot 1 GOE i cili nuk plotëson kërkesën 7 të dosjes së tenderit lidhur me licencën për prodhimin e bazës se asfaltit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 4

a) AK, në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka paraqitur kërkesën: " *7. OE duhet te jete i licencuar leje për aktivitete te veçanta për prodhimin e bazës se asfaltit, prodhimin e bazës se betonit dhe OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes zhavorr*". Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "*Dëshmia 7- Kopja e licencës lejes*

për aktivitete te veçanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.”.

b) GOE i rekomanduar në tenderin e dorëzuar ka paraqitur dokumentet: “Leje Për Aktivitetet e Veçanta”, e lëshuar me datë 30.04.2018, nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhc Minerale (më tej KPMM) me numër 586/KPMM/2018. Leja është lëshuar për bazë të asfaltit për biznesin "SB CONSTRACTION" Sh.p.k. në kohëzgjatje deri me datë 18.04.2023. Gjithashtu është paraqitur dokumenti - “Kërkesë për Leje për Aktivitetet e Veçanta” (formular i KPMM) e cila mbanë vulën e protokollit të KPMM me datë 05.04.2023 dhe numër të protokollit 1318. Bashkangjitur është dorëzuar edhe Fatura e lëshuar nga KPMM në lidhje me kërkesën për vazhdim të lejes. Në fund është bashkangjitur edhe dokumenti “Marrëveshje për Furnizim me Asfalt” në mes të OE “R- Rukolli” dhe “SB Construction” në të cilën shënohet: “Me këtë vërtetojmë marrëveshjen e Shitjes (furnizimit) se materialit te gjitha llojeve te asfaltit sipas recepturave, kërkesave te projektit dhe nevojës ndërmjet: R & Rukolli SH.P.K. si blerës (qiramarrës) ne njërën ane dhe SB Construction SH.P.K. si shitës/furnizues (qiradhënës) ne anën tjetër. Marrëveshja lidhet për kohëzgjatjen e projektit dhe palët pajtohen qe do te respektojnë çdo kërkesë te projektit ne fjale siç është kërkuar ne dosje te tenderit. Kjo marrëveshje garanton pa vështirësi furnizimin me materialin e cekur me larte si dhe makinerisë se nevojshme për shtrimin e asfaltit ne çdo kohe dhe ne tere territorin e Kosovës. Kjo marrëveshje furnizimi me asfalt është valide për tenderin me titull: Zgjerimi i rrugës nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc, Loti 1,2,3,4 Nr. i prokurimit: 205 23 1843 511. SB Construction SH.P.K. posedon Bazën e Asfaltit te licencuar, me kapacitet prodhimit prej 150 t/h mete gjitha pajisjet dhe stafin e specializuar për kryerjen e punëve te asfaltimeve.” Marrëveshja është nënshkruar me datë 18.04.2023 dhe është vulosur nga palët. Së bashku me marrëveshjen është dorëzuar edhe dokumenti i noterizuar me numër të LRP Nr.5399/2023 - Vërtetim nënshkrimi në të cilën shënohet “ *Sot, me date 24.04.2023 para meje, Zyfer Aliu, Noter me seli ne Lipjan ,Rruga" Lidhja e Prizrenit" p.n, vërteton se Nënshkrimi i mëposhtëm i vene ne dokumentin privat te quajtur "Marrëveshje*

për furnizim me asfalt", e dt.18.04.2023 është vene nga:1.z.Ragip Behrami i lindur ne Skenderaj, me vendbanim te përhershëm ne Skenderaj, shtetas i Republikës se Kosovës, madhore me zotësi te plote veprimi (I autorizuar i "R&Rukolli " sh.p.k.) 2.Z.Drilon Etemi, nga i ati Etem, i lindur ne Presheve-R. Serbise, me vendqëndrim ne Prishtinë, shtetas i Republikës se Maqedonisë se Veriut, madhor, me zotësi te plate veprimi (I autorizuar i "SB Construction sh.p.k.) Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e dokumentit te përpiluar jashtë zyrës se tij , noteri vetëm vërteton nënshkrimin e palës te vene ne praninë e tij dhe ne zyrën e tij. Veprimi i noterizimit u krye ne Lipjan, me dt.24.04.2023 ne selinë e Noterit Zyfer Aliu ne adresën e lartshënuar "

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 4</u>

Eksperti sqaron se GOE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Lejen për Aktivitetet e Veçanta, për bazë të asfaltit, e lëshuar nga KPMM me afat deri me datë 18.04.2023, që i bie të ketë pasur vlefshmëri në kohën e publikimit për kontratë, ndërsa leja ka skaduar para afatit për dorëzimin e tenderëve. Gjithashtu, GOE i rekomanduar ka dorëzuar edhe kërkesën e bërë në KPMM për vazhdimin e lejes. Megjithatë, marrë për bazë faktin se afati i lejes ka skaduar dhe faktit që GOE ka dorëzuar si dëshmi formularin për vazhdimin e lejes, si dokument zyrtar i KPMM-së, AK për të konstatuar se plotësohet apo jo kërkesa e dosjes së tenderit, përkatësisht GOE ka kapacitetin për të përmbushur kontratën është dashur të kërkojë informacione shtesë nga GOE apo KPMM se a ka subjekti licencë të vlefshme për veprimtarinë përkatëse. Në lidhje me dyshimin se marrëveshja e nënshkruar në emër të subjektit i cili ka lejen për aktivitete të veqanta (Sb Contruction) eksperti sqaron se AK duhet që konform nenit 52, paragrafi 7 të LPP-së të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit. Andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

<u>Pretendimi ankimor 5</u>

GOE ankues pretendon se AK Autoriteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë për Lot 1 GOE i cili ka plotësuar listën e kontratave vetëm për Lot 4 dhe nuk ka dorëzuar liste te pajisjeve për LOT 1 qe është rekomanduar për kontrate.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 5

a) AK në njoftimin për kontratë të publikuar me datë 08.03.2023 tek kërkesat lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional ka vendosur kërkesën "*2.Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës DT*". Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është "*Dëshmia 2. Lista e pajisjeve sipas aneksit te DT te plotesur ne te gjitha kolonat, bashkangjitur Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet te regjistrohen. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytëzimin, te pajisjeve, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim Deshmit per pajisjet duhet te ofrohen te renditura sipas listes se bashkangjitur ne Aneksin 1. Gjithashtu deshmit duhet te jene te dukshme*."

b) AK ka publikuar tri njoftime për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara, korrigjimin me datë 17.03.2023, korrigjimin me datë 13.04.2023 dhe korrigjimin me datë 24.04.2023.

c) Me datë 24.04.2023, AK ka publikuar dosjen e tenderit të korrigjuar ku tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nuk ka vendosur (e ka larguar përmes njoftimit për korrigjime) kërkesën të cilën OE ankues pretendon se nuk plotësohet nga GOE i rekomanduar për kontratë.

d) Në lidhje me pajisjet, AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ka paraqitur Pajisjet dhe Mekanizimi e Obligueshëm për secilin Lot, ku për Lot 1 është paraqitur tabela me 22 pajisjet me sasitë përkatëse. Si dhe teksti: "*Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1 duke deshmuar Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit ,ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj).*"

e) GOE i rekomanuar për kontratë ka dorëzuar listën e pajisjeve ku në fillim të listës shënohet Lot 4.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 5

Ashtu sikurse është sqaruar me sipër, kërkesa për listën e pajisjeve si kriter i përzgjedhjes është larguar përmes njoftimeve për korrigjim të publikuara nga AK. Megjithatë, në dosjen e tenderit është evidente kërkesa për pajisjet e obligueshme si dhe sasitë minimale që duhet të plotësohen për secilin lot. Pa paragjykuar plotësim apo jo të sasive minimale të kërkuara, eksperti sqaron se fakti që lista e kontratave shënohet se është për lot 1 nuk konsiderohet mosplotësim i kërkesës për pajisje. Plotësimi i kërkesave për pajisje dëshmohet në bazë të dëshmive të përcaktuara në tabelë nga AK e të cilat janë: viti i prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamionë rexh. i targave,mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj, si dhe përshkrimit "pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit, ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj)". Andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 6

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka rekomanduar për Lot 4 GOE i cili nuk plotëson kërkesën për kapacitetin ekonomik dhe financiar 2.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 6

a) AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit tek kërkesat për Kapaciteti ekonomik dhe financiar, ka vendosur kërkesën nr. 2 si vijon: "*Kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (lideri i grupit duhet te ketë min 40% te mbështetjes bankare), - Pjesën e I-re 1,600,000.00 euro, - Pjesën e II-te 1,400,000,00 euro, Pjesën e III-te 1,200,000,00 euro, Pjesën e IV-te 2,000,000,00 euro*." Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "*Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi te pakushtëzuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni. Bankar.*"

b) GOE, lidhur me këtë kërkesë ka dorëzuar dokumentin e lëshuar nga Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C, me titull Konfirmim Bankar, të lëshuar me datë 14.04.2023, për projektin:

Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9. 7 -Segmenti Kijeve-Dollc,Loti 7 ,2,3,4, në të cilin shënohet: Me ane te kësaj shkrese konfirmojmë se FAMIS CO-H.C SHA me adrese, Shiroke Therande, me numër unik identifikues: 870628399 ka llogari aktive ne bankën tone dhe është klient i Raiffeisen Bank Kosove. Kompania FAMIS CO-H.C SHA ka qarkullim me bankën tone si dhe ka limit te aprovuar ne vlere rreth 1,800,000 milion Euro përfshirë : mbitërheqjen dhe linja kreditore qe përdoren për nevoja te biznesit. Nëse ka ndonjë informacion tjetër te nevojshëm ne lidhje me këtë çështje mos hezitoni te na kontaktoni ne çdo kohe. Dokumenti është nënshkruar dhe vulosur.

c) Poashtu është dorëzuar dokumenti - Letërkonfirmim, i lëshuar nga banka Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C, lëshuar me datë 07.04.2023, për projektin: Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9. 7 -Segmenti Kijeve-Dollc,Loti 7 ,2,3,4, në të cilin shënohet: "*Te nderuar, Përmes kësaj shkrese konfirmojmë qe :Kompania KAG ASPHALT SHPK me numër 810593518, është klienti i Raiffeisen Bank Kosove. Kompania ka qarkullim me bankën tone si dhe ka limit ne vlere 500,000 euro përfshirë: Mbitërheqjen dhe Linjën Kreditore qe përdoret për nevoja biznesi. Për me shume info mos hezitoni ten a kontaktoni*" Dokumenti është i nënshkruar dhe vulosur.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 6

Eksperti sqaron se GOE ankues në pretendimin ankimor e ka bashkangjitur si dëshmi vetëm konfirmimin bankar për liderin e GOE të rekomanduar. Andaj, sikurse është sqaruar mesipër GOE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar konfirmimet bankare për dy anëtarët e grupit të cilat bashkarisht arrijnë vlerën prej 2,300.000.oo euro rrjedhimisht plotësohet kërkesa prej 2,000.000.oo për Lot 4. Gjithashtu, kushti prej 40 % e kësaj vlere për liderin e grupit (Famis Co HC) plotësohet. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 7

GOE ankues pretendon se AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë për Lot 4 GOE i cili nuk plotëson kërkesën 4 te kapacitetit teknik dhe profesional të dosjes së tenderit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 7

a) AK, në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ka paraqitur kërkesën: "*4. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ose gjeodet (shkolla e lartë), ose Bahcelor i diplomuar i gjodezisë me pesë vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) në lëmin e kërkuar (ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve)*.".Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "*4 CV- për projektet e realizuara pas diplomimit-, diploma e noterizuar nga origjinali (noterizimi te mos jete me i vjetër se 6 muaj nga data e njoftimit për kontrate) Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt (noterizimi te mos jete me i vjeter se 6 muaj nga data e njoftimit për kontrate), si dhe Referenca për punët e mëparshme ne lëmin e kërkuar te lëshuar nga punëdhënësi*."

b) GOE i rekomanduar ka dorëzuar diplomën e Universitetit të Prishtinës, Fakultetit i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës ku shënohet se z.ARBER SHUKRI GASHI, u regjistrua ne vitin akademik 2014/2015.Studimet i mbaroi me 24 dhjetor 2019 ne: Departamenti i Ndertimtarise, Programi Studimor: Gjeodezi dhe mori tituilin: Bachelor i Gjeodezise. Diploma mban datën e lëshimit me: 5 shkurt 2020.

Mendimi i Ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 7

Eksperti sqaron se sipas kërkesës së dosjes së tenderit, në rastin kur OE dorëzojnë dëshmitë e nivelit të studimeve Bachelor për Gjeodetin, i njëjti duhet të ketë pesë vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Bazuar në faktin se GOE ka dorëzuar diplomën e nivelit Bachelor për z.Arber Gashi ku thuhet se ka mbaruar studimet me datë 24.12.2019 dhe diploma është lëshuar me datë 05.02.2020, atëherë i njëjti nuk përmbushë kushtin e kërkesës që të ketë përvojë 5 vjeçare pas diplomimit. Rrjedhimisht pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor 8

GOE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke rekomandua për kontratë për Lo 4 GOE i cili nuk ka dorëzuar marrëveshjen për themelimin e

grupit konform kërkesave të dosjes së tenderit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 8

a) AK, në dosjen e tenderit, tek seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit, në nenin 11.1 Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik, kërkohet: "*a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës, b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d.Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.*"

b) GOE të rekomanduar për kontratë për Lot 4 ka dorëzuar deklaratat për themelimin e grupit në të cilat shënohet:

   i. "*Deklaratë, "Famis Co HC"sh.a. - Suhareke, Përfaqësuar nga Fadil Bytyçi – Drejtor, dhe KIT-AK Gradnje d.o.o. - Slovenia, Perfaqesuar nga Andrej Kitak – Drejtor, Dhe "KAG Asphalt Company sh.p.k., Përfaqësuar nga Bashkim Maliqi – Drejtor Me këtë ne deklarojmë se kompanitë me emrat e cekur me larte do te jene partner dhe do te realizojmë punimet se bashku ne tenderin me emër: TITULLI: "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc, Loti 1,2,3,4", Numri Prokurimit: 205-23-1843-5-1-1.*

   ii. *Përfaqësuesit e dy kompanive deklarojnë se nuk do te marrin pjese ne mënyrë individuale apo ne ndonjë grup tjetër qe marrin pjese ne këtë procedurë te prokurimit.*" Dokumenti është nënshkruar nga tre përfaqësuesit e sipërpërmendur dhe mbanë vulat e tri kompanive.

   iii. "*Deklaratë, "Famis Co HC"sh.a. - Suhareke, Përfaqësuar nga Fadil Bytyçi - Drejtor, dhe KIT-AK Gradnje d.o.o. - Slovenia, Përfaqësuar nga Andrej Kitak – Drejtor, Dhe "KAG Asphalt Company sh.p.k., Përfaqësuar nga Bashkim Maliqi – Drejtor Me këtë ne deklarojmë se kompanitë me emrate cekur me larte do te jene partner dhe do te realizojnë punimet se bashku ne tenderin me emër: TITULLI: "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc, Loti*

1,2,3,4", Numri Prokurimit: 205-23-1843-5-1-1. Përfaqësuesit e dy kompanive deklarojnë se janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit te tenderit dhe ne rast se grupit i jepet kontrata për ekzekutimin e kontratës" Dokumenti është nënshkruar nga tre përfaqësuesit e sipërpërmendur dhe mbanë vulat e tri kompanive.

iv. *"Deklaratë (Për Autorizimin e Partnerit Kryesor), Për realizimin e kësaj oferte ne tenderin me emër : "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijeve-Dollc,Loti 1,2,3,4", Numri Prokurimit : 205-23-1843-5-1-1, Kompanitë partnere autorizojnë kompaninë "Famis Co HC" sh.a. me Drejtor z Fadil Bytyçi, qe te veproj ne emër te grupit si udhëheqëse dhe përfaqësuese e bashkimit te operatoreve kundrejt autoritetit kontraktues - Kuvendi Komunal - Rahovec, duke kryer te gjitha veprimet ne emër dhe për llogari te bashkimit te shoqërive. Dokumenti është nënshkruar nga tre përfaqësuesit e sipërpërmendur dhe mbanë vulat e tri kompanive."*.

Mendimi i Ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 8

Ashtu sikurse është paraqitur me sipër, GOE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmitë për themelimin e grupit, ku në dëshminë e dorëzuar nga anëtarët për aurorizimin e partnerit kryesor është lënë fjali e dedikuar për një autoritet tjetër. Megjithatë duke marrë për bazë faktin se në kreun e dëshmisë përshkruhet titulli dhe numri i aktivitetit për këtë aktivitet të prokurimit, atëherë pjesa e tekstit ku përshkruhet një AK tjetër mund të jetë një gabim teknik që nuk e zhvlerëson deklaratën e dorëzuar nga anëtarët e grupit. Andaj, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 9

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke rekomanduar për kontratë për Lot 4 OE i cili ka dorëzuar Planin Dinamik të palexueshëm.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 9

a) AK në dosjen e tenderit, tek Aneksi-1 Specifikimet teknike të detyrueshme, në pjesën 19. Kriteret e Propozuara për Dhënien e Kontratës, tek tabela e kritereve ka paraqitur kriterin numër rendor 5 Plani dinamik, me përshkrimin e kriterit *"Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë i detajuar."* Pesha në poena është 0,10 dhe metoda e Vlerësimit është (pdo/Pd)x10, ku

me poshtë është përshkruar "Pd - planin dinamik më i mirë i detajuar dhe më i shkurtë i ofertuesit" ; "pdo - planin dinamik i ofertuesit" dhe është dhënë përshkrimi: "*Plani Dinamik - duhet të prezantohet sa më i detajuar i mundshëm (duke i përfshirë të gjitha aktivitetet/pozicionet që janë të përfshira nëpër paramasa) nga ana e ofertuesit/Kontraktuesit*"

b) Më tej në aneksin në Aneksin 6. Kriteret për Dhënien E Kontratës, për Lot 1 ka paraqitur tabelën me kriteret ku me numër rendor 4 është vendosur nënkriteri "4.Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë i detajuar", me koeficient "0.10".

c) GOE të rekomanduar për kontratë për Lot 4 ka dorëzuar dokumentin 45 faqesh të Planit Dinamik për Lot 4. Në pjesën e parë të dokumentit në formë tabela janë paraqitur të gjitha pozicionet, kohëzgjatja në ditë, data e fillimit dhe data e mbarimit. Në pjesën e dytë është paraqitur poashtu plani i përgatitur në MS Project i detajuar ku përshkruhen pozicionet, data e fillimit dhe data e mbarimit.

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 9

Ashtu sikurse është sqaruar me sipër, GOE i rekomanduar për Lot 4 ka dorëzuar planin dinamik të detajuar në dy formate, formatin tabelor dhe në formatin në MS Project. Në të dy formatet planet paraqesin një pasqyrë të qartë të detajuar të dinamikës së punëve të shoqëruar me afate. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, eksperti i rekomandon Panelit Shqyrtues si vijon:

1. Ankesa e OE me numër 2024/0048 të aprovohet si pjesërisht e bazuar.
2. Ankesa e OE me numër 2024/0050 të aprovohet si pjesërisht e bazuar.
3. Ankesa e OE me numër 2024/0056 të aprovohet si pjesërisht e bazuar.
4. Ankesa e OE me numër 2024/0057 të aprovohet si pjesërisht e bazuar.
5. Ankesa e OE me numër 2024/0058 të aprovohet si pjesërisht e bazuar.
6. Ankesa e OE me numër 2024/0059 të aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Më tej, eksperti rekomandon që të anulohet vendimi i AK-së i datës 29.12.2023 për Lot 1 dhe Lot 4, dhe të bëhet rivlerësimi i ofertave për këto Lote (1 dhe 4). Ndërkaq për Lot 2 dhe 3 të mbetet në fuqi vendimi i AK-së i datës 29.12.2023.